



"Almedicus"! Suplementi për mjekësinë
7% e nxënësve me ADHD, si ta kuptojmë dhe mjekimi që duhet
► Faqe 13-20

PATOZI

► Faqe 4

Ministria e Brendëshme i takon PD-së, nuk ka zgjedhje të reja

KUNDERSHTIMI

► Faqe 12

Muslimanët: Jo lëndë për homoseksualët në shkolla, dëmtojnë

PROVIMET

► Faqe 11

Klasa IX, varianti i zgjidhur për 25 pyetjet e testit të gjuhës

[SHQIPTARJA.com]

së shpejti...
TELEVIZIONI MË I RI
INFORMATIV NË SHQIPËRI

A1 REPORT!
origjina e lajmit...

LEKË 30 SHQIPTARJA.com + Suplementi ALMEDICUS

VITI II - NR. 139 E enjte, 14-06-2012

LUNCH.com/ Rrëfimi shpirtëror i presidentit të votuar Bujar Nishani

QETESOHUNI, SHEROHEM PER NJE VIT E GJYSEM

"Nuk do të jem president i Berishës". Përgjigjet për drejtësinë, Ramën dhe dëshirën për të mbajtur mustaqet si gjyshi. "Ftoj Mentor Petrelën të tregojë kartelën time"

Lajmi

Presidenti i votuar Bujar Nishani në një intervistë për "Shqiptarja.com" tregoi momentet para se të votohej për postin e lartë të kreut të shtetit, si dhe problemet shëndetësore që ka kaluar tre vite më parë. Ai e ftoi doktor Mentor Petrelën që të bënte publike kartelën e tij mjekësore



Koment



NGA ENTON ABILEKAJ

Fitoi qeveria të tjerët humbën

Pas një fushate presidenciale 45-ditore, varianti më i keq u bë realitet. Një ministër i qeverisë u bë kryetar i shtetit, Berisha arriti qëllimin që kishte me një kosto të paqartë për të, por të qartë për shqiptarët. Pushteti ekzekutiv është lëshuar drejt gjyqësorit për ta asgjësuar përfundimisht. Përzjerja e medias me politikën, që ishte një nga pjesët e spektaklit presidencial, tregoi që nuk ka asnjë pushtet të pagllabëruar nga politika dhe kryesisht nga Kryeministri. Dinë çmimin e gjithçkaje dhe vlerën e asgjëje, do të thoshte Oskar Uajlld. Tani që zhurma e së hënës u fashit, por veshët ende shungullojnë nga bëmat e zhurmshme të orëve të gjata, duket qartë që ndërtesa kryesore e shtetit, u ble shtrenjtë, por nuk ka më asnjë vlerë. Kur Ilir Meta deklaronte se nuk do të votonte një kandidat të Partisë Demokratike, i tregonte Berishës se mund të votonte kundër dhe takonte Edi Ramën në shtëpinë e tij, u duk se gjërat nuk ishin aq keq sa ç'pritej. Mund të kishte një shpresë për një President që të garantonte insitucionet e pavarura. Por të hënën u kuptua se deklarata e Metës kishte parasysh vetëm Jozefinën...
► vijon në faqe 6

TIRANE

MIRA KAZHANI

Ai ndodhet vetëm pak metra në këmbë zyrës presidenciale ku pritet të shkelë pas një muaji dhe të qëndroj atje për 5 vite e ardhshëm. Aktualisht ish-ministri i brendshëm Bujar Nishani i sapovotuar president në parlament me votat e koalicionit qeverisës është zhvendosur, me një pjesë të stafit të tij, në një nga ambientet e Pallatit të Kongreseve në pritje për të filluar detyrën e tij si kryetar i shtetit.

Ai është tema e ditës dhe jo i vetëm, por edhe bashkëshortja e tij ka përthithur një interes...
► vijon në faqe 2

I PLAGOSURI ► Faqe 19



Dëshmitari i 21 janarit: Më qëlluan kur isha te Kullat

SOT VARRIMI ► Faqe 21



Vdes i vetmuar poeti i dashurisë Pano Taçi

PUBLIKOHET VENDIMI

Qeveria, OK varrezës greke në Bularat

Zyrtarizohet dhënia e 1610 metër katrorëve tokë në Dropull

TIRANE

GENC KONDI

Qeveria shqiptare u ka dhënë "zgjerim" varrezave të ushtarakeve grekë të rënë gjatë Luftës së Dytë Botërore...
► Faqe 8

NERANXI
... gjithmonë një hap përpara...
Erëza dhe fruta të thata
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 7, Yrshak Tiranë. Tel: 042 406 500; 042 406 501; Fax 042 406 502; e-mail: neranxi@neranxi.com www.neranxi.com

DHURONI GJAK SHPËTONI JETË!

Në 14 Qershor 2012, në vendet e mbarë botës do të organizohet Dita Botërore e Dhuruesve Vullnetarë të Gjakut. Në këtë ditë bëhet e mundur një sensibilizim më i gjërë i nevojës për gjak të mjaftueshëm e të sigurt dhe theksohet rëndësia e dhurimit vullnetar të gjakut si një akt humanitar

Bashkohuni me Kryqin e Kuq Shqiptar dhe dhuroni gjak! Çdo dhurues gjaku është HERO!

Kryqi i Kuq Shqiptar organizon në Tiranë seancë dhurimi më 14 qershor në Parkun Rinia dhe më 21 qershor, pranë Galerisë Kombëtare të Arteve. Në rreth drejtohuni pranë zyrate të Kryqit të Kuq ose pranë bankave të gjakut.



Belgjika: Respektoni rregullat, ndryshe kthejmë vizat

Belgjika i ka bërë sërish thirrje Shqipërisë të respektojë liberalizimin e vizave. Sekretarja belge për emigracionin Moggie de Block gjatë një takimi në qytetin e Shkodrës ka paralajmëruar vendosjen e vizave mes vendit të saj dhe Shqipërisë nëse do të ketë rritje të azilkerkuesve shqiptarë. "Nëse do të ketë rritje të azilkerkuesve atëherë Belgjika do të rishikojë liberalizimin e vizave me

Shqipërinë. Për momentin janë 45 kërkesa në muaj që bëhen prej shqiptarëve ku 90 % e tyre janë nga Shkodra", theksoi De Block. Sipas saj një tjetër problem mbetet edhe kërkesa e shqiptarëve për azil duke përdorur fenomenin e gjakmarrjes për të cilën kërkoi nga qeveria shqiptare të marrë masa. "Edhe pse Shqipëria është një shtet i sigurtë sa i takon azilit dhe emigracionit, shteti shqiptar duhet të

marrë masa ndaj azilit për gjakmarrje. Krahunasur me vitin e kaluar ka pas një ulje të numrit të azilkerkuesve çka tregon angazhimin e shtetit shqiptar për uljen e këtij fenomeni" shtoi më tej De Block. Ndërsa një ditë më parë, Sekretarja belge për emigracionin Moggie de Block u takua edhe me drejtorin e përgjithshëm të policisë së shtetit Burgaj të cilin i kërkoi vijimin e masave për të parandaluar azilin.

EKSKLUZIVE/ Intervistë me presidentin e votuar, Bujar Nishani Sëmundja e përkohshme shërohem për 1 vit e gjysëm

"Ftoj doktor Mentor Petrelën të tregojë kartelën time"

■ ■ ■ TIRANE

MIRA KAZHANI

vijon nga faqja 1

...të pamasë nga media. Shëndeti dhe fati që e zgjodhi president në raundin e 5-të e kanë shndërruar zotin Bujar Nishani në kureshtinë dhe më të kërkuarin e gazetareve. Është një zyrë e thjeshtë me kolltukë të kohës së komunizmit dhe sekretarja më thotë se aty do të qëndrojnë vetëm për një muaj. Ai pjesën më të madhe të kohës e kalon duke ju përgjigjur mesazheve që i mbërrijnë në celular.

Si ja bëni t'ju përgjigjeni të gjithëve dhe për kuriozitet sa mesazhe keni marrë deri tani?

-Nuk do ta besosh po janë të paktën 1 mijë mesazhe dhe dua t'ju përgjigjem personalisht sepse e ndiej detyre edhe kënaqësi, më thotë ai me një sens përgjegjësie, por edhe thjeshtësi. Akoma nuk duket president ndoshta nga mënyra sportive me të cilën më priti dhe fakti që më drejtohet a thua se jemi miq prej një jete. Atmosferën e çlirio pikërisht kjo nuancë njerëzore për të cilën nuk është se nuk kam dëgjuar por e konstatova me sytë e mi dhe jo vetëm këtë por mjaft dilema që po qarkullojnë redaksive dhe kafeve të Tiranës e ndoshta Shqipërisë mbarë.

Thonë që në ministri filluan të vijnë lule që ditën e shtunë përpara se të dilte emri i Artan Hoxhës që pastaj u tërhoq. Kur u'a tha Berisha që ishit ju emri i tij per President?

-Pjesa e luleve është thashethem me siguri! Kryeministri më ftoi në zyrë dhe aty ishin edhe kryetarët e tjerë të partive të koalicionit. Mu njoftua tërhoqja e kandidatit Hoxha dhe se kandidatura do të isha unë. U surprizova, dhe të them të drejtën nuk e prisja. Nuk kisha shumë kohë për tu menduar për vetë mënyrën sesi kishin rrjedhur ngjarjet. Me një autoanalizë të shkurtër gjykova që përgjigjia ime të ishte pozitive. Thashë "po" dhe tani që ka kaluar pak kohë e jam menduar edhe më gjatë besoj që



kam dhënë përgjigjen e duhur. Këtë e lidh me besimin që kam tek vetja, energjitë pozitive dhe përkushtimin për një detyre e cila kërkon integritet dhe liri. Mendoj se do të mund të bëj atë që i takon një kryetari shteti. Shtytja e parë e imja do të jetë sistemi i drejtësisë.

Do të flasim më poshtë për këtë, por mbetemi në PD zoti Nishani.

A ka qejfmbetje në PD për zgjedhjen tuaj? A mendoni se kryeministri Berisha ju pa si figurën e vetme që nuk do të krijonte "alergji" brenda grupit kuvendor të PD. Nuk e ka patur të thjeshtë thonë edhe Berisha me disa klane e përplasje që pëshpëriten.

Së pari më lejoni t'ju them se në PD nuk ka klane siç po artikulojnë ju, as përplasje mes grupesh të caktuar. Unë të paktën nuk jam në dijeni. Gjithashtu nuk di nëse ka patur qejfmbetje, por shpresoj që jo. Mendoj që jo.

Pse nuk u kandidua zonja Topalli?

-Jua them me siguri se nëse do të kishte patur që në fillim një kandidaturë politike ajo do të kishte qënë zonja Jozefina Topalli. Fakti që ajo nuk u kandidua kishte të bënte edhe me mënyrën sesi rrodhën ngjarjet. Qëndrimi frixhid i liderit të opozitës ndaj një kandidature të tillë bëri që procesi të zhvendosej fillimisht në emra apolitikë, por siç e dini pati surpriza deri sa u mbërrit në emrin tim.

Dua të rikthehem edhe njëherë në ditën e votimit dhe këtë herë dua të flasim për rolin e ndërkombëtarëve. I pari që ju uroi në media u tha se ishte ambasadori Wollfarth, ndërsa Ambasadori amerikan Arvizu ishte gjatë votimit tuaj duke pirë një kafë në zonën e ish-blokut me gazetaren Ilva Tare. Në seancë ishte ambasadori i BE Ettore Sequi që ju ndiqte me stafin e tij por edhe ambasadorët të tjerë. Kam diçka që nuk e kam kuptuar ose nuk jam shumë e qartë? Para se ju të votoheshit si president në media u shpërndaj një mesazh urimi nga Arvizu, ndërsa gjatë votimit ai nuk u duk në sallë. A mund ta sqarojmë disi këtë situatë? Si e morët ju këtë sjellje të ambasadorit amerikan në Tiranë?

-Është e vërtetë historia e mesazhit dhe është hera e parë që e them për një media. Po, kam marrë një mesazh gjatë

paradites nga ambasadori amerikan Aleksandër Arvizu. Ishte një mesazh njerëzor dhe e vlerësova shumë. Nuk di sesi ai mesazh u shpërndaj në media dhe sa i përket sjelljes së ambasadorit gjatë kohës së votimit nuk më lejohet të komentoj dhe nuk di pse ai nuk ishte në sallë, por dua të nënvizoj se pas përfundimit të seancës mora mesazhe zyrtare nga ambasada amerikane, zyra e BE në Tiranë, OSBE.

Keni thënë se keni marrë mesazhe urimi nga deputetët socialist, a mund të na thoni disa nga emrat e tyre? Po zotin Rama kur do ta takoni?

-Kam marrë disa mesazhe nga deputetë të vjetër dhe të rinj të PS. Natyrisht që identiteti i tyre është pjesë e etikës së intimitetit të komunikimit personal. Me z. Rama besoj do të kem një komunikim vijues zyrtar dhe korrekt që besoj se do të nisë pas marrjes zyrtarisht të detyrës.

A jeni gati të përballeni me një drejtësi të shfytëruar? Do t'ju mjaftojnë 5 vite për të shpëtuar drejtësinë shqiptare, e cila është shndërruar në makthin e qytetarëve shqiptar, por që po infektion përditshëm imazhin e vendit tonë, por ajo që më shumë ka rëndësi jetën dhe të drejtën e qytetarëve.

-Presidenti nuk ka një shkop magjik dhe bën mrekullira me sistemin e drejtësisë apo me gjithëka tjetër por një president ka të gjithë kohën e mjaftueshme për të bërë ndryshime të mjaftueshme dhe pozitive. Qasja ime e parë jua thashë më lart do të jetë drejtësia dhe aty do të mbështetem në 2 faktor kyç:


1-gjyqtarët, ku do të konsistohet në promovimin dhe mbështetjen e profesionistëve me moral dhe integritet.

2-Parlamenti, tek i cili do të kërkohet bashkëpunim dhe ndërveprim ligjor dhe në shërbim të qytetarëve.

Jam i cytur dhe i motivuar për të sjellë drejtësi, drejtësisë shqiptare.

Dua t'ju theksoj se nuk bëhet kjo se presidenti është ai burri me shkopin magjik apo që dirigjon drejtësinë. Presidenti i takon të rregullojë ekuilibrat, të mos vihet nën presionin e askujt dhe të qaset vetëm nga e mira.

-Duket kaq e bukur dhe ideale kjo që po më thoni. Të jem i sinqertë ju besoj sot por ka një përvojë ironike me zyrën e të gjithë presidentëve qëkur ka nisur kjo historia e konsensualëve me takime mes palëve dhe që më vonë votohen nga një palë e vetme. Por ka akoma më shumë, ju e dini që Kryeministri Berisha ka



shkuar keq me presidentët edhe kur ato kanë dalë nga gjiri i partisë tije. A do ta prishni ju këtë magji? A do të mund të ruani integritetin tuaj z Nishani sepse koha ka treguar jo rrallë të kundërtën.

-Së pari dua t'ju kujtoj se presidenti nuk është i askujt. Nuk mund të jetë i kryeministrit, i liderit të opozitës, apo i LSI. Presidenti është i shqiptarëve dhe madje nuk ka pse të sforcohet aspak për këtë. Nëse ka një devijacion nuk është prej zyrës, por prej njeriut. Unë besoj që vendimet tona janë produkt i moralit tonë dhe jo i rrethanave politike. Askush nuk mund të të vërë në presion nëse je në atë zyrë për popullin tënd.

Duke parë e duke bërë thotë populli, por nëse nuk do ju zërë as ju tersi i asaj zyre apo dobësia për dekorata dhe anshmëria me siguri do të kemi një president për të qënë. Dua t'ju pyes për bashkëshortën tuaj, zonjën Odeta për të cilën sot më tha dikush se është një inxhinierë shumë e zonja, por ajo çka ka rënë sy është një interes marramendës i medias për të. Thuhet se ajo është një zë i fortë në veshin tuaj. Këtu nuk shoh asgjë të keqe sepse e tillë ka qënë edhe Hillary Clinton gjatë kohës së presidencës së Bill Clinton. Ku qëndron e keqja që të kemi për herë të parë një zonjë të parë të vendit me një rol aktiv.

Në fakt Odeta ka kërkuar mirëkuptimin e medias gjatë këtyre ditëve sepse edhe ajo është gjendur përballë një realiteti të ri. Është e vërtetë ajo që thoni ju në lidhje më interesin e medias. Nuk di sa shumë revista e gazeta po i telefonojnë. Sot pashe që kishin gjetur edhe foto të saj dhe të dy fëmijëve. Realisht po ju them se Odeta është një bashkëshorte që më ka mbështetur shumë, por jo profesionalisht. Shpesh herë ngjarje të ndryshme i ka marrë vesh nga mediat. Roli i Odetës ka qënë më shumë si grua dhe nënë. Pa dyshim që do t'përgjigjet edhe interesit të medias por në kohën e duhur.

A është e lumtur Odeta?

Po besoj që po megjithëse jua thashë janë ditët e para dhe akoma nuk kemi biseduar aq gjatë.

P.sh, as për zhvendosjen në



Futet në lojë PDIU, merr rezervat e shtetit

Fillojnë ndryshimet e parë në rang drejtorish. Pas lëvizjes së Bujar Nishani nga ministria e Brendshme dhe zyrtarizimi si kreu i ri i shtetit, PDIU ka shtrirë tentakulat në drejtorinë e Përgjithshme të Rezerva të Shtetit. Drejtori kjo që cilësohet si e barabartë me Drejtorin e Privatizimive. Pas dorëheqjes së menjëhershme të Hysen Arapit, e cila ka qenë e paparalajmëruar,

vendin e ka zënë Petrit Çerçizi. Dje Çerçizi ka marrë çelsin e zyrës së tij zyrtarisht. Edhe pse është mbajtur i fshehtë ky emërim, shqiptarja.com arriti që t'i marrë vesh lëvizjet e fundit brenda ministrisë së Brendshme. Ky pozicion është shumë i rëndësishëm, pasi administrohen pasuritë publike si dhe sekuestrimet e bëra në rrugë të paligjshme. Bërisha pas dhënies së dy

posteve për PDIU në rang zëvendësministra, dha edhe një drejtori shumë të rëndësishme siç është ajo e rezervave të shtetit. Çerçizi ka hequr dorë si sekretar i Këshillit të Qarkut, Durrës. Rezultatet në Google janë shumë të kufizuara për emrin e Petrit Çerçizit. I vetmi rezultat pas vendimit të këshillit të qarkut dhe facebook, ai ka bërë edhe një shkrim mbi marrjen e pronave të çamëve.



Në foto: Presidenti i votuar Bujar Nishani gjatë intervistës për Shqiptarja.com

Shehu: Do plotësohet vendi në Ministrinë e Brendshme

PD: Presidenti, test për koalicionin

Deputeti i PD: Me Metën fitojmë edhe në 2013

■ ■ ■ TIRANE

JAKIN MARENA



Tritan Shehu

rezidencën Presidenciale?

Jo, tani që po ma thoni ju po më kuptohet edhe kjo gjë. Ende jetojmë në apartamentin tonë në zonën e Selitës. Por më lejoni të ndaj një moment sinqeriteti. Ndiheh shumë në siklet kur kaloj me autokolonën presidenciale në rrugën pranë shtëpisë dhe si njeri ndihem pak në vështirësi kur shoh se duhet të ndalohe makinat e tjera për të kaluar ajo autokolona e gjatë. Aq më tepër që është një rrugë e ngushtë disi dhe ndoshta duhet menduar edhe kjo. Por janë vetëm ditët e para dhe ka aq shumë për të menduar.

A jeni i mërzitur me ndonjë artikullshkrues këto ditë?

Jo, nuk mërzitem me mediat. Është e drejta dhe puna e gazetarëve të kërkojnë, të dyshojnë, të komentojnë. Ndoshta do të mërzitesha nga politikanët për ndonjë pakujdesi që është lidhur me shëndetin tim por aspak me mediat.

Nërkohë që bisedojmë telefonin bie pa pushim dhe sinjali i mesazheve është pothuajë çdo minut.

E pyes edhe nëse ka ndërmend të ndryshojë pamje dhe hapur pa ndrojë ndoshta se ai më lejoi tap yes me çiltërsi dhe pa më të voglin dyshim që ka vija të kuqe që nuk i prek dot. Mustaqet të cilat i mban në jetë edhe babai im dhe duke referuar rastin që e kam në shtëpi i rrëfej se si bijë ja kam kërkuar prej kaq vitësh që ti heq sepse rrisin në moshtë dhe sinqerisht i gjej demode.

Ai qesh pak dhe nis e më tregon historinë e gjyshit të tij që duket se është një njeri që ka lënë gjurmë në jetën e Presidentit tonë të ri. Një burrë që ka punuar në kavalierin e mbretit Ahmet Zog dhe që ka mbajtur gjithë jetën mustaqe. Nuk më mohan se edhe dikush mund t'i ketë thënë ndonjëherë por ai gjithmonë përgjigjet me humor se ka kompensuar disa flokë që janë rraluar por që në kamera krijojnë akoma më shumë iluzionin se mungojnë. Ai realisht është një burrë më i gjatë, më elegant dhe shumë më i ri sesa duket në kamera. Dhe për këdo që ka ndonjë kureshti, duhet të dijë se Presidenti nuk do të ndryshojë asgjë në pamjen e tij. Në fakt do të ndryshojë vetëm dicka dhe ajo ka të bëjë me shëndetin e tij që për fat është një lajm i mirë i cili u zbulua

gjatë kësaj interviste.

Në tv Klan ju folët pak për problemin tuaj shëndetësor, për një ndërhyrje kirurgjikale të cilën keni kryer në vitin 2008, por a mund të na thoni diçka më shumë?

Z. Nishani a do ta bëni publike kartelën tuaj shëndetësore për qytetarët shqiptarë?

Absolutisht po! Qytetarët shqiptarë kanë të drejtën legjitime që të kenë një president të shëndetshëm. Një president që është në gjendje të marrë vendime të shëndosha, me moral dhe me fuqinë e të qenit mbi palët. Sigurisht që ka një problem shëndetësor që nuk është më i brendshëm por më shumë një çështje estetike e jashtme. Në vitin 2008 jam përballur me një problem të cilin mësova nga mjekët në Finlandë që ishte i lindur por që me kohën dy vena në kokë që ishin të ngjitura në një moment krijuan një ngërë të qarkullimit të gjakut. Ka qenë një operacion i shkurtër por shumë delikat që u përbëll me sukses. Nuk e di Mira, më drejtohet ai por isha shumë pozitiv atëherë. Nuk ju dorëzoza problemit që kisha dhe nuk pata as frikë, por e gjitha mu shndërrua brenda një çasti në një forcë pozitive e cila me siguri do më ketë ndihmuar. Sa për pasojat fizike që siç e shihni është një ngadalësim në lëvizje të këmbës së majtë dhe krahut të majtë ato janë të përkohshme.

Sa të përkohshme?

-Mjekët thonë se jo më shumë se një vit e gjysëm. Pas kësaj kohe gjithçka do të jetë si më parë. Megjithatë dua të ftoj gazetarët që janë skeptikë që të kontaktojnë njeriun e duhur për të pyetur për presidentin që është ish-pacienti i doktor Mentor Petrelës. Edhe pse urdhri i mjekut mund të mos lejojë publikimin e dosjes unë e ftoj publikisht doktor Petrelën që të jap gjithë informacionin rreth sëmundjes që kam patur unë.

Ky është Presidenti i ri i shqiptarëve. Shja që të tek bisedon me të është shumë më ndryshe nga një perceptim që vjen nga ekranet dhe gazetat. Është pa dyshim larg disa ekzagjerimeve dhe gojëplot mund të besoj se problemet estetike (të përkohshme në rastin e z.Nishani) nuk kanë qenë fatkeqësia e këtij vendi, i cili ka nevojë për një mendje dhe shpirt të shëndoshë.

Nga demokratët votimi me 73 vota i Presidentit të ri Nishani shihet si një test i kaluar me sukses nga koalicioni qeverisës dhe si një konsolidim i aleancës për të shënuar dhe një fitore tjetër në zgjedhjet e verës së vitit 2013. Ka qenë ish-kryetari i PD, Tritan Shehu ai që foli me tonë vlerësues për koalicionin me LSI e partitë e tjera. "Ky koalicion është i konsoliduar e tepër real, demokratik dhe i hapur me një pjesëmarrje të gjithëve dhe me rregulla reciproke, i cili funksionoi si duhet në zgjedhjen e presidentit të ri Nishani. Është një koalicion që do funksionojë dhe në të ardhmen, më 2013 e do përtërihet me shumë. Zgjedhja e Presidentit ishte një test i kaluar shkëlqyer për këtë koalicion. I cili do vijojë dhe pas fitores së vitit 2013. Madje mund të zgjerohet", tha Shehu për gazetën. Ai ka nënvizuar se PD doli më e fortë nga kjo sfidë presidenciale duke marrë atë që i takonte. "PD mori atë që i takonte si mazhorancë, si një forcë politike që ka qeverisur me politikat e saj të qarta e me vizion afatgjatë, por dhe për qëndrimet e saj luajale ndaj aleatëve dhe hapësirës shqiptare në përgjithësi", nënvizoi Shehu. Për të cilin pas këtij procesi më e fortë doli Kushtetuta e cila u respektua, si dhe ligji e principet demokratike. "Gjithçka u zhvillua me një frymë kushtetuese, dalog brenda frymës kushtetuese dhe ishte një shenjë emacnipimi i politikës shqiptare", nënvizoi Shehu. Për të cilin për sa i përket ndryshimeve në qeveri, është shumë e rëndësishme që të zëvendësohet vendi vakant në Ministrinë e Brendshme, por për këtë Shehu thotë se janë hap të cilët i takon t'i ndër-marrë kryeministri i vendit. Përsa i përket hyrjes së PDIU të Idrizit në qeveri, deputeti demokrat tha se "ka një marrëveshje me PDIU për koalicionin e ky është një problem që do duhet të vendosin partitë e koalicionit. Mendoj që ky vit i fundit do jetë vit reformash. Jam shumë i bindur në fitoren e vitit 2013", ka qenë deklarata e Shehut. Ndërsa lëvizjen më të fundit të Nanos e ka cilësuar një punë të brendshme të PS. "Padyshim që Nano është një personalitet i së majtës. Një lëvizje që

Kasaruho:

"Nishani, njeri i mirë, mbi të gjitha i drejtë"

Duke komentuar sjelljen e opozitës, Kasaruho vëren dhe keqardhje mospërfshirjen saj me alternative në këtë proces. Ai vë në dukje faktin pozitiv se nuk kanë munguar vlerësimet e mëhershme ndaj Nishanit, madje dhe nga kryesocialisti Rama. Vetëm një herë i ka qëlluar të takojë Nishanin, por e mjaftueshme për Kasaruho për të evidentuar në pak minuta diçka të rrallë, siç ai vë në dukje: të qenit i drejtë. Kasaruho ka një përgjigje të drejtëpërdrejtë për reagimet në media deri diku cinike për më tepër aspak të referuara në Kushtetutë, mbi aftësinë fizike të zotit Nishani, dy herë ministër i Brendshëm e një herë ministër Drejtësie, për të ushtruar detyrën e krenut të shtetit. Shembullin amerikan kur e marrim duhet ta marrim në të gjitha rastet thekson ai, duke iu referuar presidentit amerikan Ruzvelt. Të pakta janë fjalët për Nanon, lëvizjen e të cilit Kasaruho e konsideron të kurajshme, por që deri në presidencë s'mund ta çonte dot, ndoshta për t'u rikthyer në politikë.

realisht vjen si pasojë e problemeve të medha që ka PS e lider-shipi i saj, si pasojë e politikave të gabuara që ajo parti ka mbajtur gjatë kësaj periudhe. Sidoqoftë duhet të presim, të shikojmë që kjo lëvizje të shërbejë për modernizimin dhe emacipimin të forcës më të madhe opozitare në vend. Shoh një platformë politike, ta ndjekim e të shpresojmë që produkti të jetë pozitiv për PS. Ne jemi të interesuar që PS të ketë një rol sa më emancipues në Shqipëri", tha Shehu.

Arkitekti  *stili në ambientet tuaja ...*

WWW.ARKITEKTI-IM.COM
INFO@ARKITEKTI-IM.COM
+355694012132/3



POLITIKE

Ligjet thërrasin Ina Ramën në seancë dëgjimore

Kryeprokuroerja, Ina Rama do të raportojë e fundit, por jo nga rëndësia në Komisionin e Ligjeve në Kuvend raportine vitit 2011, ku përfshihet edhe ngjarja e 21 Janarit të famshëm. Edhe pse pritej të silllej më herët për të raportuar mbi gjendjen e kriminalitetit dhe zbulueshmërisë, komisioni i Ligjeve ka vendosur që të vijë

e fundit për të përmbyllur edhe ciklin e raportimeve të institucioneve që varen nga Kuvendi i Shqipërisë. Që pas ngjarjes së ndodhur më 21 Janar të vitit 2011, në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" përpara kryeministritë, Ina Rama ka prishur marrëdhëniet me qeverinë Berisha dhe me grupin parlamentar të saj. Raporti vjetor i Prokurorisë së

Përgjithshme do të jetë me tepër mbi kriminalitetin në vend si dhe mbi zbulueshmërinë e ngjarjeve më të rëndësishme. Pritet që Partia Demokratike ta bombardojë kryeprokuroren Ina Rama me pyetje, ndërsa Partia Socialiste do të kërkojë llogari për ngjarjen e 21 Janarit dhe për autorët e saj.

Kreu i Grupit të PD. S'ka zgjedhje të parakohshme

Patozi: Ministria e Brendshme i takon PD

"Oketa, jo Nishanit, Dule e Islami votë të bardhë"

Lajmi

Ministria e Brendshme do të jetë e Partisë Demokratike. Kjo i ka dhënë fund edhe aludimeve se ministria e Brendshme do të merrej nga kreu i LSI, Ilir Meta. Patozi ka këmbngulur se kjo do të jetë nga PD. Ai ka zbardhur votën e Oketës dhe të Islamit gjatë zgjedhjes së Presidentit.

TIRANE ALFRED PEZA



Astrit Patozi

Votat

Ajo që unë prisja ishte 73 vota, që ishte maksimumi. Mazhoranca aktuale ka 73 vota. Për fat të mirë, ne nuk kemi nevojë për të pasur njëte të fshehta për të zbuluar votën. Votimi ishte një skaner dhe ai nuk ishte fare befasi. Mazhoranca hyri dhe doli me 73 vota.

Ministria e Brendshme i takon Partisë Demokratike. Kështu është shprehur kreu i grupit kuvendor demokrat, Astrit Patozi në emisionin e gazetarit Alfred Peza. Patozi ka komentuar zgjedhjen e Presidentit, votën kundër dhe të pavlefshme të Nishanit.

Cfarë ndodhi me zotin Hoxha? Po prodhoheshin fletët e votimit, Garda u vu në mbrojtje të tij. Ishin luftërat brenda PD-së që nuk garantuan votat, apo kishte diçka në të kaluarën e tij?

Ajo që publiku pret është bërë e qartë. Mos prisni prej meje që unë të futem në detaje të një historie të pakëndshme, e cila sapu meje është e iniciuar politikisht nga të njëjtët njerëz, nga të njëjtat segmente politike që detyruan Zaganjorin të tërhiqej nga gara. U përdor e njëjta artilleri për të krijuar një traumë në procesin e zgjedhjes së presidentit. Arsyet Hoxha i ka bërë vetë publike. Ajo që ndodhi ishte e papritur, ishte një betejë e pistë për ta ndotur procesin dhe duke pasur si target zotin Hoxha që ishte kandidati për President.

Cila ka qenë arsyeja që refuzuat Sandër Lleshin si kandidat?

Ne dhamë disa shembuj që, me gjithë lojën e pistë të opozitës për t'asgjësuar si kandidat, dhamë disa shembuj pse politika është më mirë që ta synojë. Historia e tregoi dhe produkti ishte i tillë që e përligj këtë që po them. Imagjino sa larg do ishim ne sikur të kishim një kandidat për President ushtarak. Unë nuk mund të mos them që një ushtarak është shumë më pak se një diplomat dhe një gjyqtar njëkohësisht. Një ushtarak ndoshta është më pak për të qenë President edhe se një diplomat

vetëm. Një ushtarak është shumë më pak se një përfaqësues i shoqërisë civile që ka pasur edhe karrierë politike. Unë nuk e njoh personalisht zotin Lleshi.

Sa pranë zgjedhjeve të parakohshme ishim atë ditë?

Asnjë milimetër pranë. Ishim qindra vite dritë larg. Kam qenë plotësisht kohësht që ne në të gjitha votimet do të merrnim të njëjtin numër votash.

Ka pasur hatërmbetje në grup?

Jo nuk e besoj. Ambicia presidenciale është një gjë shumë njerëzore sidomos për politikanët, sepse është kulmi i karrierës dhe asnjë politikan nuk mund të privohet nga stacioni i fundit, siç një gjykatës nuk mund të privohet nga zgjedhja në krye të gjykatës së lartë apo në gjykatën kushtetuese.

Si kanë qenë ato orë me zotnjën Topalli?

Kjo që thoni ju është thjesht një spekulim mediat.

Berisha e tha në Parlament...

Kjo është një rrjedhojë logjike e asaj që duhet të ndodhte në rast se ne do ishim në një situatë normaliteti në raport me opozitën, që ti do e fillos nga pika më e lartë dhe pika më e lartë i takon të ishte zotnja Topalli, sepse Berisha tha që nuk jam. Piramida fillonte me zotnjën Topalli, që është numri dy i shtetit. Berisha e ka thënë pasi ngjarjet rrodhën. Zonja Topalli kurrë nuk ka thënë që unë aspiroj për të qenë Presidente e Shqipërisë.

Nano ka pasur shans për të qenë ai President?

Fatos Nano nuk ka pasur asnjë shans për të qenë president konsensual, por ka pasur shanse për të qenë kandidat i PS-së. Por në castin që Rama solli në tryezë vetëm emrin e Lleshit dhe askush në tryezë

nuk e njihje, madje edhe Rama tha që kështu më ka thënë Kadareja, Nano ka të gjithë të drejtën e botës që të ndihet i lënduar, por edhe çdo socialist që mund të mos e dojë Nanon. Të paktën më përfaqësues i PS-së se Lleshi ishte Nano. Ai s'mund të ishte i propozuar nga PD-ja.

Vendi i ministrit të Brendshëm është bosh. Kush do ta zëvendësojë, i është premtuar LSI-së?

Vakanca e përkohshme e ministrit të Brendshëm nuk prish ndonjë punë në performancën e qeverisë. Zëvendësimi do të bëhet në kohën që Kryeministri do e gjykojë të përshtatshme dhe nuk gjykojë se kjo kohë do të jetë e gjatë. Do të jetë e shpejtë.

Do jetë ministër nga PD?

Nishani u largua nga ai post për t'u ngjitur një shkallë më lart në karrierë si deputet i PD, kështu që i takon PD-së të ketë ministrin e Brendshëm.

A do jeni ju ministër i Brendshëm?

Unë kësaj pyetjeje të drejtë përdrejto po i jap një përgjigje të drejtëpërdrejtë. Unë ndihem mirë në punën që bëj dhe do ta



mbyll këtë legjislaturë në Parlament. Ndihem shumë mirë dhe shumë i motivuar në punën që bëj si kryetar grupi.

Edhe nëse Berisha j'ua kërkon?

Unë mendoj se kjo s'ka për të ndodhur, por tek e fundit unë e kam shumë të zhvilluar sensin e detyrës. Këtu nuk ka nevojë për ta pasur për shkak, pasi PD ka shumë personalitete për ta ushtruar atë detyrë.

E dini e kujt ishte vota kundër?

Është fare e qartë. Vota kundër është e zotit Oketa dhe dy votat e bardha janë të Dules dhe Islamit. Diferenca mes Dules dhe Islamit është që Dule e bëri demonstrative votën, ndërsa Islami respektoi më shumë procedurën, sepse është njeri më strikt dhe shkoi deri te dhoma e fshehtë. Të dy këta personazhe megjithëse nuk votuan për një kandidat të mazhorancës, bënë një gjest prej politikani të përgjegjshëm

Deklarata

Rama: Nano, një shërbëtor i Berishës

TIRANE



Kryetari socialist Edi Rama në një inervistë për emisionin "Fakt" në UTV është shprehur se Fatos Nano ka qenë një shërbëtor i Sali Berishës në shtatë vitet e fundit, duke paralajmëruar se ai s'do jetë kurrë deputet i PS pasi ka ikur nga kjo parti që në vitin 2007 kur votoi për presidentin Topi. "Po më kërkoni që të jepja konsensus për Jozefinën. Nano ishte i paanshëm. S'ishte nga ana jonë, megjithëse duke marrë bilancin e përgjithshëm ai ka qenë 15 vjet në shërbim të PS dhe 7 vitet e fundit një shërbëtor i Berishës. Nëse çdo mjet justifikon qëllimin, atëherë mjeti i përdorur nga Fatosi ishte vendosja e

zërit e figurës së tij në shërbim të Sali Berishës, sa herë ai e ka pasur të nevojshme, dhe ka elementë pikantë të shërbimit, qoftë ndaj Berishës dhe ndaj kandidatëve të tij në fushatën kundër nesh", ka qenë deklarata e Ramës. Sipas të cilit Berishës i duhej Fatos Nano si diversion ndaj PS. Në të njëjtën kohë ai duke komentuar lëvizjen e Nanos për rimarrjen e PS deklaroi se as ka punë më në PS. "Është një turp i madh për njeriun që vetëofrohej për të qenë kreu i shqiptarëve dhe pak ditë më pas shpallos një fjalor që ta kishte zili çdo karrociër i dehur. Ka ikur pa kthim në vitin 2007 kur votoi për Topin president, ka sulmuar PS në çdo moment kyq për të mikluar Berishën. As për deputet

s'kandidohet në emër të PS", tha prerë kreu i PS, Rama. Ndërkohë ai e cilëson Nishanin një President me profil të ulët, pa ndonjë meritë, profili i një njeriu kokëkullur, që ka pasur vetëm një meritë, që nuk ka ngritur zërin dhe nuk ka ndjellë zërin e përgjithshëm të qeverisë ndaj opozitës. "Me Jozefinën në Presidencë do kishim Salin në katror. Salinun e kemi në kryeministri deri në qershor të vitit tjetër. Në presidencë sot kemi një ministër, burrë të urtë nën udhërat e tij. Me Jozefinën do kishim një skifter të PD si heronjtë e lindjes së mesme që mbajnë një fajakua në shpatull", tha Rama. Duke nënvizuar se Berisha është komunisti i fundit që vjen vërdallë në këtë vend.



POLITIKE

Rama-Meta më propozuan mua, kundër Berisha

Paskal Milo kryetari i PDS, aleat i PS bëri të ditur dje se e majta jozyrtarisht propozoi emrin e tij tek kryeministri për President, por ky i fundit e hodhi poshtë me një argument të vetëm. Milo zbuloi se takimi Rama-Meta prodhoi një emër që mund të ishte kandidati i opozitës për President. "Janë çuar disa emra në tavolinën e z.Rama. Emri im është propozuar, është diskutuar në tavolinën të ngushta në biseda liderësh

politikë të së majtës dhe së djathtës. Të enjten e shkuar është bërë një kompromis mes liderëve të së majtës Ramës dhe Metës për emrin tim siç më kanë konfirmuar burime të sigurta. Është shkuar tek z. Berisha dhe ai e ka refuzuar duke e argumentuar se poqese do hapet kapitulli i kandidaturave politike, ai do ia adresojë kandidaturave të partisë së tij", tha Milo. Ai vuri në dukje se për këtë arsye nuk arriti të

bëhej kandidat. "Jo, nuk kam qenë kandidat dikush do duhet të më kishte propozuar zyrtarisht ose do isha vetëshpallur, nuk e kam bërë sepse duhet të matësh forcat para se të hysh në garë. Duhet mbështetje politike e cila nuk u dha publike për shumë arsye", tha ai. Kreu i PDS akuzoi opozitën se veprimi keq. Sipas tij, kjo ishte një garë që në vend që të prodhonte emra, prodhoi diçka tjetër, kulisa.



Tavo:

"Rama gaboi që nuk e kandidoi Fatos Nanon"

TIRANE

Nënkryetari i Kuvendit të Shqipërisë Vangjel Tavo është shprehur dhe njëherë në favor të një kandidimi i ish-kreut socialist Fatos Nano për postin e Presidentit të Republikës, ndonëse ka folur me tonë superlativ për presidentin e ri të zgjedhur nga mazhoranca, Bujar Nishani. Në një deklaratë për mediat, Tavo ka deklaruar se



Para se gjithash do të kishte dashur që Fatos Nano, lideri historik i Partisë Socialiste, të ishte kandidat për president, por i takonte PS-së ta propozonte, gjë që nuk e bëri për shkak se nuk desh vetë lideri i kësaj partie Edi Rama, arësytet e të cilës i di vetë ai. Anëtarë i kryesisë së Lëvizjes Socialiste për Integrim, deputeti Vangjel Tavo, ka theksuar se zgjedhja e kreut të ri të shtetit, Bujar Nishani, është kryer në respekt të plotë të Kushtetutës së vendit. Ai vlerësoi personalitetin e kreut të ri të shtetit, Nishani, duke e cilësuar një

personalitet që ka kontribuar për këtë vend. "Presidenti Nishani është një figurë që i ka dhënë shumë vendit në institucionet që ka drejtuar dhe është zgjedhur në rregullsi të plotë të kushtetutës së Shqipërisë", ka qënë deklarata e deputetit të LSI, Vangjel Tavo. Por nuk ka qënë i vetmi ky deputet i LSI që ka kërkuar kandidimin e Nanos nga ana e PS për postin e presidentit të ri të Republikës. Madje kanë këmbëngulur fort në këtë drejtim kreu i PBDNJ, Vangjel Dule por dhe kreu i PDIU, partisë përfaqësuese të çamëve, Shpëtim Idrizi.

Kreu i grupit mbledh deputetët sipas qarqeve: Zbrisni në terren Deputetët e PS në bazë gati shtabet elektorale

Do punohet me listat dhe evidentimin e kandidatëve

TIRANE

JAKIN MARENA

Socialistët tashmë janë të përgjendruar të gjithë në bazë për të përgatitur fitoren sipas tyre të zgjedhjeve të ardhshme parlamentare. Kreu i grupit parlamentar socialist, Gramoz Ruçi, vetëm një ditë pas festimeve të 21 vjetorit të krijimit të Partisë Socialiste ka mbledhur deputetët e partisë së tij sipas qarqeve për të rikultuar dhe njëherë të gjitha detyrat që dalin në këtë vit, që të gjitha partitë politike e kanë cilësuar si një vit elektorale. Bëhet e ditur se temë kryesore në këtë takim ka qënë ngritja e shtabëve elektorale në përbërje të të cilëve do të jenë deputetët, të deleguarit e kryesisë e të Asamblesë Kombëtare të PS, kreut e PS të rretheve, të komunave e bashkive përkatëse, kreu i FRESSH, i Gruas Socialiste dhe i atij grupi potencialësh njerëzore që mendohet se do të jenë dhe bërthama nga ku do të zgjidhen dhe kandidatët për deputetë për të qënë pjesë e listës rajonale për zgjedhjet parlamentare të verës së vitit 2013. Njëherësh në këto takime të gjithë deputetët socialistë kanë dhënë propozimet e tyre për përmirësimin e punës me bazën, dhe sidomos për të arritur mbajtjen e koalicionit të opozitës së bashkuar në këmbë që të funksionojë në zgjedhjet e verës së ardhshme. Një ndër elementët kryesorë që është kërkuar ndaj deputetëve të PS ka qënë përfshirja e të gjithë atyre që duan të kontribuojnë në largimin e kësaj qeverisje, që sipas tyre është e korruptuar dhe e ka varfëruar popu-



Fushata

Blendi Klosi, sekretari Organizativ i PS, i cili lanço fillimin e organizimit elektorale tashmë që zgjedhja e presidentit, sipas tij përfundoi njëanshmërisht. Klosi thotë se kushdo që do të kontribuojë për të majtën duhet të kontribuojë brenda PS-së.

përzgjedhje me bazë sa më të gjërë për të evidentuar dhe përzgjedhur të gjithë ata kandidatë të cilët kanë mbështetje të madhe në komunitet dhe për pasojë mund të thithin më shumë vota për PS dhe opozitën në përgjithësi. Një takim i tillë i Ruçit me deputetët socialistë sipas qarqeve ka ardhur vetëm një ditë pas takimit të kreut të PS, Edi Rama me grupin parlamentar, të cilëve u ka kërkuar tashmë që të mos merren me me Presidentin dhe zgjedhjen e tij, pasi pavarësisht se nuk është zgjedhur në mënyrë konsensuale, ai është zgjedhur sipas Kushtetutës. Dhe për këtë arsye, Rama e ka cilësuar këtë betejë të përfunduar, duke kërkuar që deputetët të zbarkojnë në bazë dhe të punojnë me të për arritjen e fitores së madhe në zgjedhjet parlamentare të qershorit të vitit 2013. Ndërsa po një ditë më parë ka qënë dhe Blendi Klosi, sekretari Organizativ i PS, i cili lanço fillimin e organizimit elektorale tashmë që zgjedhja e presidentit, sipas tij përfundoi njëanshmërisht. Klosi thotë se kushdo që do të kontribuojë për të majtën duhet të kontribuojë brenda PS-së.

lin. Është kërkuar që të bisedohet dhe me të gjithë ata që kanë qënë të pakënaqur deri më tani, apo të mënjanoar në mënyrë që të arrihet krijimi i

"Është kërkuar dhe po punohet shumë në bazën e PS për identifikimin e kandidatëve që mund të jenë në listën shumëemërore për deputetë"

një fronti të përbashkët opozitar që të kontribuojnë të gjithë në këtë vit elektorale në realizimin e një fitoreje të së majtës, pas tetë viteve të qëndrimit në opozitë. Nga ana tjetër një ndër elementët kryesorë që është kërkuar në

takimin me deputetët ka qënë dhe puna me listat e zgjedhësve. Duke qënë se në zgjedhjet vendore të 8 majit të vitit të kaluar ka pasur shumë kontestime për listat e zgjedhësve dhe sidomos për transferimet dhe lëvizjet e votuesve në mënyrë të pakontrolluar dhe pa kriter sipas nevojave elektorale të mazhorancës, është dhënë udhëzimi i prerë që të bëhet verifikimi i tyre dhe të rregullohen sipas ligjit, në mënyrë që të mos ketë tjetërsim të votës apo votim dy herë sipas preferencave partiake. Një element tjetër që është kërkuar dhe po punohet shumë në bazën e PS është identifikimi i kandidatëve që mund të jenë në listën shumëemërore për deputetë, ku kreu i PS Rama ka vendosur të bëjë një

PELOD STUHLING ORIGINAL
Marke Amerikane (New York), garancia 2 vjet
Adresat: Dytanë Kleopatra perballë kompleksit Taiwan Flagship Center Durrës
 cel: +355 696235070
 albaniatime@gmail.com

Grup Zjarrfikseje
Pompa
Gjeneratore
Pishina
Përpunim uji
Crystalblue
 Adresa: Unaza e Re, pranë Alpha Bank Tiranë; +355 4 8320162;
 Tel/fax: +355 69 400 95 87
 E-mail: erjon@crystal-blue.gr

Higjenë e garantuar nga ALPEN PULITO
 Dezinfirmim
 Deratizim
 Dezinsektim
 Firmë Pastrimi, Shërbime speciale pastrimi, Pastrim dyshemeje të çdo lloj siperfaqeje, Produkte pastrimi, Shërbime DDD
 Cel 06822009101 ose 0683055364
 info@alpenpulito.al - www.alpenpulito.al
 Makineri paisje-aksesore pastrimi, Auto vinc me qera



Ish-kreu socialist

Nano: Do të provoj t'i rimarr PS-në Ramës

Fatos Nano për herë të parë ka paralajmëruar me gojë e tij se pas tretjes së ambicies presidenciale, do synojë drejtimin e PS. Ish lideri historik i së majtës në një pronocim të shkurtët deklaroi se tashmë ka vetëm një mision: të çojë socialistët në fitoren e zgjedhjeve të 2013 me ose pa Edi Ramën, raporton Ora Neës. "Kjo lëvizje do të orientojë fuqimisht elektoratin e majtë drejt një

formule fituese me apo pa Edi Ramën. Nuk e përjashtoj objektivin e rimarrjes së drejtimit të PS dhe në rast se Rama dhe struktura që ai drejton do ta pengojnë këtë gjë, ne do ta orientojmë të gjithë ushqimin elektorat të socialistëve dhe të së majtës drejt një liste tjetër, jo të Ramës", tha Nano. "Nëpërmjet këtij uragani që sapo ka nisur dhe natyrisht do ta përfshijë dhe

vetë PS". Nano ka vijuar me serinë e akuzave ndaj kreut aktual të PS-së, që sipas tij i ka sjellë partisë më të madhe opozitare vetëm humbje, humbje që për Nanon duhet të marrin fund. "Në rast se Rama vazhdon të qesëndisi me nervozizëm nevojën për të rikthyer fuqinë e socialistëve të bashkuar, atëherë fundi do të jetë edhe gjymtimi i këtij fenomeni nga Rama.

Flet zv.kryeministri dhe ministri i Jashtëm, Edmond Haxhinasto

Negociatat, shkuam në zgjedhjet optimale

Presidenti i ri, ky proces i mungonte vendit

Lajmi

Politika duhet të realizojë ato detyrime që ka marrë. Kështu është shprehur zëvendëskryeministri Edmond Haxhinasto gjatë një interviste për televizionin A1 Report dhe gazetën "shqiptarja.com", sipas tij, zgjedhja e Nishani ka treguar protshmeri optimale.



Reformat

Politika duhet të realizojë ato detyrime që ka marrë. Politika ka arritur marrëveshje në nëntor të vitit të kaluar përsa i takon reformës zgjedhore dhe asaj parlamentare. Ritmi për të realizuar këto reformat nuk duhet të bie në mënyrë absolute. Ky është detyrim i madh politik, nuk ka të bëjë me optimizimin apo pesimizimin, Ky është detyrim deri në momentet e fundit. Politika të realizojë deri të fund ato marrëveshje të arritura në nëntor të vitit të kaluar

Politika ka arritur marrëveshje në nëntor të vitit të kaluar përsa i takon reformës zgjedhore dhe asaj parlamentare. Ritmi për të realizuar këto reformat nuk duhet të bie në mënyrë absolute. Ky është detyrim i madh politik, nuk ka të bëjë me optimizimin apo pesimizimin, Ky është detyrim deri në momentet e fundit. Politika të realizojë deri të fund ato marrëveshje të arritura në nëntor të vitit të kaluar

Ju jeni vlerësuar si Ministër se keni simpatinë e Brukselit. Në takime konfidenciale a merrni këshilla apo kritika nga zyrtarët e Brukselit?

Dimensioni njerëzor i marrëdhënieve është shumë i rëndësishëm. Kam kënaqësinë të dëgjoj këtë konstatim. Unë përfaqësoj Shqipërinë, sigurisht një pjesë e këtij përcaktimi i përket vetë vendit tim. Progresit që ajo ka bërë, angazhimeve në rritje ndërkombëtare që ajo ka bërë, ritmeve të saj. Së fundi në nënshkruam një marrëveshje me BE, në kuadër të emergjencave që hap një kuadër shumë të gjerë në atë të emergjencave. Por dhe rolin që Shqipëria luan në kuadër të organizatave të tjera siç është NATO, apo në rajonin e Ballkanit.

Ka një sens të fortë realizimi të asaj që Shqipëria bën në rajon në kuadër të detyrimeve të saj, por dhe ato që ajo bën për tu afruar me BE. Kjo është një klimë pozitive që ka reflektimin të atij roli të madh që shqipëria luan dhe syron të luajë dhe në të ardhmen.

KOMENT

NGA ENTON ABILEKAJ

Pak fitues dhe shumë humbës

vijon nga faqja 1

...se vota kundër kërkonte vetëm koncesione të reja dhe takimi me Ramën, ishte njëpërdorimsh, sa për të detyruar Berishën të tërhiqej. Meta fitoi, shqiptarët humbën. Berisha ishte më i sinqerti. E tha që në fillim që donte një eksponent të partisë së tij. E vlerësoi sa duhej Metën dhe e zhvlerësoi sa duhej Ramën. Kandidatët e tërhequr ia dha aleatit të majtë, të vërtetën e mbajti për vete. Pas koncesioneve, të tretin mund ta merrte. Dhe, nëse Meta nxorri Ramën kur i duhej, Berisha i nxorri Metën Ramës kur i duhej. Kryetari i opozitës mbeti vetëm, gjysmëhapi i përjashtuar dhe gjysmëhapi i vetëpërjashtuar nga procesi. Berisha fitoi, shqiptarët humbën. Në kampin e të humburve janë edhe përfaqësuesit e Komunitetit Ndërkombëtar. Ambasadori amerikan u deklarua që në fillim të procesit kundër zgjedhjes së një ministri në krye të Shtetit. Ndodhi pikërisht e kundërta. Pritej që Arvizu të deklaronte atë që premtoi, që ky ishte shansi i humbur. Në vend të kësaj ishte një deklaratë që uronte dhe besonte tek Nishani. Përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar kërkonin garanci që presidenti i ardhshëm nuk do të firmoste dëshirat e kryeministrit për të shtënë në dorë Prokurorinë dhe SHISH-in. Nishani nuk mund ta garantojë këtë. Kjo ishte një humbje që reflektohej në deklaratën e lëshuar nga ambasada e SHBA. Ata humbën bashkë me shqiptarët. Nano humbi ndoshta shansin e fundit për t'u bërë president. Tentativa e fundit tregoi se pa një mbështetje të fortë nuk mund të kërcësojë në krye të Shtetit. Rama nuk ia dha për asnjë nga çmimet, as për ofertat bashkëpunuese.

Kryetari i Partisë Socialiste ishte i humburi më i madh në këtë proces. Që në fillim, pasi shpërndau ftesat për takime me të gjithë, shkoi në Gjirin e Lalzit që t'i shërbente Metës për të paralajmëruar Berishën. Ngjarjet me editorialin dhe më pas u bë simbol i paqartësisë së kryetarit të opozitës. Deri të dielën në 10 qershor. Takimi i fundit me maxhorancën, një ditë përpara raundit të katërt. Meta ishte tërhequr plotësisht, kandidaturat ishin politike, Sandër Lleshi ra. Ishte hapur gara. Rama nuk mund të zgjidhte president dhe kishte të drejtë. 64 vota nuk mjaftonin. Por kur humbi shansi për konsensus, kur maxhoranca po çonte në garë një kandidat të vetin, opozita kishte të drejtën të mendonte për më tej dhe të kërkonte nga kjo garë rrezimin e Berishës. Të zhdukte hijet dhe paranojat dhe të kandidonte Nanon. Për të humbur betejën e 11 qershorit dhe për të fituar, bashkimin e të majtës për zgjedhjet e 2013. Vënien e Metës përballë një zgjedhjeje të vështirë për t'u bashkuar me Nanon si kandidat i së majtës, apo me Nishanin si kandidat i Berishës. Dhënia e një mesazhi për ndërkombëtarët që opozita nuk rri dhe vështron kur kërcënohen institucionet e pavarura, por reagon me të gjitha votat e mundshme. Asgjë nga këto nuk ndodhi. Edhe pse ishte paralajmëruar, Rama zgjodhi të mos bëjë betejë me Berishën dhe t'i hapte rrugë një beteje brenda së majtës. Sot beteja brenda së majtës është në ditën e tretë. Ata kanë humbur bashkë me shqiptarët dhe po shkojnë drejt një humbjeje akoma më të madhe. Presidenti pritet të bëjë betimin dhe së shpejti gjithçka do të kthehet në normalitet, përveç Partisë Socialiste. Në parlament maxhoranca dhe opozita do t'u rikthehen 3 pikave të tjera, kodit zgjedhor, reformës parlamentare dhe heqjes së imunitetit të deputetit. PS është e interesuar të arrijë konsensusin në këto pika, sidomos për kodin zgjedhor. Me këtë konsensus do të shkohet në Bruksel për të kërkuar statusin e kandidatit. Kjo do të jetë dita kur pretendimi i vetëm i Ramës gjatë procesit të presidentit do të rrezohet.

www.shqiptarja.com

■ ■ ■ TIRANE

MIRA KAZHANI

Ministri Edmond Haxhinasto gjatë një interviste për televizionin A1 Report dhe gazetën "Shqiptarja.com" ka folur për zgjedhjen e Presidentit, regjimin e BE-së si dhe për integrimin në komunitetin evropian.

Dje deklarata e dalë nga Brukseli, zyra për shtyp e zotit Fyle që u komentua edhe nga mediat shqiptare, pra gjuha diplomatike e Brukselit kishte një mesazh, a mund të themi se zgjedhja e Presidentit ishte shansi i humbur, ne e rrezikojmë ne statusin?

Kurkush s'ka thënë që statusi rrezikohet nga mënyra sa do zgjidhet Presidenti. Kjo është në kuptimin deklarativ, kurse në kuptimin e substancial ne shikojmë që procesi ka patur risitë e veta, ka patur takime të gjithë faktorëve politikë, takime të drejtuesve të mazhorancës me drejtuesit e partisë kryesore të opozitës. Ky ishte një proces që i mungonte për një kohë të gjatë vendit, diskutimi për një çështje të caktuar të rëndësishme nga të gjitha palët. Procesi i diskutimit dhe konsultimit ka në thell një parim të rëndësishëm, që nga procesi duhet të fitojnë të gjitha

palët. Nuk mund të hysh në një takim me synimin për të arritur pritshmërinë maksimale. Procesi i presidentit afro mundësinë që gjithkush të lë pritshmërinë maksimale dhe të dalë më një zgjedhje optimale.

Fakti që ambasadori i BE ndoqi seancën ishte legjitimim i Bukselit për procesin?

Gazetarët e kanë qejf simbolikën, prezencën e ambasadorit të BE është e mirëpritur, cilësia e procesit afro mundësitë për çdo forcë politike të arrijnë në një terren të përbashkët për zgjedhjen e presidentit, zgjedhja e bërë i shërben vendit dhe procesit të integritetit. Duhet të kuptojmë në thellësi dhe konceptimin konkret parimin që procesi negocues vendosi një një terren të përbashkët. Nuk mund të hyjë kurkush më kondicionim për zgjedhje të caktuara apo imponim për zgjedhje të caktuara. Në një proces negocim për herë të tretë të gjitha palët duhet të kenë seriozitetin e duhur. Zgjedhja e bërë duke përzgjedhur Nishanin si President të vendit vendos në territor të përbashkët të gjitha palët përta i përket integritetit të presidentit të ri dhe cilësive që Nishani ka si figurë që ka vepruar gjith-

monë në përputhje të plotë me ligjin dhe që ka patur sukses në të gjithë detyrat e dertanishme.

Vjeshta ka shumë pritshmëri për vendin, përsa i përket statusit, qëndrimet janë të ndryshme, jeni skeptik apo optimist, e marr me mend se ju jeni optimist, a mendoni se statusi përkethehet në shenjestër të politikës për ta marrë si punë të kryer më shumë se si nevojë e qytetarëve, a e kanë qytetarët informacioni e plotë për këtë proces?

Statusi është objektiv politik i rëndësishëm, objektiv i gjithë politikës shqiptare. Është në krye të axhendave të tyre, të programeve që ata kanë, por dhe një hap cilësor për Shqipërinë dhe qytetarët shqiptarë. Me këtë status Shqipëria ka të drejtë të futet në përfitim të skemave të caktuara të fondeve komunitare në investime në shumë sektorë. Nuk është çështje imagini, por dhe çështje konkrete praktike. Do thosha se momenti i vlerësimit të Shqipërisë për statusin duhet të shërbejë si motivim për politikën, pavarësisht zgjedhjes së Presidentit. Politika duhet të realizojë ato detyrime që ka marrë.



Votohet sot moratoriumi, PS pret surpriza

Partia Socialiste është përgatitur të shoh surpriza gjatë votimit të propozimit të tyre për heqjen e moratoriumit të skafeve. Burime nga selia rozë kanë bërë me dije se "gjatë votimit do të ketë surpriza dhe rrjedhje votash nga Partia Demokratike. Kjo do të vijë pas një lobimi që ne i kemi bërë. Në të vërtetë duhet që të hiqet moratoriumi,

pasi ai po bën pengesë lëvizjen e lirë". Artan Gaçi, deputeti i selisë rozë, në emër të Partisë Socialiste ka sjellë në Kuvend një mandament për të hequr moratoriumin e skafeve. Komisioni i Sigurisë dhe Komisioni i Ligjeve kanë rrëzuar amendimin e Gaçit. Por pritet se do të ketë surprizë në seancën e sotme plenare, ku besohet dhe pretendohet se

do të hiqet me vota moratoriumi i skafeve që ka gjashtë vjet që është vendosur. Trefteçari i dytë i përfundon në shkurt të vitit 2013. Partia Socialiste e ka parë si një shkelje të së drejtës për të përdorur pronën e saj private. Ndërsa demokratët me arsyetimin se vendosja e moratoriumit ka ulur nivelin e kërimit të organizuar në vend.

Debate në Kuvend, opozita kërkon ndëshkim për abuzuesit

Shkollat, 38 janë ende pa licensë

Çmimi i librave shkollorë, vendos ministria

Lajmi

Janë me dhjetëra institucione private parauniversitare, që veprojnë në gjithë vendin të palicensuara. Kjo u konfirmua ditën e djeshme në komisionin e Arsimit. Ndërsa gjoha maksimale për shkollat pa licensë do të jetë një milion lekë të reja.



Shkollat pa licensë

Deputeti i PD-së, Mark Marku ka aluduar se në shkollat e palicensuara mund të ketë edhe raste të trafikimit të organeve. Por kjo shprehje, është ndeshur me rezistencën e deputetit tjetër të PD-së, Bogdani tha se nuk mund të ketë rast që në këto shkolla të ekzistojë trafiku i organeve

kemi të drejtë që të heqim licencat për ato shkolla që nuk përmushin standartet e vendosura nga ne.

Leskaj: Po nëse ju po thoni kështu atëherë ne kemi nivel të lartë të informalitetit të madh. Dhe në këtë mënyrë i bie që sistemi parauniversitar të jetë pa cilësi.

Shamku: Ok të mendojmë se do tu heqim licencën, po ku do të shkojnë këta fëmijë, se nuk do të jenë pak klasa në të.

Marku: Në këto shkolla pa licensë mund të ketë edhe trafikim të organeve.

Valentina Leskaj: Atëherë të rrisim nivelin e gjobës. Nga një milionë që e ka vendosur ministria maksimumin le ta vendosim 10 milionë, pra një 100 milionë. Ndoshta kështu janë më të përgjegjshëm. Dhe do të ulët edhe numri i abuzimeve. Unë këtë heqjen e licensave, apo të shkollave që nuk kanë marrë fare licensë e shoh të rrezikshme për shoqërinë shqiptare. Rritja e

ratimit. Shkollat private e hapura në rrugë jo ligjore rrezikojnë gjobë deri në një milionë lekë të reja. Propozimi i ministrisë së Arsimit ka qenë "gjobë nga 500 mijë deri në një milionë lekë për ato shkolla që nuk kanë marrë licensë për të hapur një shkollë apo kopësht". Ndërsa deputetja e Valentina Leskaj ka kërkuar që gjoha maksimale të mos jetë një milionë, por dhjetë milionë lekë të reja. Sipas saj kjo gjobë të ishte për ato shkolla që kanë shumë klasa dhe që ushtrojnë aktivitetin në rrugë të paligjshme.

Gjohat janë debatura shumë nga të dyja palët, pasi propozimi i Leskajt u duk shumë i tepruar në shifër.

DEBATET NË KOMISIONIN E MEDIAS


Ledi Shamku: Nga një studim që është bërë ka 544 institucione arsimore parauniversitare, ku 38 prej tyre rezultojnë të jetë në palicensuar.

Halit Shamata: Ka 402 shkolla private që janë të licensuara. Ligji i ri i inspektiveve na ka dhënë mundësi që në të

Denoncimi i "Shamikuqes"

Baraku: Nuk e dimë se numri është i Mziut

Komisionerja për mbrojtjen nga diskriminimi është kërkuar për të hetuar rastin të denoncuar nga një ish-punonjëse e administratës, për kryetarin e Bashkisë Kamez, Xhelal Mziu. Mesashi i dërguar prej tij bëri xhiron e medias me pseudonimin "shamikuqja". Komisionerja Irma Baraku tha gjatë raportimit në Komisionin e Ligjeve, tha se nuk mundi të provonte se numri i telefonit prej nga niseshin ngacimimet seksuale, ishte i kreut të njësisë lokale. "Është shumë e vështirë për tu verifikuar. Kemi kërkuar informacion nga kompania celulare, dhe nuk na ka dhënë pasi duhet të merret vendim nga Prokuroria. Dhe së dyti kryetari i Bashkisë nuk na ka konfirmuar se është numri i tij", është shprehur Irma Baraka pas pyetjes së bërë nga deputetja e Partisë Socialiste Ermonele Felaj ku u shpreh se: "Rekalama më e mirë do të ishte ajo e të qenit aktiv. Këtu i referohem rastit të shamikuqes së famshme ne media. Ju nuk i keni dhënë përgjigje. Rasti është bërë publik dhe ju nuk keni marrë vendime por e keni mbyllur. Verifikimi është i thjeshtë dhe ju duhet ta kishit bërë. Të konfirmoni numrin e telefonit që është bërë publik si dhe të verifikoni nëse punonjësja ka qenë pjesë e administratës së bashkisë së Kamzës".



gjobës mendoj se do të ndikojë në parandalim. Nuk duam të dënojmë ata që kanë këto biznese, por duhet të mbrojmë interesin e shoqërisë.

Gert Bogdani: Më herët u tha se në këto shkolla të palicensuara mund të bëhet edhe trafikim organeve. Me këtë e ulët shumë nivelin e diskutimit të ligjit për arsimin parauniversitar. Se do të na vij Karla Del Ponte sërish në Shqipëri.

Valentina Leskaj: Qesh. Pa merak se nuk të vjen!

Gert Bogdani: Po ashtu siç folët ju edhe mundet. Unë nuk jam dakord për propozimin tuaj znj. Leskaj për të rritur nivelin e gjobës maksimale, është shumë e madhe për biznesin.

Valentina Leskaj: Nuk është

e madhe. Po përndryshe do të gabohet shumë rëndë

Gert Bogdani: Po do të kemi rrezikun për të mos i mbledhur fare këto gjoha. Pastaj nëse nuk janë me licensë fajin e ka kryetari juaj që nuk lejoji që të bëheshin në shkolla shkallët e emergjencës.

Valentina Leskaj: E kalojmë në votim atëherë. Dakord me propozimin tim për rritjen e gjobës? (PD kundër, rrezohet)

Gert Strazimir: Zonja Leskaj për procedurë! Kur votohet nuk mund të diskutohet. E parashikon Rregullorja e Kuvendit! Nëse nuk e dini është ajo me ngjyërë blu.

Ndërhym Shamku
Gert Strazimir: Zonja Kryetare edhe zonja po shkel rregulloren nuk të mori leje për marrjen e fjalës

ALBA TECH SYSTEM

HP DX5150
Monitor 17"

89 Euro

Processor AMD Athlon 64 2.19 Ghz
512 MB RAM
80 GB HARD DRIVE
DVD - Rom
Mouse dhe Tastjerë

Rr. Haxhi Dalliu,
P. 16, Shk. 1, Ap. 2,
përballë "ProCredit
Bank" Tiranë - Albania
Tel: 04 22 43 299
Cel: 067 400 31 38

Sisteme Sigurie
Audio
Telefonie
Aksesorë

+355 4 2269 049 • www.impact-al.com

IMPACT
electronic & professional

inkodër • lezhë • durrës • tiranë • eëbasan • berat • flet • vlorë

TOA Visonic EverFocus

KLINIKA RADOVANI

Nëse përgjigja është "po" drejtohuni tek "Klinika Radovani" për të zgjidhur problemin tuaj. Ofrojmë profesionalizëm dhe aparate dëgjimi dixhitale "Siemens", që janë më cilësorë në botë.

Tel: 042371735

Adresa: Rruga Hoxha Tahsin P.60/2/14, Tiranë
www.klinikaradovani.com

Probleme të rënies së dëgjimit?
Nevojë për volum të lartë të TV?
Vështirësi të ndjekjes së bisedave në grup?



Financat shesin bonot më afatgjata me interes 10 për qind

Për herë të parë, qeveria nxjerr në treg letra me vlerë më afat më të gjatë dhe më interes rekord të fitimit. Ministria e Financave njoftoi se sot, më datë 14 qershor, do të zhvillohen ankandet e obligacioneve shtatëvjeçare, si me kupon fiks, ashtu edhe të ndryshueshëm në Bankën e Shqipërisë. Ankandi 7-vjeçar me kupon fiks ka këto parametra: Data e

emetimit 18.06.2012, data e maturimit 18.06.2019 dhe shuma e përgjithshme e shpallur është 1 miliard lekë. Kuponi indikativ i ofruar nga ministria e Financave do të jetë 10% dhe interesi do të paguhet çdo gjashtë muaj, përkatesisht më datat 18 dhjetor dhe 18 qershor të viteve përkates. Ndërkohë, ankandi 7-vjeçar me kupon të ndryshueshëm ka këto të dhëna:

Data e emetimit 18.06.2012, data e maturimit 18.06.2019 dhe shuma e përgjithshme e shpallur është 1.5 miliard lekë. Edhe në këtë rast, interesi do të paguhet nga ministria e Financave çdo gjashtë muaj, përkatesisht më datat 18 dhjetor dhe 18 qershor. Interesi prej 10 përqindësh është më i larti i arritur deri tani dhe mund të jetë edhe më i lartë.

Vendim i Këshillit të Ministrave për 1.610 metra katrorë në Bularat të Dropullit

Jepet OK për varreza të tjera greke

Pas varrezave të ushtarëve grekë në Korçë, Përmet e Gjirokastrë, vijon "mbjellja" e territorin shqiptar me objekte që shpallen "në shërbim të mbrojtjes kombëtare"

Lajmi

Qeveria shqiptare u ka dhënë "zgjerim" varrezave të ushtarëve grekë të rënë gjatë Luftës së Dytë Botërore në territorin shqiptar, duke shtuar për këtë qëllim një truall 1.610 metra katrorë në Bularat të Gjirokastrës

TIRANE

GENC KONDI

Varrezat e ushtarëve grekë të rënë gjatë Luftës Italo-Greke në territorin shqiptar janë shtuar me një Vendim të Këshillit të Ministrave të 9 majit të këtij viti. Ky vendim ishte publikuar në faqen zyrtare të qeverisë, por pas specifikimit se trualli që jepej në pronësi të ministrisë shqiptare të Mbrojtjes kishte të bënte me një varrezë greke. Me publikimin në Fletoren Zyrtare, ku VKM tashmë ka hyrë në fuqi. Sipas këtij akti, të nënshkruar nga kryeministri Sali Berisha, është miratuar një shtesë në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ministrisë së Mbrojtjes, konkretisht një truall rreth 1.6 dymy në Bularat të Dropullit të Sipërm, shumë pranë kufirit shtetëror me Greqinë. Akti i referohet një planimetrie, të siguar nga gjeneral brigada Abaz Lleshi, komandant i Brigadës Mbështetëse Rajonale (BMR) ose Reparti Ushtarak 1320, me qendër në Tiranë. Kjo njësi kryen detyrat xhenjere të ushtrisë shqiptare.

Detyra për kryerjen e planimetrisë është dhënë që në muajin dhjetor të vitit 2008 nga vetë shefi i atëhershëm i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë shqiptare, në bashkëpunim me Komisionin e përbashkët shqiptaro-grek pranë ministrisë së Jashtme.

SPECIFIKIMI

Objekti nuk mjaftohet me pranimin e ndëtimimit të një




1. Pamje nga sateliti e varrezave të reja të përfunduara na Bularat (Dropulli i Sipërm) të ushtarëve grekë të rënë në Luftën e 2-të Botërore (Google Map)

2. Planimetria e varrezave të reja të Bularatit, me sipërfaqe 1.610 metra katrorë, miratuar nga Këshilli i Ministrave sipas paraqitjes nga Brigada e Mbështetjes Rajonale, nënshkruar nga komandanti i saj, gjeneral brigada Abaz Lleshi

3. Vendimi i qeverisë i datës 9 maj 2012 që përcakton kalimin në administrim të ministrisë së Mbrojtjes të territorit të varrezave të ushtarëve grekë

4. Varrezat ekzistuese të ushtarëve grekë në Grykë të Këlcyrës



VENDIM
Nr. 301, datë 9.5.2012

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHITËTËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR

Zona hapësinore		Niveli i parësor		Ekskluziviteti i pronës		Komponenti përbërës i pronës		Adresë vendndodhjeje e komponentëve përbërës		Përmasat e pronës sipas NUI		Funksioni për të cilin përdoret zona		Estat me përgjegjësi administrative		Estat përbërës, statusi juridik i përdoruesit		Të dhëna të tjera, shprehur në raportin e vlerësimit		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	
1120									Bularat, Dropull, Gjirokastrë		1610 m ²	Për vendosjen dhe mbrojtjen e ushtarëve të rënë gjatë Luftës së Dytë Botërore	Ministria e Mbrojtjes, Reparti Ushtarak 1320 (0448)	Brigada e Mbështetjes Rajonale (BMR), me qendër në Tiranë, datë 08.11.2011.						
Truall																				




varreza të re të ushtarëve grekë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas tabelës shoqëruese të VKM-së, të miratuar nga qeveria, emërtesa e pronës, që kalon tani e tutje në administrim të ministrisë shqiptare të Mbrojtjes është "Varreza (vendpreheje e ushtarëve dhe shtetasve të tjerë grekë)". Pra, nuk është fjala vetëm për banesën e fundit të grekëve me uniformë, që kanë luftuar kundër italianëve të vitet e para të konfliktit botëror, por edhe të "shtetasve të tjerë grekë", përfshijm që krijon kushte për lëshime të reja. Fusha e përdorimit të


pronës, një specifik tjetër që kërkon ligji për një pronë shtetërore, është përcaktuar gjithashtu me një term tjetër evaziv: Për mbrojtjen kombëtare. **PRECEDENTËT** Në fakt, sikurse dëshmon edhe fotoja nga sateliti, e marrë në Google Map, varrezat e Bularatit tashmë janë përfun-

duar dhe e re është vetëm detyra që qeveria i jep Mbrojtjes shqiptare të administrojë këtë objekt, pavarësisht se një e drejtë e tillë i njihet edhe Kishës Ortodokse. Në prill të këtij viti, në Shtëpinë Qendrore të Ushtrisë janë zhvilluar bisedime dypalëshe, ku është folur për zgjerim të

varrezave ekzistuese dhe, me sa duket, qeveria e ka miratuar një kërkesë të tillë. Një skandal jo i vogël është shënuar më parë me përdorimin e skeleteve të zhvarrosura në varrezën e fshatit të Kosinës në Përmet, për të mbushur varre të ushtarëve grekë.



SHKURA, 82 ORË PUNË NË BASHKI
Rezarta Shkurta, do të përballlet me 82 orë punë të detyrueshme në bashkinë e Tiranës në rast se do të dënohet nga gjykata e kryeqytetit. Masa prej 82 orë punë të detyruar është kërkuar gjatë pretendencës përfundimtare nga prokurori Ervin Karanxha, i cili i kërkoj gjyqtarit Gerd Hoxha që të shpallë të pandehur fajtorë dhe dënojë atë me punë të detyrueshme, për shkak të rahjes së Rozana Radit.



KOKAINA, KAPEN DY SHQIPTARË
Eglantian Hasa dhe Artan Bregu dy emigrantë shqiptarë në Itali janë arrestuar nga policia pasi transportonin një sasi droge. Operacioni për ndalimin e dy shqiptarëve është bërë në zonën e Astit dhe gjatë ndalimit atyre ju sekuestrua një sasi prej gjysmë kilogramë kokainë të cilësisë së lartë që nëse do kishte arritur në treg do sillte një fitim prej 100 mijë euro.

Dëshmia e të plagosurit para kryeministrit në 21 janar

Dybeli: Në 5 sekonda më qëlluan 2 plumba

"Kur hyri Benzi, unë jam qëlluar me armë"

LAJME SHKURT

Elbasan, kapet benzi me 20 kg marijuanë

Një makinë tip benz me targa AA 659 CE u zbulua në fshatin Hotolisht në Librazhd me 200 kilogramë marijuanë. Sipas të dhënave të policisë së Elbasanit mësohet se pas informacioneve të marra në rrugë operative policia u vu në ndjekje të makinës brenda të cilës u gjet edhe lëndë narkotike. Mësohet se shoferi dhe persona të tjerë që ndodheshin në mjet e braktisën atë bashkë me lëndën narkotike dhe u zhduken në drejtim të paditur. Nga ana e policisë u bë bllokimi i lëndës narkotike dhe automjetit, ndërsa vijon puna për identifikimin dhe kapjen e autorëve, që ishte duke transportuar lëndën narkotike.

I arrestuari, tregon 31 grabitjet në Tiranë

Një operacion i policisë së kryeqytetit i koduar "Banesat" ka vënë në pranga një 17 vjeçar si dhe ka shpallur në kërkim 3 bashkëpunëtorë të tij të akuzuar për 31 vjedhje të kryera në bane. Burime zyrtare nga policia thane se u vu në pranga 17 vjeçari me iniciale G.B i cili u kap në flagrancë duke vjedhur banesën e një shtetaseje, në rrugën "Medar Shtylla" në zonën Komuna e Parisit ndërsa u identifikuan dhe u shpallën në kërkim bashkëpunëtorët e tij 24 vjeçari Arjanit Muzhaja, 22 vjeçari Ervin Tavaxhi dhe 23 vjeçaria Amanda Pellumbi. Të ndaluarit akuzohen se në bashkëpunim me njëri-tjetrin, në mënyrë kronologjike gjatë vitit 2011-2012, dyshohen se janë autorë të vjedhjeve të 31 banesave në qytetin e Tiranës, duke përdorur mekanizmin e thyerjes së bravës.

Plagosje nga pakujdesia, pranga 37-vjeçarit

Një 37-vjeçar nga qyteti i Shkodrës ka përfunduar në pranga të policisë nën akuzën për plagosje dhe armëmbajtje pa leje. I arrestuari u identifikua si Tol Pjetri, banues në fshatin Muriqan. Arrestimi i tij u bë pasi pasditen e djeshme, në fshatin Muriqan Tol Pjetri ka plagosur me armë zjarri, nga pakujdesia 34-vjeçarit me iniciale P.M., banues në kampingun e roreve, në lagjen Salo Hallil Shkodër. Lidhur me këtë ngjarje u sekuestrua një pushkë model 54, të cilën Tol Pjetri e mbante pa leje dhe ndaj tij nisën hetimet për veprën penale "Plagosje e lehtë nga pakujdesia", "Mbatjeje pa leje të armëve luftarakë".

Lajmi

Administrohet dëshmia e parë në gjykatën e Tiranës për ngjarjen e 21 janarit. I plagosuri nga Tirana Artens Dybeli ka treguar se në demonstratë ai ishte ndodhur krejt rastësisht, dhe aty ka marrë dy plumba, një në shpatullën e djathtë dhe tjetrin në qafë. Fatmirësisht Dybeli nuk kishte pësuar dëmtime të rënda, ndërsa nuk ishte në gjendje të tregonte se kush e kishte qëlluar.

TIRANE

ELTON QYNO



Artens Dybeli dje në Gjykatën e Tiranës

Artens Dybeli, njëri nga personat e plagosur në demonstratën e 21 janarit ka hapur siparin e dëshmiave duke treguar momentin e plagosjes me dy plumba nga ana e Gardës së Republikës. Dybeli ka pohuar se në demonstratë kishte qëndruar vetëm 30 minuta, dhe se gjatë të shtënave me armë kishte perceptuar mendimin se plumbat ishin manovër dhe jo luftarakë. Në sallën e gjyqit Dybeli pohoi se një plumb e kishte marrë në qafë dhe një tjetër në shpatull, ndërkohë që nuk ishte në gjendje të përcaktonte se kush nga gardistët e kishte qëlluar, pasi ai nuk kishte parë njeri. Para gjykatës ai tregoi se në momentin e plagosjes ndodhej mes godinës së kuvendit dhe kullave Binjake.

tentoi të futej në kryeministri, diçka më pak se 5 sekonda unë jam qëlluar me dy plumba. Pastaj për momentin, nuk kuptova se me çfarë u qëllova dhe se në këtë kohë po dëgjoja zhurmë të madhe nga krismat e armëve, por të them të drejtët kam menduar se ishin plumba manovër, pasi kështu dëgjoja edhe nga persona të tjerë. Kur kam parë

Disa persona të panjohur më kanë ngritur në krahë dhe me një makinë të policisë Bashkiake

gjakom që po më ridhte kuptova që nuk ishin plumba manovër. Përkishtë në këtë moment po ndjeja që po humbisja ndjenjat, shoku që kisha me vehte nuk ishte aty pranë, por ndodhej gati tre metra larg nga unë. Tentova të thërrija atij për ndihmë, por nuk kisha fuqi. Pastaj disa persona të panjohur më kanë ngritur në krahë dhe me një makinë të policisë Bashkiake më kanë çuar në Spitalin Ushtarak. Koha ime në

demonstratën e 21 janarit ka qënë vetëm 30 minuta, unë vetëm kur jam afruar demonstratë kam qënë në mes të turmës dhe shikoja që po qëllonin me gurë nga të dyja palët, si nga njerëzit ashtu edhe nga policia. Nga momenti që jam qëlluar kam qëndruar pesë ditë në spital dhe më pas nuk mbaj mënd asnjë gjë rreth kësaj ngjarje dhe sdi çfarë të them për vrasjet apo plagosjet e tjera, pasi ato i kam mësuar më pas.

Prokurori: Dëshmitar mund të tregoni edhe një herë përpara gjykatës intenerarin tuaj nga momenti që keni qënë tek kullat binjake deri në momentin e plagosjes. Pra çfarë intenerari lëvizje keni bërë atë ditë?

Atëherë në momentin e parë që unë jam takuar me shokun tim Erald Karaj, tek trotuari i piramidës dhe se duke qënë se gjendja po përkeqësohej shumë ketej, menduan që të tërhiqemi dhe të kalojmë në anën tjetër të bulevardit, nga Kullat Binjake. Kemi kaluar direkt drejt, në trotuarin e Kullave Binjake, dhe më pas aty jemi spostuar më djathtë në rrugën që ndodhet tek Gjykata Kushtetuese.

DËSHMITARËT E 21 JANARIT

- Fatos Mahmutaj
- Ened Janina
- Fatos Skeja
- Zabit Deda
- Besnik Bare
- Tom Doshi
- Paulin Sterkaj
- Anton Deda
- Dritan Pepaj
- Erald Bisha
- Pjerin Ndreu
- Zef Rroku
- Zefshin Shabani
- Joan Ninaj
- Preng Ndrevojatj
- Refat Ismaili
- Arben Nika
- Edmond Marselaj
- Shpëtim Bismakaj
- Shpëtim Mutkaj
- Qani Hasa
- Arben Dako
- Durim Tabaku
- Kastriot Jahja
- Xhelal Krasniqi
- Genta Dervishi
- Artan Hoxha
- Learit Gjoka
- Ajet Xhindolli
- Ilir Sula
- Shazime Bukaçi
- Arben Çuko
- Ilmi Hoxha
- Agim Fuga
- Aurora Allkanjari
- Olsi Karapiçi
- Ergis Tahiri
- Sul Cara
- Surja Ahmetaj
- Përparim Bashukaj
- Ilir Duraku
- Sokol Sheha
- Përparim Pane
- Amarildo Juca
- Armando Gele
- Klodian Goga
- Erlind Selimi
- Ervin Sylaj
- Andi Ruçaj
- Armando Dani
- Amarildo Data

Prokurori: Ju dhe shoku juaj Karaj në 21 janar kishit gjë me vehte në duar, si shkopinj, gurrë apo diçka tjetër.
Absolutisht unë kisha vetëm një çadër me vehte sepse ishte dhe ditë shiu, ndërsa shoku im nuk kishte asnjë gjë. Ne thjesht nuk shkuam për dhunë, por për tu takuar për të pirë kafe dhe për të parë demonstratën.

Prokurori: Në këtë intenerar lëvizje që ju sapo shjeguat a mund ta lidhësh me momentin se kur kanë filluar qitjet me armë. Pra duke pasur parasysh, intenerarin, Piramidë, Kulla Binjake, trotuar dhe zbritja poshtë në të djathtë.
Në momentin kur unë jam takuar me shokun tim, të shtënat e armëve kishin filluar. Pra kur kam shkuar unë i kam gjetur krismat. Gjëndja po acarohej shumë dhe se nga krismat të gjithë mendonin se janë plumba manovër, për të qënë më të sigurt unë dhe shoku im u tërhoqëm duke kaluar sipas intenerarit që ju tregova. Krismat vashdonin në ajër apo drejt, pasi unë nuk e dija se në çfarë ore janë plagosur të tjerët.

Prokurori: A mund të shpjegoni dëmtimet, në çfarë pjese të trupit i keni patur?
Atëherë një plumb më është futurë në qafë (tregon me gisht qafën) dhe ka përshkuar një distancë gati 6 ose 7 centim dhe ka dalë këtu matanë, prapa qafës. Ndërsa një tjetër e kam në shpatullën e djathtë.

Prokurori: Po personat që ndodhen në bankën e të akuzuarve i njihni, i keni parë në 21 janar?
Jo nuk i njoh, si kam parë asnjëherë. Nuk mund të akuzoj njeri se kush më ka qëlluar.

FISIOMED OFRON SHERBIME FIZIOTERAPIE PROFESIONALE NE NJE AMBIENT KOMOD DHE MODERN. EKSPERIENCA PERENDIMORE DHE APARATURAT E GJENERATES SE FUNDIT JANE TASHME PRANE JUSH. BESOJANI SHENDETIN TUAJ FIZIOTERAPIE PROFESIONALE

FISIOMED

Adresa: Rruga e Barrikadave 18/2, Galeria e Tiranës Ish Kinema 17 Nentori, Kat 3
Tel: +355 42 400 418 / Cel: +355 69 20 533 30;
E-mail: info@fisiomedal.com / Web: www.fisiomedal.com

- Hernie diskale
- Paralizat e ndryshme
- Spondiloztrozot
- Marrje mendsh

- Bursitin
- Enjlljen e krahut
- Tendinitin
- Dhimbjen e nofules

- Skoliozen
- Celullitin
- Traumat e gjurit
- Para dhe mbas lindjes



EKONOMI

Greqi, "arratisen" depozitat bankare 500 mln euro/ditë

Pak ditë para se të zhvillohen zgjedhjet parlamentare, qytetarët grekë kanë rritur ritmin e tërheqjes së depozitave të tyre pranë bankave të vendit, raportojnë bankierët, sipas agjencisë ekonomike të lajmeve Bloomberg. Tërheqjet ditore, nga 100 milionë euro, që ishin deri para pak ditësh, këtë javë kanë shënuar një ritëm konstant mesatar prej rreth 500 milionë

eurosh, thanë ata. Këto shifra nuk janë zyrtarizuar nga Banka qendrore e Greqisë. Ndërkohë, një tjetër bankier që nuk pranoi të citohej me emër, deklaroi se ditën e martë janë tërhequr në gjithë vendin rreth 700 milionë euro. Me një ritëm të tillë, është shënuar rekord në këtë drejtim që nga fillimi i krizës. Aktualisht, është llogaritur se janë

tërhequr rreth 72 miliardë euro nga sistemi bankar grek që nga fillimi i krizës, më tetor të vitit 2009. Depozituesit janë të siguruar nga Banka Qendrore Evropiane, por frika ekziston në faktin se, po doli vendi nga eurozona, BQE nuk i ndihmon dot më, ndërkohë që, në kuadrin e një rikthimi të mundshëm tek dhrahmia, depozitat do të zhvlerësoheshin shumë.

Pas këmbënguljes nga Tirana për çmimet referencë

Lajmi

Ministria e Tregtisë e Kosovës ka vendosur një tarifë jashtëzakonisht të lartë prej 35 përqindësh për zhdoganimin vetëm të çimentos që vjen nga Shqipëria. Kjo është përgjigja për referencën shqiptare ndaj patates

Kosova fillon "luftën e çimentos"

Dy shtetet shpëfillin rregullat e CEFTA-s

TIRANE

GENC KONDI



Fabrika e çimentos në Han të Elezit Kosovë SharrCem

Përplasja

Qeveria e Kosovës ka patur një premtime nga kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, se aplikimi i çmimit referencë për patatet do të zvogëlohet në masë të madhe për Kosovën, por asgjë nuk lëvizti realisht

Kosova hakmerret me të njëjtën monedhë ndaj qeverisë shqiptare, për bllokimin që ka bërë për hyrjen e mallrave kosovare në Shqipëri. Ndonëse Shqipëria aktualisht ka kryesinë e organizatës së tregtisë së lirë CEFTA, ku bëjnë pjesë të dy vendet, ministria e Tregtisë Mimoza Kusari-Lila ka vendosur të "bllokojë" hyrjen e çimentos së Shqipërisë në Kosovë. Sipas saj, kompanitë që e importojnë nga vendi ynë këtë mall, lëndë të parë të rëndësishme për sektorin e ndërtimit, duhet të paguajnë një tarifë prej 35% të vlerës së importuar dhe kjo bëhet për të mbrojtur prodhimin e vendit. Pra, është vendosur një normë tejet e lartë e çmimit të referencës, ashtu sikurse ministria shqiptare e Financave ka vendosur për patatën e prodhuar në Kosovë.

Kompania e vetme prodhuese e çimentos në Kosovë është "SharrCemi", që është në pronësi të kompanisë greke "Titan". Nga kjo masë më së shumti do të preket fabrika e çimentos e Fushë-Krujës, në pronësi të libanezëve, e cila ka dominuar deri tani tregun e Kosovës. Sipas të dhënave të Doganës së Kosovës, nga Shqipëria gjatë vitit 2011 u importuan rreth 226.000 ton çimento, me vlerë rreth 14 milionë euro, duke bërë që ky mall të ndikojë ndjeshëm në vlerën e eksportit shqiptar në Kosovë. Ndërsa gjatë tremujorit të parë të vitit 2012 u importuan nga Shqipëria në Kosovë vetëm 102 ton çimento, si rezultat i kësaj mase.

PARALAJMËRIMI

Në mars të këtij viti, zëvendësrymënistria e Kosovës, Mimoza Kusari-Lila, ka paralajmëruar Maqedoninë e Shqipërisë se qeveria e Kosovës nuk do të rrijë duarkryq në rastet kur ato po vendosin

barriera tarifore e jotarifore për prodhimet kosovare. Ajo ka paralajmëruar se do të përdorë masa të njëjta edhe për prodhuesit e vendeve që po i pengojnë eksportet e Kosovës. "Me politikën të cilën janë duke e udhëhequr po na shtynjë që edhe në të aplikojmë masat adekuatë edhe ndaj prodhuesve të tyre", ka thënë Kusari-Lila.

Me gjithë premtimet e

shumta dhënë nga udhëheqësit e qeverive të dy vendeve, patatet e prodhuara në Kosovë po vazhdojnë të jenë jokonkurrense në Shqipëri për shkak të çmimit të referencës që po e aplikon ky shtet. Shqipëria prej shumë kohë aplikon çmim të lartë referencë për patatet e prodhuara në Kosovë. Ministria ka thënë se kanë pasur një premtime nga kryeministri i Shqipërisë, Sali

Berisha, se aplikimi i çmimit referencë për patatet do të zvogëlohet në masë të madhe për Kosovën, krahasuar me shtetet e tjera, por asgjë nuk ka lëvizur realisht.

Qeveria e Kosovës mund të ankohe ndaj Shqipërisë në CEFTA (marrëveshja e tregtisë së lirë) për shkelje në aplikimin e çmimit të referencës për patatet.

Por përveç paraqitjes në instancat më të larta rajonale, ministria e Tregtisë ka përmendur edhe mundësinë që Kosova të vendosë çmime të referencës për prodhimet e Shqipërisë. Me sa duket, me rritjen e referencës për çimenton, Kosova ka vendosur ta bëjë realitet një kërcënim të tillë.

PYETJE PERGJIGJE

Si mund të shpjegohet kjo shkelje e angazhimeve të Kosovës, të marra me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes së tregtisë midis dy vendeve?

Kosova e di mirë që çdo gjë që bie ndesh me marrëveshjen do të shkojë si ankesë në sekretariatit të CEFTA-s. Vendimi i saj për të taksuar kaq rëndë një produkt shqiptar është i hapur dhe i menduar mirë. Kur Shqipëria të ankohe, do të dalë se ajo e ka shkelur më parë marrëveshjen me taksimin e patates, verës, etj produkteve kosovare. Mund të mendohet se ky është një hap i qëllimshëm.

A ka edhe interesa të tjera në lojë?

Këtu mund të bëhen vetëm hipoteza, por vendimi i leverdis kompanisë greke "Titan", e cila zotëron të vetmen kompani prodhimi të çimentos në Kosovë dhe një tjetër subjekt në Shqipëri.

LAJMË SHKURT

Ulen me 17 për qind shpenzimet e shqiptarëve jashtë
Në tremujorin e parë të vitit 2012, shpenzimet e shqiptarëve për udhëtime jashtë vendit kanë rënë me rreth 37 milionë euro (17%), duke arritur në 181 milionë euro, ndër nivelet më të ulëta të viteve të fundit. Ngadalësimi i rritjes ekonomike, i shoqëruar me mosrritje të pagave, apo rritje të papunësisë në tremujorin e parë 2012 ka shtuar pasqirën e shqiptarët, të cilët kanë preferuar që dhe t'i kursejnë paratë që kanë, e reflektuar kjo në rritjen e depozitave, të cilat në fund të prillit 2012 shënuan një zgjerim me bazë vjetore prej 10%. Ndërkohë, të huajt kanë shpenzuar rreth 5% më shumë para në muajt e parë të këtij viti.

Tarifa 5 euro për Kukësin, operatorët gati rritje çmimi
Vendosja e taksës prej pesë eurosh për kalimin në rrugën Durrës-Kukës-Morinë do të rëndojë dyfish në xhepat e qytetarëve. Sipas drejtuesve të furgonave që përkohë çdo ditë këtë aks, tarifa është shumë e lartë dhe ata shprehën se do të ndikojë direkt në rritjen e çmimit të biletave për pasagjerët, nga 600 lekë, që është aktualisht, në 700 deri 1.000 lekë. Sipas tyre duhet të ishte llogaritur një tarifë shumë më e ulët se kaq. Në muajin shkurt të këtij viti ministria e Transporteve nisi procedurë për të dhënë me konsencion mirëmbajtjen e "rrugës së kombit". Mirëmbajtja e këtij aksi kërkon fonde, që qeveria nuk mund t'i përballojë, pasi llogaritet në 10-20 milionë euro në vit.

Rifillojnë bisedimet për dy licensat e tjera 3G
Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP) ka nisur fazën e konsultimeve për dhënie e dy licensave të tjera 3G. Këto diskutime nisnin pas dështimit të dhënies së licensës së tretë 3G gjatë tenderit të zhvilluar nga AKEP në muajin shkurt. Më parë, licencën 3G e kanë fituar operatorët e celularëve Vodafon Albania, në fillim dhe Albanian Mobile Communication më tej, ndërsa Eagle Mobile dhe Plus Communication morën pjesë në tenderin e zhvilluar gjatë muajit të dytë të këtij viti, por pa plotësuar kriteret financiare për çmimin.

Shpronësimet

Publikimi, pagesat në 30 ditë

TIRANE

Këshilli i Ministrave ka vendosur që, pas publikimit në media të një njoftimi për shpronësim për interes publik të pronës private, brenda 30 ditëve kalendarike të kryhet pagesa nga administrata për një shërbim të tillë. Deri tani, ka patur shumë raste që pagesat janë vonuar me vite. Me VKM nr. 336, datë 16 maj 2012, është përcaktuar që ministritë kompetente për shpronësimin duhet t'i drejtojnë kërkesë me shkrim medias së shkruar, gazetave me tirazh kombëtar për botimin e njoftimit respektiv. Subjekti gëzon të drejtën t'i kërkojë medias që njoftimi të mos botohet në faqe gazete që përmbajnë lajme të kro-



nikës së zezë, reklama me natyrë komerciale apo imazhe që cenojnë rëndë shtrësit e marxhinalizuara të shoqërisë. Subjekti mediatic, jo më vonë se tri ditë pune nga përmbushja e botimit, i përcjell me shkrim subjektit kërkesë tri

kopje të gazetave përkatëse për secilin numër botimi të kërkuar. Likuidimi i faturës për botimin e njoftimit publik kryhet brenda 30 ditëve kalendarike nga plotësimi i kërkesës dhe kostot duhet të mbulohen nga kërkuesi i procedurës së shpronësimit.

Ministritë kompetente për shpronësimin duhet të përfshijnë në vendimin e propozuar për miratim të Këshillin e Ministrave për shpronësimin edhe koston e publikimeve.

Për të gjitha publikimet në gazeta kombëtare para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kostot e të cilave ende nuk janë likuiduar, qeveria vendos të kryhen pagesat brenda 30 ditëve kalendarike pasi të kenë siguruar kopje të botimeve.



Provimet e lirimimit

VLERËSIMI Shpallja e rezultateve do të bëhet 15 ditë pas ditës së dhënies së provimit

Klasa IX, si zgjidhet testi i Gjuhës

Ministria e Arsimit publikon variantin e zgjidhur për të 25 pyetjet e provimit të parë. Rezultatet për rreth 56 mijë nxënës dalin pas dy javësh, mbetësit do masin dijet në vjeshtë

TIRANE
Rreth 56 mijë nxënës të të gjitha shkollave 9-vjeçare në vendit, u nënshtuan dhe provimit të Lirimimit për lëndën

e Gjuhës Shqipe dhe Leximit. Për t'u ardhur në ndihmë kësaj kategorie nxënësish, MASH ka publikuar përgjigjet e sakta që duhet të jepnin nxënësit për 25 pyetjet. Provimi filloi në orën 10:00 dhe procesi, i cili zgjati 2 orë e

gjysmë, u zhvillua normalisht. Në provim morën pjesë rreth 56 mijë nxënës në të gjithë vendin, të vendosur në rreth 700 mjediste të përgjithshura nga Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore. Testi i Matematikës

përbante 25 kërkesa nga të cilat 13 me alternativa dhe 12 me zhvillim. Pranë çdo Drejtoritë Arsimore në vend është ngritur një komision vlerësimi me mësuesit më të mirë, të trajnuar nga Agjencia e Vlerësimit të Arritjeve

(AVA) dhe Drejtoritë Arsimore. Procesi i provimit të Gjuhës Shqipe u monitorua dhe do të zhvillohet nga Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar (IKAP) dhe të gjitha Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore në

vend. Provimet e Lirimimit janë një "maturë" për nxënësit e klasave të 9-ta pasi mënyra e hartimit të testit, e zhvillimit të provimit dhe i korrigjimit të tyre është e ngjashme me atë të Maturës Shtetërore.

SKEMA E VLERËSIMIT
PROVIMI I LIRIMIT 2012
SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT
PËJESA I
Pyejta 1 A 1 pikë
Pyejta 2 D 1 pikë
Pyejta 3 B 1 pikë
Pyejta 4 C 1 pikë
Pyejta 5 D 1 pikë
Pyejta 6 C 1 pikë
Pyejta 7 A 1 pikë
Pyejta 8 (a) 2 pikë

SKEMA E VLERËSIMIT
Përfytyrimi:
Kontrasti i krijuar shërben për të theksuar ndryshimin midis së bukurës, që gjendet në natyrën e pasatë dhe të abstrakteve dhe ndoshta, zhurmave, ajrit të papastë që kemi shikuar në vetë.
Pyejta 8 (b) 2 pikë
Pyejta 9 D 1 pikë
Pyejta 10 A 1 pikë
Pyejta 11 (a) 2 pikë

SKEMA E VLERËSIMIT
PËJESA II
Pyejta 9 D 1 pikë
Pyejta 10 A 1 pikë
Pyejta 11 (a) 2 pikë
Pyejta 12 (b) 3 pikë

SKEMA E VLERËSIMIT
Gjuhë shqipe
Raporti i vajtës me luamin
Pyejta 12 (a) 1 pikë
Pyejta 13 (b) 3 pikë

SKEMA E VLERËSIMIT
Gjuhë shqipe
Përfytyrimi (përgjigje e lirë):
Pyejta 13 (a) 2 pikë
Pyejta 13 (b) 1 pikë

SKEMA E VLERËSIMIT
PËJESA III
Pyejta 14 D 1 pikë
Pyejta 15 C 1 pikë
Pyejta 16 2 pikë
Pyejta 17 1 pikë
Pyejta 18 Gjinja: mashkullorë
Pyejta 19 1 pikë
Pyejta 20 2 pikë
Pyejta 21 2 pikë
Pyejta 22 1 pikë
Pyejta 23 C 1 pikë
Pyejta 24 D 1 pikë
Pyejta 24 (b) 1 pikë
Pyejta 25 6 pikë

SKEMA E VLERËSIMIT
Pyejta 13 (c) 2 pikë
Pyejta 14 D 1 pikë
Pyejta 15 C 1 pikë
Pyejta 16 2 pikë
Pyejta 17 1 pikë
Pyejta 18 Gjinja: mashkullorë
Pyejta 19 1 pikë
Pyejta 20 2 pikë
Pyejta 21 2 pikë
Pyejta 22 1 pikë
Pyejta 23 C 1 pikë
Pyejta 24 D 1 pikë
Pyejta 24 (b) 1 pikë
Pyejta 25 6 pikë

Kriteret e vlerësimit
KRITERI I: SHITJELIMI IDESË 2 pikë
KRITERI II: STILI DHE ORIGINALITETI 1 pikë
KRITERI III: STRUKTURA 1 pikë
KRITERI IV: SAKTESIA GJUHËSORE 2 pikë



DHURUESIT E GJAKUT
 "Çdo dhurues është një hero". Është kjo motoja e Ministrisë së Shëndetësisë për të mbështetur et gjithë ata që dhurojnë gjak. Ministri i Shëndetësisë, gjatë ditës botërore të dhurimit të gjakut ka deklaruar se Shqipëria shënon një histori suksesi, ku brenda një periudhe të shkurtër ka arritur që 85% e dhuruesve të jenë vullnetarë.



MASH UDHËZON UNIVERSITETET
 Ministria e Arsimit kërkon nga universitetet publike dhe private të vendit që t'i përshtatin ofertat e studimeve me ato të tregut të punës. Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës ka përgatitur një paketë rekomandimesh për universitetet mbi orientimin e programeve të studimit dhe përcaktimin e kuotave të studentëve, në mënyrë që secili universitet publik të krijojë një profil unik.

"E papranueshme, të jepen njohuri për devijimet personale"

Myslimanët kundër LGBT në shkolla

Agron Hoxha: "Avokati" të mbrojnë të ngujuarit



Agron Hoxha

Lajmi

Deputeti Leka

Kundër njohurive të LGBT në shkolla

Komuniteti Mysliman në Shqipëri e shikon si absurde kërkesën e "Avokatit të Popullit" për përfshirjen e njohurive mbi LGBT në tekstet shkollore. Për ta është e papranueshme që fëmijët, në librat shkollore, në vend që të marrin një edukim të shëndoshë të mësojnë se një familje mund të përbëhet nga dy prindër të së njëjtës gjini.

Deputeti i Partisë Socialiste, Agim Leka është shprehur kundër futjes së lëndës që do të ketë njohuri mbi komunitetin LGBT (Lesbikë, gay, biseksual dhe transgjor). Referuar kërkesës së "Avokatit të Popullit", Igli Totozani për të sjellë një risi në programin mësimor, ka irrituar deputetin Leka, i cili e ka vlerësuar si të tepruar këtë kërkesë, pasi nuk mundet që fëmijët në shkolla të marrin njo-



Agim Leka

huri të tilla. Dua ti referohem Aristotelit ku thotë se "Ne fëmijët i ojtmë nëpër shkolla për tu bërë të mirë, të zgjuar dhe të edukuar". Nuk mundet që në të fusim edhe këtë lëndë, pasi ne na është kërkuar edhe nga komuniteti fetar të futen programe mësimore me njohuri mbi fetë. Jam kundër nismës së Avokatit të Popullit. Nuk mund ta perceptoj dot se si do ti rrisim brezat"

AMBASADA AMERIKANE

Dy ditë seminare për çështjet LGBT

Sot dhe nesër, Ambasada amerikane do të mbështesë një aktivitet sensibilizues të organizuar nga Ambasada Pink dhe LGBT pro. Në këto aktivite jo vetëm që do të flitet për çështjet kundër diskriminimit të këtij komuniteti, por gjithashtu do të mund të vlerësohen edhe disa nga shpërndahen edhe tre çmime për gazetarë që me shkrimet e tyre kanë ndihmuar që kjo kategori personash të mos shikohet si e ndryshme dhe e "çuditshme", por të pranohet ashtu siç janë. Edhe çmimet që do të shpërndahen janë mundësuar nga ambasada e SHBA-ve në Tiranë.

TIRANE
ESMERALDA KETA

Agron Hoxha, drejtor i marrëdhënieve me publikon në Komunitetin Mysliman Shqiptar në një intervistë për "Shqiptarja.com" shprehur se "Avokati i Popullit", ndoshta duhet të dalë nga zyra e tij dhe të ngrejë zërin për ata që nuk kanë zë, siç janë fëmijët e ngujuar. Kjo pasi sipas tij, çështja e LGBT nuk është i vetmi problem që kanë shqiptarët.

Zoti Hoxha, "Avokati i Popullit" i ka rekomanduar Ministrisë së Arsimit që të përfshijë në kurrikulat mësimore njohuritë për LGBT, në mënyrë që ata të mos rriten në një mjedis diskriminues. Ju si komunitet mysli-man si i duket kjo kërkesë?

Ne u njohëm sot nëpërmjet medias për letërnë funderit që "Avokati i Popullit" i ka dërguar ministrit të Arsimit. Dhe në fakt argumentin tim dua ta filloj pak më herët, kur komunitetet fetare kërkuan në komision të Edukimit futjen e një lënde informuese mbi kulturën fetare në kurrikulat e arsimit parauniversitar, si lëndë me zgjedhje. Fillimisht gjeti edhe mbësht-

etjen e MASH, por më pas u rrëzua. Ajo që dua të them është se për ne si komunitet kjo nismë e "Avokatit" është absurde, në disa dimensione.

Përse i duket absurde?
 Komuniteti LGBT kishte iniciuar një aktivitet më 17 maj dhe që nxori në pah që në fakt ata nuk janë një shtresë aq e diskriminuar, apo aq në nevojë. Gjë që ka të bëjë edhe me objektin e punës së "Avokatit të Popullit". Ai duhet të jetë amplifikator i shtresave më në nevojë të shoqërisë. Në këtë kontekst, nuk ka si të mos na

Dhe në këtë kontekst komuniteti LGBT, në raport të zhdrejtë me numrin e tyre, zërin ua kemi dëgjuar më tepër se sa ç'duhet.

Sipas jush "Avokati i Popullit" nuk duhet të merret me të drejtat e LGBT?

Gjatë muajve të fundit kemi pasur rastin të shikojmë se LGBT, kanë avokatë mjaft të mirë e mjaft të njohur që i mbrojnë, ndërsa "Avokati i Popullit" duhet të jetë avokat i shtresave që nuk ka kush t'i mbrojë, ndaj kjo kërkesë e tij na duket sa absurde, aq edhe

qesharake. Këtë e them edhe sepse në vendin tonë kjo kategori nuk diskriminohet. Ata kanë jetën e tyre, jetojnë siç duan vetë dhe thjesht ata nuk duhet t'i përzihen shumë shtresës tjetër. Ne mbrojmë idenë tonë që kjo lloj sjellje është një antivlerë, që meqë ekziston do ta pranojmë ashtu siç është dhe jo ta diskriminojmë, por ama që të futen edhe në librat shkollore më duket tejet absurde.

Ju si komunitet a e mbështesin idenë që në libra t'futen edhe njohuritë për LGBT?

Absolutisht jo. Në shkollë duhet të jepet një edukatë e shëndoshë, mbi normat e shëndosha të familjes dhe jo e kundërta, pasi familja është garantuesja e vetme e vijimit. Unë kam tre fëmijë që dua t'i çoj në shkollë publike. Dhe unë nuk pres që fëmija im të mësojë aty, që në një familje, ndryshe nga ajo që ka në shtëpi dhe që përbëhet nga babai dhe nëna mund të përbëhet edhe nga dy prindër burra, ose femra. Për ne është tejet e papranueshme, që fëmijët tanë, në shkollat publike të marrin një informacion mbi devijimin personal apo familjar

të një bashkësie të kufizuar të shoqërisë. Ne duhet të ndajmë vlerat nga antivlerat dhe "Avokati" të jetë amplifikator i vlerave.

Ju a do të keni ndonjë reagim zyrtar pranë MASH apo "Avokatit të Popullit"?

Besoj se MASH, ka maturinë dhe përkrahje dhe nevojshme që kësaj nisme t'i japë përgjigjen e duhur. Natyrisht ajo do ta marrë me seriozitet pasi është një kërkesë që i vjen nga një tjetër institucion kushtetues, por besoj se do të jetë në lartësinë e duhur që t'i japë një përgjigjen e merituar një nisme të tillë.

Ujësjellësi

Tirana "jo thatësirë" këtë verë

TIRANE

Brenda datës 15 qershor do marrë fund problemi i ujit të pijshëm për 50.000 banorë të Tiranës, të cilët nuk do të vuajnë thatësi në gjatë verës. Kjo pasi, drejtorja e Ujësjellësit të Tiranës po përfundon fazën e parë të investimeve në rrjetin e ujësjellësit, pikërisht në një zonë të Kodrës së Priftit, Unazës së Re dhe Kinostudios. Ky ka qenë premtimi i Drejtorit të Ujësjellës-kanalizimeve të Tiranës, Sait Dollapi gjatë ditës së djeshme. Dollapi u shpreh se problemi i ujësjellësit ka marrë fund



dhe se faji mbetet tek administrimi i vetë qytetarëve. Sipas tij në fillim të muajit korrik do fillojnë ndërrhyjet

edhe në disa zona të tjera. Gjithashtu drejtori i UKT-së, Dollapi i bëri thirrje të gjithë qytetarëve që të marrin masa për shlyerjen e detyrimeve dhe plotësimin e dokumentacioneve ligjore pasi në të kundërt do të ketë penalizime dhe ndërprerje të shërbimit të ujësjellësit. Drejtori i Ujësjellësit të Tiranës, Sait Dollapi, deklaroi se paralelisht me shtimin e tubacioneve të reja, po vendosen edhe matësat, për të luftuar informitetin. Ndërkohë, ka nisur edhe faza e dytë e investimeve, po në këto zona, si dhe në Sharrë e Allias. Këto punimet pritet të përfundojnë në vjeshtë.



Si ta kuptoj nëse fëmija im ka ADHD

Asnjë skaner i kokës apo analizë gjaku Anuk mund ta diagnostikojë ADHD-në. Diagnoza vendoset me një ekzaminim nga një mjek profesionist i cili...

Faqe 15

Gjithçka që duhet të dini mbi mjekimin e ADHD

Barnat stimulante, gjenden në formë Farmaceutike me kohëzgjatje të shkurtër dhe të gjatë. Format me kohë të shkurtër merren 2-3 herë në ditë...

Faqe 16



Botim zyrtar i Fakultetit të Mjekësisë, Universiteti i Tiranës
Adresa: Fakulteti i Mjekësisë, Nr.371, Cel: 069 63 46688, E-mail: suplementi@almedicus.org

SUPLEMENTI MJEKESOR

ALMEDICUS



Nr.19

BOTIM I PËRJAVSHËM I GAZETËS SHQIPTARJA.COM

E ENJTE 14.06.2012

GJYSMA NUK DIAGNOSTIKOHEN DHE MJEKOHEN NE KOHE

7% e nxënësve, të shkollave me ADHD

Fëmijët me ADHD, hiperaktiv dhe impulsiv

DR.BUJAR ÇAKANI

Nivelet e larta të aktivitetit dhe periudhat e shkurtra të mungesës së vëmendjes janë pjesë normale e fëmijërisë për shumë fëmijë, por për ata me ADHD, hiperaktiviteti dhe mungesa e vëmendjes ndikojnë dukshëm në jetën e përditshme. Simptomat e ADHD zakonisht fillojnë të shfaqen në moshën 3 ose 4 vjeçare dhe vijnë duke u përkeqësuar. Të qëniet hiperaktiv dhe impulsiv kulmon në moshën 6 ose 7 vjeç: aktiviteti i shtuar zakonisht moderohet në moshën e adoleshencës, por impulsiviteti mund të zgjasë deri në moshë të rritur. Çdo fëmijë bëhet i lëvizshëm me kalimin e kohës dhe kryesisht djemtë shpërthejnë në energji që është e vështirë të kontrollohet. Është e zakonshme për fëmijët të "zhyten..." Faqe 14-18



Neurologji

Faqe 19



Myastenia gravis: Simptomat dhe mjekimi

Myastenia Gravis vjen nga latinishtja dhe greqishtja dhe do të thotë "dobësim i rëndë muskular". Në mënyrë që muskujt tanë të funksionojnë, sinjalet elektrike dërgohen nga truri në pjesët fundore të nervave. Kur këto sinjale arrijnë fundet nervore, ata stimulojnë çlirimimin e një lënde kimike (neurotransmetues) i quajtur acetilkolinë...

Këshilla

Faqe 20



Konsumi i kafesë, ja 14 përfitimet

Kafeja përfaqëson pijen aromatike më të konsumuar në të gjithë botën. Efektet e saj të mira apo të dëmshme për organizmin janë vënë në pikëpyetje që në lashtësi. Duke u bazuar në studimet e kohëve të fundit, nuk ka asnjë arsye për ta braktisur kafënë, pasi efektet e saj dobiprurëse janë më të mëdha se efektet e dëmshme. Kafeja...

Drejtor:

Taulant MUKA

Kryeredaktore:

Jana NANO

Zv/Kryeredaktore:

Fjorda KOROMANI

Redaksia:

Armina Avdulaj

Besiana Balla

Blerita Dollaku

Dea Qirjaqi

Erklida Sula

Isid Xhura

Kledia Dimroci

Miralda Gina

Këshilli botues:

Departamenti i Shëndetit Publik

Enver ROSHI

Shërbimi i Endrokrinologjisë, QSUT

Agron YLLI

Shërbimi i Urgjencës, QSUT

Edmond ZAIMI

Shërbimi i Nefrologjisë, QSUT

Arjana STRAKOSHA

Shërbimi i Reumatologjisë, QSUT

Argjend TAJFAJ

Shërbimi i Alergologjisë, QSUT

Etleva QIRKO

Shërbimi i Kardiologjisë, Spitali Ushtarak

Gerta KOÇEKU

Shërbimi i Neurologjisë, Spitali Ushtarak

Fatos JAHO

Shërbimi i Ortopedi-Traumologjisë, Spitali Ushtarak

Gjergj ÇAUSHI

Shërbimi i Toksikologjisë, Spitali Ushtarak

Zyhni SULAJ

Biokimi Klinike, QSUT

Ndok MARKU

Farmac

Leonard DEDJA

Shëndeti mendor

SIMPTOMAT e ADHD zakonisht fillojnë të shfaqen në moshën 3 ose 4 vjeçare dhe vijnë duke u përkeqësuar

DR. BUJAR CAKANI

7 përqind e nxënësve të shkollave janë me ADHD

Dr. Cakani: Fëmijët me ADHD, hiperaktiv dhe Impulsiv

Nivelet e larta të aktivitetit dhe periudhat e shkurtra të mungesës së vëmendjes janë pjesë normale e fëmijërisë për shumë fëmijë, por për ata me ADHD, hiperaktiviteti dhe mungesa e vëmendjes ndikojnë dukshëm në jetën e përditshme. Simptomat e ADHD zakonisht fillojnë të shfaqen në moshën 3 ose 4 vjeçare dhe vijnë duke u përkeqësuar. Të qenit hiperaktiv dhe impulsiv kulmon në moshën 6 ose 7 vjeç: aktiviteti i shtuar zakonisht moderohet në moshën e adoleshencës, por impulsiviteti mund të zgjasë deri në moshë

ADHD nuk shkaktohet nga pakujdesia Prindërore nga problemet familjare, mësuës të dobët

të rritur. Çdo fëmijë bëhet i lëvizshëm me kalimin e kohës dhe kryesisht djemtë shpërthejnë në energji që është e vështirë të kontrollohet. Është e zakonshme për fëmijët të "zhyten në ëndrra" duke shmangur aktivitetet të tjera gjatë ditës. Disa duken të jenë të organizuar dhe etiketohen si "harraqë". Disa të tjerë janë gjaknxehtë në situatat e përditshme jetësore. Por ADHD është më shumë se të qenit çapëkn. Ai përbën një çrregullim të rëndësishëm mjekësor që e vështirëson procesin e të mësuarit të fëmijës në shkollë si dhe luan një rol kritik në dëmtimin e socializimit ndërpersonal.

Kush mund të ketë ADHD?

ADHD është një problem mbarëbotëror që prek fëmijët dhe të rriturit të të gjitha etnive dhe grupeve socio-ekonomike. Ai kulmon më shumë në djemtë e moshës 2 deri në 4 vjeç.

Çfarë e shkakton ADHD?

ADHD nuk shkaktohet nga pakujdesia prindërore, nga problemet familjare, mësuës të dobët, ndenja për shumë kohë përpara televizorit, alergjitë ushqimore ose sheqeri i tepërt. Një teori e hershme shpjegonte që çrregullimi i vëmendjes shkaktohet nga trauma të vogla apo dëmtime të trurit. Për këtë arsye, për shumë kohë, ADHD u quajt "dëmtimi minimal i trurit" ose "disfunksioni minimal i trurit". Shumica e individëve me ADHD nuk kanë histori të



traumave në tru ose evidencave të dëmtimit trunor. Ka fakte të rëndësishme që tregojnë se ADHD trashëgohet në familje e cila sugjeron për predispozicion gjenetik. Nqs një person në një familje diagnostikohet me ADHD, atëherë ka një probabilitet prej 25-35% që një tjetër pjesëtar i saj të ketë ADHD, krahasuar me 4%-6% me një individ të popullatës.

FAKTORËT FIZIK

Teknikat e avancuara imazherike kanë detektuar ndryshime në trurin e fëmijëve me ADHD krahasuar me fëmijët që nuk kanë ADHD. Në disa studime, skaneri i kokës ka treguar që ana e djathtë e trurit është më vogël në fëmijët me ADHD. Ana e djathtë përmban tre zona të rëndësishme: korteksin prefrontal, nukleus caudatus dhe globus pallidus. Anomali në këto zona mund të dëmtojë aftësinë e një individi për të frenuar veprimet duke rezultuar në impulsivitetin tipik të ADHD.

PROBLEMET E SHTATZANISË

ADHD shpesh lidhet me probleme të shtatzanisë. Duhet përmendur se shtatzanisë gjithashtu lidhet me ADHD.

ÇFARË E SHKAKTON ADHD

■ ADHD është një gjendje neuro-psikologjike me simptoma që përfshijnë shqetësim të tepruar, shpërqëndrim dhe akte impulsive. Vlerësimet tregojnë që 3-7% të nxënësve të shkollave dhe 4% të të rriturve kanë ADHD.

■ Për ADHD nuk është gjetur asnjë shkak biologjik, por shumica e kërkimeve flasin për gene të trashëguar nga prindërit si kontribues kryesor për shfaqjen e ADHD. Studimet tregojnë qartë se rrënjët e kësaj sëmundjeje janë në familje, psh 78% e fëmijëve me ADHD kanë dikë në familje po me këtë sëmundje. Shkencëtarët tani janë duke studjuar se cilat gene ose kombinime genesh janë përgjegjëse për ndryshimin e sjelljes në personat me ADHD.

■ Lindja premature, përdorimi i duhanit gjatë shtatzanisë ose stresi ekstrem, përdorimi i alkoolit dhe dëmtimet traumatike të trurit kontribuojnë në zhvillimin e ADHD.

Diagnoza

ADHD kapet në vitet e para të shkollës

ENISA SHEVROJA

ADHD është një sëmundje që nuk mund të diagnostikohet nëpërmjet ekzaminimeve të trurit apo analizave të gjakut. Pediatrët dhe psikiatërët janë të aftë të përcaktojnë nëse fëmija juaj ka ADHD, pra nëse sjelljet që ai shfaq janë simptoma të ADHD apo janë thjesht reagime të papjekura, të pazakonta. Shumica e rasteve me ADHD diagnostikohen në vitet e para të shkollës. Fëmijët e diagnostikuar me ADHD kanë simptoma që pengojnë zhvillimin e aftësive të tyre paralelisht me bashkëmoshtarët. Këto simptoma duhet të zgjasin së paku 6 muaj para diagnostikimit me ADHD. Për një diagnostikim korrekt, shërbejnë një sërë informa-



cionesh rreth fëmijës, si psh:

■ Ajo ç'ka shkruhet për sjelljen e tij në raportet e shkollës (mungesa e vëmendjes, vështirësi në përqëndrim, mungesa e përpjekjeve etj. janë

karakteristika që favorizojnë diagnostikimin me ADHD)

■ Diskutimi me prindërit për t'u njohur me çdo diagnozë të fëmijës si dhe me shfaqjen e simptomave të ADHD

■ Një rëndësi të veçantë ka edhe njohja e historikut të sëmundjeve të familjes (në të shumtën e rasteve të diagnostikuara me ADHD kanë një të afërm me të njëjtën diagnozë)

Duhet theksuar se ADHD, edhe kur diagnostikohet në individë të rritur, është një çrregullim që fillësat e tij i ka në fëmijëri dhe se për diagnostikim, edhe tek të rriturit, shfrytëzohen "burimet" e sipërpërmendura.

KA 3 TIPE ADHD:

1-ADHD ku individi ka mungesë

SIMPTOMAT E ADHD

Mungesa e vëmendjes përfshin:

■ Të qenit lehtësisht i shpërqëndruar dhe "të kapërcyerit" nga njëri aktivitet në tjetrin

■ Kryerjen e detyrave të shkollës nën presionin e të rriturve

Të qenit i çorganizuar

■ Humbjen e sendeve vetjake dhe bërjen e gabimeve të shpeshta nga pakujdesia

■ Rënia nga mësimet pavarësisht një koeficienti inteligjence (IQ) normale

Hiperaktiviteti përfshin:

■ Të paturit energji të tepërta

■ Kryerjen e aktiviteteve të tilla si kërcimi apo vrapimi kur nuk është e përshtatshme

■ Të folurit shumë

■ Nevoja për të qenë i zënë duke u përpjekur për të bërë shumë gjëra njëkohësisht

Impulsiviteti përfshin:

■ Të qenit i paduruar

■ Vjedhin lodrat e moshatarëve

■ Të vepruarit para të menduarit

vëmendjeje

2-ADHD ku individi shfaq impulsivitet dhe është hiperaktiv

3-ADHD ku individi i shfaq të dyja këto simptoma. Tipi i fundit quhet "tipi i kombinuar i ADHD.

Në ditët e sotme diagnostikimi është shumë herë më i lehtë sepe njerëzit janë të mirëinformuar rreth ADHD dhe simptomave të saj. Raporti aktual i femra/meshkuj të diagnostikuar është 1:3, por mjekët janë të bindur se në të vërtetë janë po aq vajza sa edhe djem të prekur nga ADHD. Arsyeja e mosdiagnostikimit të një pjese të konsiderueshme të vajzave është se simptomat e tyre janë deri diku më pak problematike në moshë të re dhe shfaqen më "butë" se tek djemtë.

Fenomeni

MJEKU PEDIATËR ose psikiatri i fëmijëve ose moshave të adoleshencës do t'ju thotë nëse sjellja e fëmijës suaj lidhet me simptomat e ADHD apo nëse ai ose ajo është aktive në mënyrë të pazakontë

JORA XHAXHO

Si ta kuptoj nëse fëmija im ka ADHD

Medikamentet efikas në trajtim

A snjë skaner i kokës apo analizë gjaku nuk mund ta diagnostikojë ADHD-në. Diagnoza vendoset me një ekzaminim nga një mjek profesionist i cili përcakton dhe mjekimin sipas vlerësimit të sjelljes së fëmijës suaj. Mjeku pediatër ose psikiatri i fëmijëve ose moshave të adoleshencës do t'ju thotë nëse sjellja e fëmijës suaj lidhet me simptomat e ADHD apo nëse ai ose ajo është aktive në mënyrë të pazakontë.

Shumica e rasteve me ADHD zbulohen për herë të parë që në shkollën fillore. Fëmijët që diagnostikohen me ADHD kanë simptoma që i pengojnë ata të jenë si gjithë fëmijët e moshës së tyre. Këto simptoma mund të zgjasin të paktën 6 muaj para se fëmija të diagnostikohet me ADHD.

Problemi më i madh mbetet që akoma shumë fëmijë me ADHD (pothuaj gjysma e tyre) nuk diagnostikohen



Kemi 3 nëntipe të ADHD: 1) shpërqendrim primar 2) hiperaktivitet dhe impulsivitet primar dhe 3) kombinim i këtyre 2 simptomave që quhet dhe nëntipi i kombinuar. **Djemtë e diagnostikuar me ADHD në krahasim me vajzat janë në raportin 3 me 1.**

Disa mjekë janë të mendimit që vajzat preken nga ADHD po aq sa dhe djemtë, por shpesh ato nuk diagnostikohen duke qenë se kanë simptomatikë më pak të shprehur dhe nevojshmëria për mjekim lind vetëm në moshë më të mëdha. Për pasojë, vajzat ndonjëherë e shprehin ADHD e tyre në mënyra më pak shqetësuese si psh vetëm duke qenë të pavëmendshme. Në ditët e sotme, kur mjekët janë të vetëdijshëm mbi mënyrat unike që ADHD shfaqet te vajzat dhe te djemtë, shumë prej tyre diagnostikohen herët dhe marin mjekimin përkatës.

Duket sikur numri i fëmijëve që diagnostikohen me ADHD është më i madh sot se në të shkuarën. Kërkimet tregojnë se kjo rritje është për shkak të përforcimit të njohjes së kësaj sëmundjeje dhe diagnostikimit në kohë edhe tek fëmijët që mund të paraqesin forma më të lehta të ADHD.

Pavarësisht rritjes së per-

sonave të diagnostikuara me ADHD dhe frikës se disa fëmijë trajtohen gabimisht sikur kanë ADHD, problemi më i madh mbetet që akoma shumë fëmijë me ADHD (pothuaj gjysma e tyre) nuk diagnostikohen dhe nuk marrin mjekim e tyre në kohë.

Cilat lloje mjekimi janë më efikasë?

Për të ndihmuar familjet për të marrë vendime të

rëndësishme mbi mjekimin Instituti Nacional i Shëndetit Mendor ka drejtuar studimet më të thella të kryera ndonjëherë në lidhje me vlerësimin e mjekimit të ADHD-së. Të dhënat nga ky studim treguan që metilfenidati (medikament kryesor që përdoret për trajtimin e ADHD) është efikas edhe në trajtimin e simptomave të ADHD i vetëm ose i kombinuar me terapi të sjelljes. U zbulua gjithashtu se

mjekimi me medikamente është më efikas për simptomat e ADHD si psh për hiperaktivitetin sesa terapia e sjelljes vetëm. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur monitorimi i mjekimit bëhet në mënyrë të veçantë dhe specifike për çdo fëmijë.

Ky studim së bashku me studime të tjera në shkallë më të gjerë kanë arritur në përfundimin që efikasiteti dhe siguria e medikamenteve të

TRAJTIMI I SJELLJES

1- Trajnimi i prindërve:
Ndhon prindërit të mësojnë mbi ADHD dhe mënyrat si të kontrollojnë sjelljet e shkakuar nga ajo.

2- Mjekimi i përqëndruar te fëmija:
Ndhon fëmijët ose adoleshentët të jenë socialë, akademikë dhe të aftë të zgjidhin problemet e tyre.

3- Ndërhyrjet në shkollë:
Ndhon mësuesit të njohin nevojat e edukimit të nxënësit duke u mësuar nxënësve të tjerë si të kontrollojnë sjelljet e nxënësve me ADHD në klasë.

ADHD. Kërkimi tregon se për pacientët e vegjël me ADHD, mjekimi ul në mënyrë dramatike hiperaktivitetin, përmirëson vëmendjen dhe rrit aftësinë për të komunikuar me të tjerët. Ndërsa vetëm medikamentet japin rezultate të provuara në mjekimin e ADHD, kombinimi i tyre me terapinë e sjelljes ka patur rezultate të padiskutueshme në ndihmën ndaj familjeve dhe mësuesve duke u mësuar fëmijëve mënyra për të ndryshuar sjelljen e tyre që u shkakton probleme në shkollë dhe në shtëpi. Përveç kësaj, shumë fëmijë që përdorin këtë kombinim kanë mundur të ulin dozat e mjekimit të tyre. Fëmijët me ADHD të cilët kanë probleme të tjera mendore si depresion ose ankth ndihmohen në mënyrë të veçantë nga terapia individuale si dhe trajtimi familjar si pjesë e planit të trajtimit.

A do ta shërojë mjekimi fëmijën tim?

Mjekimi është një rrugë shumë efektive për trajtimin e simptomave të ADHD, por funksionon vetëm kur meret sipas rekomandimit të mjekut. Ndryshe nga antibiotikët ose medikamente të ngjashëm që meren për një kohë të shkurtër për trajtimin e infeksioneve, nuk ka mjekim specifik për ADHD që e shëron këtë gjendje. Për fat të mirë shumica e fëmijëve me ADHD mund të përmirësohen dukshëm nga kombinimi i mjekimit me trajtimin e sjelljes. Kërkimet vazhdojnë për të mësuar më mirë për mënyrën se si ADHD prek funksionet e trurit dhe se si mund të trajtohet kjo sëmundje në mënyrë më të mirë të mundshme.

Zgjedhja e mjekimit

Ja cilat janë alternativat e mjekimit

Medikamentet e ADHD grupohen në 2 bashkësi të mëdha: Stimulues dhe jo stimulues.

Medikamentet stimuluese si metilfenidati dhe amfetamina janë shumë efektive për trajtimin e ADHD dhe janë përdorur për shekuj. Amfetaminat janë dhënë për më shumë se 70 vjet, metilfenidati për më shumë se 50 vjet. Prandaj të dy këta medikamente janë të studiuar mirë. Eksperienca ka treguar se këto medikamente janë të sigurt kur jepen në pacientë të shëndetshëm dhe përdoren nën mbikqyrjen e mjekut.

I vetmi medikament jo stimulues i aprovuar nga Shoqatat e Medika-



menteve është Atomoxetina (Strattera) e cila ka treguar që është efikas në trajtimin e ADHD. Shumë prindër preferojnë medikamente jo stimulante. Ky medikament është gjithashtu një alternativë e mirë për të gjithë ata pacientë të cilët nuk u përgjigjen mirë mjekimit me stimulantë. Për të përcaktuar se cili mjekim është më i përshtatshmi për fëmijën tuaj merr kohë sepse edhe mjekëve shpesh herë u duhet të provojnë shumë mjekime për të përcaktuar se cili prej tyre funksionon më mirë se të tjerët.

Disa nga medikamentet e ADHD mund të mos jenë të mirë për fëmijën tuaj për shkak të efekteve an-

sore që ata shkaktojnë. Shumica e këtyre efekteve mund të eliminohen thjesht duke rregulluar dozën, ndryshuar kohën e marrjes ose duke përdorur një mjekim tjetër të ngjashëm.

Prindërit mund të ndihmohen mjekun të gjejë mjekimin dhe dozën më të përshtatshme duke mbajtur një ditar ditor mbi ecurinë e mjekimit të fëmijës dhe efektet anësore që ai paraqet pas marrjes së një medikamenti të caktuar.

Nëse fëmija juaj nuk ecën mirë me asnjë lloj mjekimi të zakonshëm për ADHD mund të përdoren dhe disa prej mjekimeve të cilët akoma nuk janë aprovuar nga Shoqata e Medikamenteve.

Trajtimi i ADHD

BARNAT i ndihmojnë të zhvillojnë më lehtësisht detyrat e shtëpisë dhe aktivitetet e tjera që kërkojnë përqendrim

Gjithçka që duhet të dini mbi mjekimin

Me mjekim fëmija më i qetë dhe i fokusuar


ANISA TOPOVITI
FLOGERT DOLLANI

Si administrohen barnat?

Barnat stimulante: Gjenden në forma farmaceutike me kohëzgjatje të shkurtër dhe të gjatë. Format me kohë të shkurtër merren 2-3 herë në ditë, me nga 4-5 orë për një dozë. Format me kohë të gjatë merren vetëm një herë në ditë midis orës 7 dhe 12. Ndonjëherë mjekët mund të përkrahajnë një kombinim të një bari stimules me kohëzgjatje të shkurtër dhe një bari me kohëzgjatje të gjatë, por ky kombinim nuk është studiuar sistematikisht. Për ata fëmijë që kanë vështirësi të gëlltisnin tabletat përdoren ngjitësa që vendosen në lëkurë, forma të lëngëta farmaceutike, tableta që përthepen, dhe kapsula që mund të hapen dhe të përzhihen me ushqimin. Shumica e mjekëve u fillojnë fëmijëve një mjekim stimules në një dozë të ulët dhe e rrisin dozën çdo 1-3 javë derisa të arrihet mbajtja nën kontroll e simptomave të ADHD-së. Mund të duhen disa muaj deri sa të gjendet doza e duhur. **Barnat jo-stimulante:** Atomoxetine (Strattera) merret si një dozë e vetme ditore në mëngjes ose si dy doza të ndara në mëngjes dhe pasdite. Shumica e mjekëve përkrahajnë një dozë të ulët në fillim dhe gradualisht e rrisin dozën në varësi të pacientit. Mund të nevojiten disa javë që të gjendet doza korrekte dhe disa javë të tjera që të vihet re efekti i plotë. Gjenden edhe barna të tjera të këtij lloji, si antidepressivët trciklikë, guanfacina, clonidina dhe bupropioni (Éellbutrin). Gjithsesi këto barna nuk janë të aprovuara nga FDA për trajtimin e ADHD-së. Është e rëndësishme të mos humben dozat e çdo lloji mjekimi për ADHD. Mosmarrja e një doze të vetme mund të risjellë simptomat e ADHD-së.

A mund të ndodhi një bashkëveprim i barnave OTC* me ato të ADHD?

Mund të ndodhi një ndërveprim p.sh., Benadryl (diphenhydramine) mund të shkaktojë ankth tek disa fëmijë. Është e rëndësishme që të lajmëroni mjekun e fëmijës tuaj ose far-



Barnat

Nuk duhet të ndryshojnë personalitetin e fëmijës edhe pse mund ta bëjnë atë më pak hiperaktiv dhe më shumë të vëmendshëm. Disa herë fëmijët kanë ndjesi të padëshirueshme gjatë fillimit të barit për trajtimin e ADHD-së, por këto ndjesi janë të vogla dhe në përgjithësi largohen më kalimin e kohës

KUR DUHET TË NDËRPRISNI TRAJTIMIN

1. Fëmija juaj nuk ka pasur asnjë simptomë për rreth një viti trajtim.
2. Fëmija juaj është përmirësuar dhe doza nuk ka ndryshuar.
3. Sjellja e fëmijës suaj është e njëjtë pavarësisht mosmarrjes së një apo dy dozave.
4. Fëmija juaj ka gjetur një mënyrë tjetër për t'u përqëndruar.

Zgjedhja për të ndërprerë barin duhet të diskutohet më mjekun, mësuesit, anëtarët e familjes dhe fëmijën tuaj.

macistin në lidhje me përkrimin, përdorimin e barnave, suplementeve bimore dhe vitaminave nga fëmija juaj. Ata do të dinë t'ju thonë ndërveprimet e mundshme dhe nëse duhet t'i përdorni apo jo këto barna OTC*.

*Over the counter-barna që merren në farmaci pa recetë mjekësore.

Si mund të sigurohem nëse bari po jep efekt?

Me barin stimules, prindërit dhe mësuesit mund të shohin efekte pozitive brenda 30 - 90 minutave në varësi të formës farmaceutike dhe dozës. Gjithsesi, nëqoftëse doza e barit stimules është e ulët, simptomat e ADHD-së do të vazhdojnë përsëri. Disa efekte pozitive të barnave jo-stimulante si Atomoxetine (Strattera), mund të shihen që javën e parë të trajtimit. Gjithsesi, mund të duhen disa javë që atomoxetine (Strattera) të

arrijë efektin maksimal edhe nëse doza është korrekte. Kur bari për trajtimin e ADHD-së po jep efekt, shumica e simptomave zhduken. Gjithashtu nuk është e pazakontë që disa simptoma të vazhdojnë. Trajtimet për të përmirësuar sjelljen mund të ndihmojnë në reduktimin e këtyre simptomave. Kur nevojitet një kohë e gjatë për të gjetur trajtimin dhe dozën efektive, barnat për trajtimin e ADHD-së do të japin efekt. Në fakt, në 90% të fëmijëve me ADHD, gjendet të paktën një bar ose një kombinim që u jep efekt.

A mund të ketë periudha kur fëmija im të ndërpresë mjekimin?

Në të kaluarën, mjekët rekomandonin një ndërprerje të trajtimit për ADHD në periudhën pas shkollës, në fundjavë dhe gjatë pushimeve verore. Në kohët e sotme, shumica e mjekëve rekomandojnë një trajtim me kohë të plotë, pa

ndërprerje të trajtimit, në mënyrë që të shihen përfitimet terapeutike në shtëpi dhe gjatë kohës që fëmija juaj është duke luajtur. Kjo mund të jetë shumë e rëndësishme për adoleshentët të cilët trajtohen me barna kundër ADHD-së jashtë shkolle, në mënyrë që ata ta kenë më të lehtë marrjen e vendimeve për të mos filluar duhanpirjen, substancat narkotike dhe faktorë të tjerë rrezikues. Barnat i ndihmojnë të zhvillojnë më lehtësisht detyrat e shtëpisë dhe aktivitetet e tjera që kërkojnë përqendrim. Gjithsesi, ndërprerjet e trajtimit ose reduktimi i dozës mund të merret parasysht në raste kur shfaqen efekte të padëshiruara tek fëmija juaj.

Si do të ndihet fëmija im nga mjekimi i ADHD-së?

Për shumicën e fëmijëve, mjekimi i ADHD-së do t'i bënte të ndiheshin më të qetë dhe më të aftë që të fokusohen diku dhe të përqëndrohen. Disa nga këto ndryshime mund të jenë të padukshme, gjithsesi prindërit dhe mësuesit do të vënë re ndryshime të kënaqshme në sjellje, në rastin kur bari jep efektin e duhur. Barnat e ADHD-së nuk duhet të ndryshojnë personalitetin e fëmijës edhe pse mund ta bëjnë atë më pak hiperaktiv dhe më shumë të vëmendshëm. Disa herë fëmijët kanë ndjesi të padëshirueshme gjatë fillimit të barit për trajtimin e ADHD-së, por këto ndjesi janë të vogla dhe në përgjithësi largohen më kalimin e kohës. Gjithashtu disa fëmijë që marrin barna jo stimules, atomoxetine (Strattera), shfaqin ndjesi më irrituese se zakonisht. Nëqoftëse vihet re një ndryshim personaliteti ose nëqoftëse fëmija juaj është në gjendje nervozizimi sa herë që merr barin, duhet të këshilloheni me mjekun e tij.



Këshilla

Monitoroni oreksin peshën dhe rritjen e fëmijës?

■ ■ ■ TIRANE

Prindërit janë të parët që duhet të monitorojnë mirëqenien e fëmijës së tyre - duke përfshirë këtu atë mendore dhe fizike. Barnat mund të kenë efekte anësore. Disa nga gjërat kryesore që duhet të vëzhgohen kur fëmija juaj është duke u trajtuar me barna për ADHD-në, përfshijnë ndryshimin e oreksit dhe të peshës. Gjithashtu edhe shkalla e rritjes së fëmijës duhet të monitorohet. Monitorimi i peshës dhe gjatësisë është pikë së pari përgjegjësia e mjekut, por është shumë e rëndësishme edhe ndihmesa që japin prindërit në këtë aspekt. Efektet e trajtimit të ADHD-së në rritje janë studiuar për vite me radhë. Kërkimet e fundit tregojnë se barnat stimulante mund të shkaktojnë një ulje të lehtë në procesin e rritjes (kryesisht të lidhura me peshën), të paktën nga viti i parë deri në atë të tretë të trajtimit. Gjith-



sesi, shumica e studimeve tregojnë se çdo zvogëlim i shkallës së rritjes është shpesh i përkohshëm dhe nuk ndikon në gjatësinë përfundimtare që do të ketë individi. Nëse do të ketë ndonjë ndryshim në oreksin e fëmijës tuaj apo në peshë, duhet të kontaktoni me mjekun. Ju dhe mjeku mund të diskutoni për mundësinë e ndryshimit të zakonave të të ushqyerit të fëmijës tuaj me qëllim për të mbajtur peshën e fëmijës në normalitet, gjithashtu nëse do të jetë e mundur edhe në ndryshimin e dozave të barnave.

Trajtimi i ADHD

FDA rekomandojnë prindërit të cilët marrin në konsideratë trajtimin me barna për ADHD për fëmijën e tyre



ANISA TOPOVITI
FLOGERT DOLLANI

Problemet e lidhura me zemrën, halucinacionet apo mendimet vetë-vrasëse janë disa prej efekteve anësore më serioze që mund shfaqen në pacientët që marrin barna për ADHD-në. Organizma të specializuara, si FDA (Food and Drug Administration) rekomandojnë prindërit të cilët marrin në konsideratë trajtimin me barna për ADHD për fëmijën e tyre, të bashkëpunojnë dhe të jenë në kontakt të ngushtë me mjekun për të ndjekur një trajtim të duhur, i cili të përfshijë analizat e nevojshme si dhe të bëhet një rishikim i kujdesshëm dhe i plotë i historikut të gjendjes shëndetësore. Në veçanti duhet t'i tregoni mjekut për çfarëdo problemi kardiak apo mendor që mund të ketë patur fëmija gjatë trajtimit të ADHD-së apo nëse ka ndonjë historik në familje me këto probleme.

Efektet anësore prindër, tregoni kujdes

Probleme me zemrën dhe halucinacione



KUR DUHET THIRRUR MJEKU?

■ Në rast se fëmija ndihet i hutuar apo i mekur; nëse ankohet për rrahje të pazakonta të zemrës, kur ka dhimbje në kraharor apo probleme me frymëmarrjen; kur nervozohet; kur nis të ketë halucinacione; kur duket i depresuar apo kur ka mendime vetëvrasëse.

■ Nëse fëmija juaj ankohet për kruarje, kur ka dhimbje apo fryrje të barkut apo simptoma të pashpjegueshme gripi, nëse urina është e errët dhe nëse ka sy apo lëkurë të zverdhur.

Problemet e lidhura me zemrën: Krallëherë janë raportuar probleme serioze të lidhura me zemrën, siç mund të jenë vdekje të papritura apo atak kardiak nga pacientët që marrin mjekime për ADHD. FDA (Food and Drug Administration) hetoi këto raportime dhe zbuloi se pjesa më e madhe e këtyre pacientëve kishin patur më herët defekte në zemër të padiagnostikuara. FDA përfundon duke thënë se është e pamundur të thuhet me saktësi nëse ka qenë defekti i fshehur në zemër, barnat apo kombinimi

i këtyre dy faktorëve që kanë shkaktuar problemet kardiale të raportuara. Nuk duket të ketë rrezik të lartë për vdekje të papritura apo atak kardiak për fëmijët që marrin barna për ADHD nëse fëmija nuk ka patur apo ka aktualisht probleme me zemër. Gjithsesi, FDA shtoi një etiketë paralajmëruese në barnat e ADHD-së duke kujtuar mjekët që të kenë kujdes në përshkrimin e këtyre barnave për njerëz që kanë defekte në zemër. Disa fëmijë me defekte në zemër mund të jenë në gjendje të marrin

stimulantë, por vetëm nën mbikqyrjen e plotë të mjekut.

Halucinacionet : FDA hetoi gjithashtu një numër të vogël raportimesh për halucinacione, psikoza dhe shpërthime agresioni në pacientët që marrin barna për ADHD. Nga një rishikim të barnave të përdorur për ADHD-në, u vu re një rrezik i ulët (rreth 1 në 1,000) në simptomat që përfshijnë: dëgjim zërash, dyshimi pa asnjë arsye apo rritje e probabilitetit për t'u bërë maniak në pacientët që nuk kanë pasur këto simptoma para se

të fillonin mjekimin.

Probleme mendore të mëparshme: Pacientët me psikoza të mëparshme, shqetësime bipolare, apo me histori në abuzime me drogën duhet të monitorohen me kujdes ndërsa përdorin barna për ADHD-në. Të dhënat tregojnë se disa barna mund të përkeqësojnë këto psikoza pre-ekzistuese apo shqetësime bipolare. Disa fëmijë me këto kushte, gjithsesi, mund të përdorin barnat për ADHD-në, por mund të kenë nevojë edhe për trajtime

të tjera. Gjithashtu, pacientët që kanë abuzuar me drogën mund të kenë rrezik për rishfaqje të dendshër për abuzim me drogën nëse marrin barna stimulante. Roli i barnave stimulante në trajtimin e adolezencëve me ADHD dhe abuzimin me substancat narkotike mbetet një problem jo shumë i qartë.

KUJDES

Efektet anësore të trajtimit

Pjesa më e madhe e fëmijëve të trajtuar me barna për ADHD-në, shfaqin disa efekte anësore. Disa prej efekteve anësore më të zakonshme dhe të parashikueshme prej barnave stimulante janë: ulja e oreksit, rënie në peshë, probleme me gjumin, dhimbje koke, dhimbje stomaku dhe irritime. Simptomat e këtyre efekteve bëhen më të lehta brenda dy muajve të parë të trajtimit. Gjithashtu edhe jo-stimulantit atomoxetin mund të shkaktojë të vjella, të ulët oreksin dhe të shkaktojë humbje në peshë. Disa fëmijë ankohen për përgjumje dhe mund të shfaqin një nervozizëm të lehtë gjatë ditës që kanë marrë barin; gjithsesi, këto efekte anësore zakonisht zhduken pas muajit të parë të trajtimit. Efektet anësore zakonisht nuk janë të rrezikshme, por duhet t'i raportohen mjekut të fëmijës nëse shkaktojnë siklet, parehati .

Mjekimi

Si mund të menaxhojmë efektet anësore

Ka disa gjëra që mund të bëni për të ulur problemet e shkaktuara prej efekteve anësore më të zakonshme të lidhura me barnat e ADHD-së.

OREKSI I PAKËT:

Disa nga mundësitë për të rritur oreksin janë: administrimi i barnave pas ngrënies së mëngjesit, në mënyrë që fëmija juaj të jetë i uritur për të ngrënë në mëngjes; dhënia e vakteve të bollshme në darkë kur medikamenti ka filluar të përthithet dhe të veprojë në organizëm. Gjithashtu duhet të keni gati ushqim nëse fëmija shfaq papritmas (jashtë vakteve) uri. Gjithashtu është e këshillueshme të ndiqet një dietë me ushqime dhe pije me përmbajtje të lartë kalorike, por gjithmonë të përshatshme dhe të mbikqyruara në mënyrë që të rifitohet çdo humbje e mundshme në peshë. Nëse oreksi i ulët vazhdon të jetë prezent tek fëmija

juaj për një periudhë të gjatë duhet të pyesni mjekun nëse është e mundur të ndalohet mjekimi apo të ulët doza e barnave gjatë kohës së verës apo edhe gjatë fundjavave.

PROBLEMET ME GJUMIN:

Është e rëndësishme për mirëqenien e fëmijës vendosja e një rutine për të bërë fëmijën të shkojë në shtrat. Kjo rutinë mund të përfshijë kryerjen e një banje, larjen e dhëmbëve, leximin nga vetë fëmija apo edhe nga prindërit para se të shkojë në shtrat. Këto aktivitete ndihmojnë në shlodhjen dhe relaksim të fëmijës tuaj. Gjithashtu përpikuni të shmangni radion, televizorin, kompjuterin apo lojërat elektronike përpara se fëmija të shkojë në shtrat, këto do të ishin rreziqe potenciale për ta stimuluar dhe shpërqëndruar fëmijën dhe do

të bënte që t'i binte dëshira për të fjetur. Nëse fëmija juaj përdor barna stimulante me veprim të zgjatur, mund të pyesni mjekun për mundësinë e ndryshimit të tyre me barna me veprim të shkurtër (8 orë në vend të 12 orë p.sh.). Nëse fëmija juaj është duke marrë barna me veprim të shkurtër, mund të flisni me mjekun për të ulur dozën apo të ndaloni mjekimin gjatë pasditeve për të ndihmuar fëmijën të shkojë në shtrat. Sikurse në rastet e shaktuara, barnat mund të ndihmojnë fëmijën për të fjetur.



PËRGJUMJA:

Nëse fëmija juaj merr barin jo-stimulant, atomoxetin (Strattera) dhe përgjumet gjatë ditës, mjeku mund t'ju rekomandojë t'i jepni barin pak para se të shkojë në shtrat dhe të mos e marrë

atë në mëngjes. Një mundësi tjetër do të ishte ndarja e dozës dhe marrja e saj dy herë në ditë ose ulja e dozës me qëllim reduktimin e përgjumjes.

RIKTHIMI I SJELLJEVE:

Disa fëmijë që marrin barna stimulante mund të shfaqen më nervoz apo të kenë rritje të simptomave të ADHD-së gjatë pasdites apo mbrëmjes. Ky quhet "Rikthimi i Sjelljeve" nga disa mjekë dhe mund të shkaktohet prej kohës së përthithjes dhe veprimit të barit në organizëm. Për të rregulluar këtë, mjeku mund t'ju rekomandojë një bar që zgjat më shumë (në veprim) apo një dozë të ndërmjetme stimulanti, pasdrecke.

EFEKTE TË TJERA ANËSORE:

Nëse keni pyetje apo shqetësime rreth këtyre efekteve anësore apo të tjera akoma, kontaktoni mjekun e fëmijës tuaj.

Psikologji

MËSUESIT janë të parët që zakonisht identifikojnë ADHD dhe ata mund t'i japin prindërve, mjekëve apo kujdestarëve të tjerë një informacion mjaft të pasur për diagnostikimin dhe trajtimin e fëmijës

Ndikimi i shkollës në trajtimin e fëmijëve

Mësuesi, çelësi i suksesit për fëmijën tuaj

RENINA VARFAJ

Psikologe Klinike

Ndihma ndaj fëmijëve me ADHD duhet të jetë një kontribut i famijes, por mbi të gjitha edhe i shkollës, si një ambient ku kalohet një pjesë e mirë e kohës. Çelësi i suksesit së fëmijës me ADHD është pikërisht marrëdhënia mes mësuesit dhe prindërve. Mësuesit janë të parët që zakonisht identi-

Fëmijët me ADHD shpesh kanë vështirësi në marrëdhëniet sociale, gjë e cila mund të sjellë konflikte në familje



Mjekimi

Sjell rezultate të mira që ndikojnë sjelljen dhe përmirësojnë mënyrën se si fëmija krijon marrëdhënie me të tjerët. Psh. ata mund të presin me durim rradhën e bisedës, rradhën e lojës, ose të flasin pa u menduar gjatë

rradhën e bisedës, rradhën e lojës, ose të flasin pa u menduar gjatë. Prindërit gjithashtu mund të ndihmojnë në këtë proces duke i lejuar mësuesit, psikologun e shkollës apo të tjerë persona që merren me edukimin e fëmijës të njihen me vështirësitë dhe problemet e fëmijës. Në këtë mënyrë fëmija mund të ndihmohet përmes pjesëmarrjes në punë grupi, pjesëmarrjes në aktivitete të shkollës apo lojra që organizohen.

A ka nevojë fëmija për trajtim gjatë kohës kur nuk është në shkollë?

Simptomat e ADHD zakonisht janë më të dukshme gjatë kohës në shkollë, gjatë lojës dhe në shtëpi. Pjesa më e madhe e mjekëve rekomandojnë që fëmija me ADHD të marrë ilaçet gjatë ditës, ve-

Trajtimi psikosocial

Rekomandohet në fillimet e ADHD

Vetëm trajtimi psikosocial (trajtimi i aftësive sociale apo terapia individuale) nuk është i mjaftueshëm pa trajtimin mjekësor për simptomat bazë të ADHD. Gjithsesi trajtimi psikosocial është ai që rekomandohet në fillimet e hershme të ADHD kur ato nuk janë përkeqësuar, kur ende nuk është një diagnozë e saktë e ADHD ose nëse familja preferon atë tip trajtimi. Megjithatë edhe në rastin kur fëmija juaj nuk është në një trajtim mjekësor, trajtimi psikosocial mund ta ndihmojë atë të menaxhojë simptomat e ADHD dhe të zvogëlojë impaktin e tyre te fëmija. Një studim ka treguar se mund të ulet doza e medikamenteve nëse trajtimi psikosocial ecën mirë. Shumë prindër rekomandojnë një terapist



me eksperiencë në këtë fushë. Gjithashtu duhen nxitur edhe trajnime të prindërve ose të mësuesve që punojnë me këta fëmijë. Mësuesit mund të mësojnë teknika të aplikueshme edhe në shkollë. Ata mund të përdorin teknikat e shpërbllimit apo të mbajtjes së pasojave për sjelljet jo të preferueshme në mënyrë që ata të mësojnë kujditje dhe mësojnë të bëjnë zgjedhje në mjedisin e shkollës.

canërisht nëse simptomat janë më të dukshme në ambiente jashtë shkollës. Mosmarrja e ilaçeve mund ta vërë në vështirësi serioze fëmijën. Fëmijët më të vegjël mund të jenë në rrezik për dëmtime gjatë lojës dhe grindje me bashkëmohatarët ndërsa adoleshentët mund të kenë rrezik për aksidente automobilistike me makinë ose motocikleta. Gjithashtu te këta të fundit ekziston dhe një pririje më e mad-

he për përfshirje në sjellje eksperimentuese dhe të rrezikshme. Mund të ndodhë, për shembull, që mjeku i fëmijës suaj, t'i japë atij një periudhë qetësie dhe t'i këshillojë ndalimin e marrjes së medikamenteve gjatë kohës së shkollës në mënyrë që ai të menaxhojë efektet anësore të tyre. Duhet të merri parasysh faktin që gjatë kësaj kohe mund të ketë një rishfaqje të simptomave në çdo kohë.

fikojnë ADHD dhe ata mund t'i japin prindërve, mjekëve apo kujdestarëve të tjerë një informacion mjaft të pasur për diagnostikimin dhe trajtimin e fëmijës. Gjithashtu, mësuesit dhe prindërit mund të punojnë sëbashku për të zgjidhur problemet dhe të planifikojnë mënyra se si të mbështesin të mësuarit e fëmijës si në shtëpi edhe në shkollë. Përshembull, mësuesi duhet të përdorë shpesh mënyra të ndryshme sjelljesh si edhe instrumenta të tjerë mësimorë që të ndihmojnë fëmijët me ADHD. Sipas Kushtetutës dhe Deklaratës për të drejtat e fëmijëve, të gjithë fëmijët kanë të drejtën të arsimohen! Megjithatë, prindërit apo kujdestarët ligjorë duhet të paraqesin një letër të shkruar në të cilën ata japin lejen e tyre për shërbimet, testimet apo vlerësimet që mund t'i bëhen fëmijës. Ato janë konfidenciale dhe pa pagesë nga prindërit. Disa fëmijëve mund t'u duhet të marrin medikamentet e tyre gjatë orarit të mësimit. Edhe në këtë rast prindërit apo kujdestarët ligjorë duhet që të lajmërojnë psikologun ose mësuesin.

mund të bëjë që fëmija të mos pranohet nga fëmijët e tjerë. Mungesa e shprehive (aftësive) sociale e kombinuar me hiperaktivitetin, impusivitetin dhe mungesën e vëmendjes mund të bëjë që fëmijët me ADHD të sillen në një mënyrë të tillë që të tjerët të mendojnë se ai është i keq, i pasjellshëm, i papërgjegjshëm ose i çuditshëm

dhe si pasojë kjo mund të sjellë për këta fëmijë, ashtu si edhe për fëmijët me çrregullime të tjera, situata ku këta janë shenjestra për tallje nga shokët. Mjekimi për ADHD sjell rezultate të mira që ndikojnë sjelljen dhe përmirësojnë mënyrën se si fëmija krijon marrëdhënie me të tjerët. Psh. ata mund të presin me durim

Komorbiteti

Sëmundjet që shoqërojnë ADHD

Çrregullimet që mund të shoqërojnë ADHD

Kërkimet tregojnë se 2/3 e fëmijëve që diagnostikohen me ADHD kanë të paktën një problem shtesë që lidhet me shëndetin mendor ose paaftësi në të nxënë. Në mënyrë që të kemi një diagnozë të saktë, mjeku i fëmijës duhet të jetë i vëmendshëm ndaj çrregullimeve të tjera që kanë ngjashmëri në simptoma dhe në shfaqje si ADHD.

Studimet kanë treguar se më shumë se gjysma e fëmijëve me ADHD mund të shfaqin sjellje deviante. Ata zakonisht kanë prirjen të mos i binden autoritetit dhe të bezdisin të tjerët qëllimisht. Disa fëmijë me ADHD të cilët shfaqin më shumë sjellje të tilla mund të kenë çrregullime të sjelljes.

Ka disa variante shfaqjeje si më poshtë:

- Vetëm ADHD



- Një tjetër çrregullim
- ADHD dhe një çrregullim tjetër.

Të paturit një problem tjetër bashkëshoqërues përveç sëmundjes bazë njihet si gjendje e komorbitetit. Kjo bashkëekzistencë mund ta bëjë diagnostikimin dhe vlerësimin e ADHD më të vështirë.

Disa prej çrregullimeve bash-

këekzistuese mund të jenë:

- Çrregullimi antisocial
- Vështirësitë e gjuhës dhe të nxënës
- Çrregullime të ankthit dhe të humorit

25-35% e fëmijëve me ADHD shfaqin komorbitet me një çrregullim të nxënës ose çrregullim gjuhësor. Në këtë rast duhet të punohet së bashku me logopedin apo të tjerë profesionistë të gjuhës dhe shkollës si edhe nevojitet një ndihmë e veçantë edhe nga shkolla. 33% e fëmijëve me ADHD kanë një çrregullim bashkëshoqërues të ADHD me çrregullimet e humorit ose të ankthit. Edhe këta fëmijë kanë nevojë për një ndihmë suplementare si edhe mundësinë për t'u përfshirë në terapinë e të folurit, mjekësore ose dhe të dyja sëbashku. Një ndër çrregullimet bashkësho-

Si ndikon diagnoza e ADHD në socializimin e fëmijës?

Fëmijët me ADHD shpesh kanë vështirësi në marrëdhëniet sociale, gjë e cila mund të sjellë konflikte në familje ose

Neurologji

MYASTENIA GRAVIS prek vetëm muskujt që janë nën kontrollin tonë të vullnetshëm, ndërsa muskujt e zorrës dhe zorrës nuk preken nga kjo sëmundje

Myastenia gravis simptomat diagnoza dhe mjekimi

Femrat tre herë më të rrezikuara se meshkujt

TAULANT MUKA

Myastenia Gravis vjen nga latinishtja dhe do të thotë "dobësim i rëndë muskolor".

Në mënyrë që muskujt tanë të funksionojnë, sinjalet elektrike dërgohen nga truri në pjesët fundore të nervave. Kur këto sinjale arrijnë fundet nervore, ata stimulojnë çlirimin e një lëndë kimike (neurotransmetues) i quajtur acetilkolinë, e cila vepron në receptorët e qelizave në muskul duke shkaktuar kontraktimin e tij. Më pas, një lëndë tjetër kimike degradon acetilkolinën në mënyrë që muskuli të relaksohet sërish.


Myastenia Gravis është një sëmundje autoimmune në të cilën, për arsye të panjohura, trupi sulmon vetveten. Në këtë sëmundje, trupi prodhon antitropa që shkatërrojnë disa prej receptorëve të muskujve tanë. Kur kjo ndodh kontraktimi muskolor është i dobët.

Cilat janë simptomat?

Muskujt e prekur nga kjo sëmundje shfaqin shkallë të ndryshme dobësimi. Myastenia Gravis prek vetëm muskujt që janë nën kontrollin tonë të vullnetshëm, ndërsa muskujt e zorrës dhe zorrës nuk preken nga kjo sëmundje. Muskujt përreth syrit janë ata që preken të parët duke shkaktuar varje të qepallës dhe pamjen e një fytyre të lodhur. Muskujt që kontrollojnë lëvizjet e syrit gjithashtu preken, duke shkaktuar shikim të dyfishtë.

Me pas, dobësohen edhe muskujt e fytyrës duke dhënë ekspresionin e ngardheshjes në fytyrë. Nëse preken edhe muskujt e fytyrës dhe nofullës atëherë të ushqyerit dhe gjellitja vështirohen. Në raste të rënda, personat e kanë të pamundur të flasin, të lëvizin krahët lart ose të ecin, si dhe kanë vështirësi në frymarrje.

Relaksimi dhe gjumi i mirë gjatë natës lehtësojnë simptomat të cilat rëndohen



Sëmundja

me kalimin e ditëve. Çdo gjënde stresi përkeqëson dobësimin muskolor dhe të gratë simptomat shfaqen më të rënda gjatë periodave. Edhe pse zakonisht është një sëmundje progresive, nuk ndodh gjithmonë kështu. Në disa persona simptomat zhduken spontanisht dhe nuk kthehen për shumë vite.

KRIZA MIASTENIKE

Një krizë miastenike është e rrallë. Kjo ndodh kur muskuli që kontrollon frymarrjen dobësohet në atë pikë që frymarrja bëhet e

vështirë. Zakonisht, në të tilla raste, është i nevojshëm shtrimi në spital ku pacienti mund t'i nënshtrohet frymar-

rjes së asistuar nga një makinë ventilatore.

Kush preket?

Myastenia Gravis mund të prekë çdo moshë por ka tendencë të prekë më shumë femrat nën 40 vjeç dhe meshkujt mbi 60 vjeç. Ajo prek rreth 1 në 20.000 veta. Femrat janë tre herë më të rrezikuara se meshkujt për t'u prekur nga kjo sëmundje. Nuk është një sëmundje e trashëguar edhe pse mund të ndodhë në më shumë se një anëtar të së njëjtës familje.

Si diagnostikohet?
Personat duhet të shihen

nga një neurolog për të konfirmuar diagnozën. Nqs injektimi i një medikamenti që rrit nivelet e neurotransmetuesit kimik shkaktonte përmirësim të përkohshëm të simptomave atëherë diagnoza konfirmohet.

Pacientët mund t'i nënshtrohen testeve të funksionit muskolor, analizave të gjakut për të parë për antitropa dhe

Për pjesën më të madhe të personave me myastenia gravis, trajtimi përmirëson dobësimin muskolor duke bërë të mundur një jetë normale pa simptoma


CT-s (tomografisë së kompjuterizuar) për të parë anomali të timusit i cili është pjesë e sistemit imunitar dhe mund të jetë përgjegjës për prodhimin e antitropave të dëmshëm që shkaktojnë myastenia gravis.

Si mund të kujdesem për veten nqs kam myastenia gravis?

Ju duhet t'ndiqni disa hapa të thjeshtë për të ndihmuar përballjen me këtë sëmundje në jetën e përditshme. Sa më shumë qetësi dhe një dietë e balancuar dhe

TIMUSI

Gjendra që shkakton sëmundjen



Timusit është një gjëndër e vogël në pjesën e sipërme të krahavorit mënjëherë pas sternumit (kockës së gjoksit). Është pjesë e sistemit imun. Timusit është anormal në pjesën më të madhe të të sëmurve me myastenia gravis, veçanërisht në ata që zhvillojnë këtë sëmundje para moshës 40 vjeç. Roli i saktë i qelizave të timusit nuk është ende i qartë por mendohet se kanë lidhje me prodhimin e antitropave. Për disa persona, heqja e timusit mund të kurojë myastenia gravis. Një numër i vogël i prekur nga myastenia gravis zhvillojnë një rritje të timusit e quajtur timoma. Nqs ndodh, zakonisht është benign (jokanceroz) por mund të jetë edhe malign (kanceroz) në një numër shumë të vogël rastesh.

e pasur me kalium mund t'ju ndihmojë që të ndiheni më pak i lodhur. Portokalli, dhe banania janë fryta që përmbajnë kalium. Këshillohet që të qetësoni sytë dhe të shtrihen disa herë gjatë ditës.

Cili është dekursi i sëmundjes dhe progniza?

Pa trajtim, myastenia gravis mund të bëhet serioze dhe rrezikuese për jetën. Gjithsesi, trajtimi zakonisht funksionon mirë. Për pjesën më të madhe të personave me myastenia gravis, trajtimi përmirëson ndjeshëm dobësimin muskolor duke bërë të mundur një jetë normale pa simptoma. Në pak raste, trajtimi nuk funksionon mirë. Në disa raste, myastenia gravis shkon në remission (përmirësim) të përkohshëm që do të thotë që trajtimi duhet të ndërpritet në periudha të caktuara kohore.

Trajtimi

Disa nga format e mjekimit

Për disa persona, heqja kirurgjikale e timusit (timektomia) mund t'i kurojë, osë të paktën t'ju lehtësojë simptomat. Të tjerë mund të trajtohen me barna që ndalojnë degradimin e neurotransmetuesve kimikë duke rritur nivelet e tij në trup.

Në situata të caktuara steroidët si prednisonone mund të përdoren në trajtimin e myastenia gravis. Steroidët supresojnë sistemin imun dhe parandalojnë prodhimin e antitropave anormale. Nevojiten disa muaj për të lehtësuar simptomat përmes përdorimit të steroidëve. Kur ka përmirësime, doza zakonisht ulet



gradualisht derisa gjendet doza më e ulët mbajtëse për të parandaluar simptomat.

Barnat imunosupresore si azothiapine mund të këshillohen si medikament shtesë i medikamenteve steroid. Këto medikamente përdoren për të supresuar përgjigjen imun.

Kur simptomat janë shumë të rënda, pacientët i nënshtrohen një procesi i quajtur plasmoforezë. Përmes kësaj teknike pacientit shkëmbehen plazmën e tij me plazmën e dhuruesit e cila nuk ka antitropa të dëmshëm. Në këtë mënyrë bëhet e mundur heqja për një farë kohe e antitropave anormale.

Dune shmangur temperaturat ekstreme, stresi dhe infeksionet të cilat mund të përkeqësojnë simptomat.

Pro apo kundër

Kafeja përfaqëson pijen aro matike më të konsumuar në të gjithë botën. Efektet e saj të mira apo të dëmshme për organizmin janë vënë në pikëpyetje që në lashtësi.

Duke u bazuar në studimet e kohëve të fundit, nuk ka asnjë arsye për ta braktisur kafënë, pasi efektet e saj dobiprurëse janë më të mëdha se efektet e dëmshme. Kafeja rekomandohet të konsumohet nga individë që gëzojnë shëndet të plotë. Në rast se vuani nga ndonjë sëmundje, atëherë është mirë që para se të konsumoni kafe, të këshilloheni me

Duke u bazuar në studimet e kohëve të fundit, nuk ka asnjë arsye për ta braktisur kafënë, pasi efektet e saj dobiprurëse janë më të mëdha se efektet e dëmshme



KAFEINA është një substancë e cila ndikon në sistemin nervor, duke rritur kapacitetin mendor dhe kapacitetin perceptiv

Parandalon formimin e gurëve në veshka dhe në tëmth. Disa studime kanë treguar se pirja e një filxhani kafe në ditë ndihmon në parandalimin e formimit të gurëve renalë dhe biliarë. Kjo vjen si pasojë e efektit diuretik të kafesë; pra duke u rritur eliminimi i urinës largohen dhe mineralet të cilat në kushte të tjera do të grumbulloheshin në trup.

Nuk rrit riskun për të zhvilluar osteoporozë. Hulumtimet e fundit kanë treguar se konsumi i moderuar i kafesë nuk rrit riskun për të zhvilluar osteoporozë. Në rast se ju merrni mjaftueshëm kalcium me anë të dietës, kafeina nuk do të modifikojë kalciumin në kockat tuaja.

Së shpejti do të përdoren preparate me kafeinë për të shmangur formimin e trombeve në enët e gjakut të cilët mund të shkaktojnë infarkt kardiak dhe emboli cerebrale

Kafe normale apo e çkafëinuar?

Kafeina është një substancë e cila ndikon në sistemin nervor, duke rritur kapacitetin mendor dhe kapacitetin perceptiv. Kjo substancë mund të shkaktojë pagjumësi dhe palpacione (rrahje zemre) në rast se konsumohet në sasi të mëdha. Kafeja nuk ka të njëjtin efekt si drogat, kështu që nuk krijon adiksion fiziologjik.

Në treg mund të gjejmë dhe kafe pa kafeinë, ose ndryshe të çkafëinuar, e cila i është nënshtruar një procesi shtesë i cili largon kafeinën. Kafeina nuk mund të largohet plotësisht (deri në 85-95%). Megjithatë, kjo lloj kafeje nuk do të sjellë të njëjtat përfitime për shëndetin.

Përfitimet e kafesë
Të mbush me energji. Hulumtues të ndryshëm kanë gjetur se kafeina stimulon sistemin nervor, duke lehtësuar koordinimin, duke përmirësuar gjendjen emocionale dhe motivacionin. Gjithashtu rrit energjinë, rezistencën dhe shpejtësinë ndërkohë që ul lodhjen.

Ndihmon në përqëndrim. Kjo nuk përfaqëson risi për shumicën nga ne, megjithatë studimet e kohëve të fundit kanë vërtetuar se kafeina rrit kapacitetin për të qëndruar në një gjendje me alertë dhe përqëndrim maksimal. Me rritjen e aktivitetit mendor ka gjasa që të mos keni gjumë, pavarësisht se shumë personave kafeina u shkakton përgjumje dhe ëndrra që duken si të vërteta.

Redukton dhimbjen e kokës. Pirja e një filxhani kafeje mund të reduktojë ose eliminojë dhimbjen e kokës, pasi kafeina ka vetinë e zgjerimit të enëve të gjakut në tru. Gjithashtu, në të njëjtën kohë kjo substancë favorizon efektet analgjezike të aspirinës.

Shmang formimin e trombeve në gjak. Së shpejti do të përdoren

Konsumi i Kafesë ja 14 përfitimet

Ul riskun për diabet dhe kancer

preparate me kafeinë për të shmangur formimin e trombeve në enët e gjakut të cilët mund të shkaktojnë infarkt kardiak dhe emboli cerebrale. Disa studime kanë treguar se kafeja nuk rrit presionin arterial, nuk ndikon në ritmin kardiak dhe nuk provokon infarkt.

Redukton riskun për të vuajtur nga sëmundja e Parkinsonit. Një studim i kohëve të fundit ka treguar se kafeja përfaqëson një substancë mbrojtëse e cila mund të reduktojë riskun për të vuajtur nga Parkinsoni: ata që nuk pijnë kafe kanë një risk 2 deri 3 herë më të lartë për të

zhvilluar këtë sëmundje. Përmirëson astmën dhe alergjitë. Kafeina zgjeron bronket, duke shmangur krizat e astmës dhe alergjitë e tjera. Aktualisht, kafeina është pjesë përbërëse e një sërë medikamentesh që përdoren për problemet në rrugët e frymëmarrjes.

Rekomandime

Jo kafes pas orës gjashtë

Konsumi i tepërt i kafeinës mund të provokojë përshpejtim të ritmit të zemrës, palpacione, rritje të presionit arterial, irritueshmëri, pagjumësi, ankh, dridhje, aciditet gastrik, shtim të urinimit, të përziera ose të vjella.

Ju vetë, në bazë të përvojës, duhet të njihni kufijtë tuaj për sa i përket sasisë së kafesë që mund të konsumoni. Mos pini kafe pas orës 18.00 në rast se doni të bëni një gjumë të mirë.

Në rast se doni të lini kafënë, ndërpriteni në mënyrë graduale. Kjo pasi ndërprerja e menjëhershme e kafeinës mund të shkaktojë dhimbje koke, përgjumje dhe gjendje ankthi.

SASIA E KAFEINËS NË PIJE TË NDRYSHME

Kafe	Vlera mesatare (mg)
■ Kafe e gjatë (150 ml)	115
■ Kafe ekspres (30 ml)	40
■ Kafe e tretshme në ujë (150 ml)	65
■ Çaj i zier (150 ml)	40
■ Çaj i tretshëm në ujë (150 ml)	30
■ Çaj i ftohtë (240 ml)	45
■ Pije me bazë kola (180 ml)	18
■ Pije energjike (250 ml)	80

Nuk provokon ulcer. Ulcerat provokohen nga bakterit Helicobacter pylori dhe jo nga konsumi i kafesë. Marrja me tepri e kafesë (më shumë se katër filxhanë në ditë) rrit prodhimin e lëngut gastrik dhe mund të përkeqësojë lezionet ekzistuese të stomakut. Duke qenë kështu, njësoj siç ndodh me ushqime të tjera irrituese, kafeja nuk rekomandohet në rastin e problemeve gastrointestinale.

Kafeja ul riskun për të zhvilluar kancer. Ka disa studime shkencore të cilat raportojnë se kafeja nuk shfaqet me risk për të zhvilluar kancer. Jo vetëm kjo, por konsumi i më shumë se dy filxhanëve kafeje në ditë parandalon disa lloje kanceri si për shembull kancerin e zorrës së trashë dhe atë të fshikëzës së urinës, pasi kafeja përmban 300 lëndë antioksiduese. Përveç kësaj, po shihet mundësia që kafeja të jetë pjesë e medikamenteve të reja kundër kancerit.

Nuk ndikon në shtatzëni. Aktualisht dihet se konsumi i dy filxhanëve kafe në ditë nuk ndikon në riprodhueshmëri dhe nuk sjell asnjë pasojë negative për gratë shtatzëna.

Parandalon kariesin. Kafeja parandalon rritjen e bakteve në gojë në rast se merret pa sheqer dhe pa qumësht.

Ul depresionin. Depresioni është një sëmundje më vete dhe duhet trajtuar nën mbikëqyrjen mjekësore të një specialisti. Megjithatë, studimet e botuara nga qendra hulumtimi me famë botërore kanë zbuluar se konsumi i moderuar i kafesë ndihmon në përbalimin me depresionin, pasi kafeina është një stimulues natyral që sjell energji.

Redukton riskun për të zhvilluar diabet. Sipas studimeve, pirja e 2 deri 3 filxhanëve kafe në ditë mund të reduktojë deri në 30% riskun për të zhvilluar diabet, pasi përbërësit e kësaj pije ulin përqëndrimin e sheqerit në gjak.



Lamtumira e poetit

■ ■ ■ TIRANE

DHURATA HAMZAI

Ndërron jetë në Spitalin Onkologjik të Tiranës poeti Pano Taçi. Trupi i pajetë qëndron prej dy ditësh në morgun e Tiranës, sepse nuk ka pasur asnjë familjar të tij në Tiranë. "Djali i tij vjen nesër (sot) për ta marrë trupin e pajetë të poetit nga morgu", thanë dje specialistë e Mjekësisë Ligjore. Poeti i divorcuar prej vitesh nga bashkëshortja ka jetuar në vetmi e varfëri të plotë pas daljes nga burgu i të përndjekurve politikë. Megjithatë ai ishte krenar për të birin, u fliste të gjithëve për të dhe ishte i lumtur sa herë që e takonte. Pano Taçi lindi në vitin 1929 në Gjirokastrë dhe ndërroi jetë më 12 qershor 2012. Poeti, që është konsideruar si përfaqësues i poezisë lirike dhe erotike shqipe, ka lënë në proces botimi librin e tij të fundit me poezi "Muzgu vjen papritur". Ndonëse Pano Taçi ishte pjesëmarrës në Luftën Antifashiste Nacional-Çlirimtare që në moshën 14 vjeç, ai u burgos që në vitin 1947 për tentativë arratisjeje dhe "për dashuri borgjeze" dhe deri në vitet '90, në pjesën më të madhe të kohës, ai ka përjetuar përndjekjen dhe persekucionin e diktaturës komuniste. Instituti i të Përndjekurve Politikë ka negociuar dje me Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve që t'i bëhen homazhet dhe nderimi i duhur poetit. Homazhet do të zhvillohen ditën e enjte, dt. 14. 06. 2012, ora 10.00 - 11.00 në hollin e Teatrit Kombëtar.


JETA DHE LIRIA E BOHEMIT POET PANO TAÇI

Poeti Pano Taçi bënte jetën e një bohemi poet. "Nuk i pati kurrë të ardhurat e e nevojshme për të jetuar. Kur kishte ndonjëherë në dorë, merrte shtëpi me qira, por të shumtat e herëve jetonte në ndonjë papafingo të braktisur", thotë për të një ndër miqtë e shumtë të poetit, shkrimtari Hysen Sinani. Kohët e fundit Pano Taçi jetonte i vetmuar, pa grua, pa të afër. Lëvizte me një motor të vjetër: rrangallën me me fat ndër gjithë rrangallat e botës, sepse ajo ishte mikja më e dashur e poetit. Me këtë rrangallë ai bënte vërtetë jetën e një bohemi ose Don Kishoti poet. Ndjenjat e tij ishin jashtë psikologjisë së kohës, por mjaft të dliira dhe të pastra. Askënd nuk lëndoi e nuk i ra kurrë njeriu më qafë. Dashuronte me zemër, pa kushte dhe nuk shante askënd, edhe pse jo rrallë herë e braktisnin,

PANO TAÇI

Vdes i vetmuar poeti i dashurisë

Pengu: Priste botimin e librit "Muzgu vjen papritur"



Poeti Pano Taçi

sidomos gratë. Pano Taçi ishte mik i të gjithë poetëve më të njohur shqiptarë, i Xhevair Spahiut, Ali Podrimjes, Sadik Bejkos, Agron Tufës, Arian

ai ishte ndër të parët poetë që shkruante pa pasur asnjë lloj tabuje mjaft poezi erotike. Ai dinte të shkruante mjaft bukur edhe poezi të lirike dhe

herë kafen te "Bar Europa. Ndërsa vuante nga sëmundja e kancerit në mushkëri, natyra e një rebeli të lindur nuk iu nënshtrua kurrë plotësisht terapive. Poeti ishte shumë i varfër dhe nuk kishte mjaftueshëm para të kurohej, edhe pse ndihmat nga miqtë nuk i munguan asnjëherë. "Në spital njeriu që kujdeset për të ishte djali i poetit të njohur Xhevahir Spahiut, me profesion mjek. "Megjithatë ai sapo bëhej pak më mirë, dilte nga spitali. Nuk duronte dot", thotë redaktori që ka në dorë librin e tij të fundit me poezi, Pandeli Koçi. Poeti sapo ndjente gjymtyrët t'i bindeshin, merrte motorin e tij të vjetër dhe dukej se don-

Pano Taçi lindi në vitin 1929 në Gjirokastrë dhe ndërroi jetë më 12 qershor 2012. Poeti, që është konsideruar si përfaqësues i poezisë lirike dhe erotike shqipe, ka lënë në proces botimi librin e tij të fundit me poezi "Muzgu vjen papritur"

Lekës, Bardhyl Londos, etj. Ishte njeri i dashur dhe i ngrohtë me të gjithë. Me atë natyrën e tij tejet të sinqertë,

ato me fabulën e moralit të pastër njerëzor. Kohët e fundit me poetin e njohur Xhevair Spahiut pinte shpesh-

HOMAZHET: Trupi i pajetë qëndron prej dy ditësh në morgun e Tiranës. Homazhet do të zhvillohen sot ora 10.00 - 11.00 në hollin e Teatrit Kombëtar

Bardhyl Londo

Pse ishte i veçantë poeti Pano Taçi

Krijimtaria poetike e Pano Taçit zë një vend të nderuar në vlerat më përfaqësuese të letërsisë shqipe, duke i dhënë kësaj të fundit më shumë identitet dhe fizionomi artistike dhe kombëtare. Edhe pse në poezinë e tij spikat motivet e mbijetesës nën regjimin totalitar komunist, fryma humaniste është një ndër ato veçori kryesore që përkshkon krejt korpusin e tij letrar. "Me vdekjen e tij kultura shqiptare humbi një ndër penat më të talentuara dhe letërsia shqiptare një ndër zërat më të veçantë të saj", thotë poeti i njohur Bardhyl Londo. Pasi ka folur për kalvarin e burgjeve dhe vuajtjeve të "poetit me shpirt të bardhë", Londo rrëfen edhe disa nga arsytet pse ishte Pano Taçi ishte një poet i veçantë. Ai thotë ndër të tjera se "Ai nuk është i veçantë sepse e kemi specifikuar shpesh si poetin e guximshëm të erosit dhe të dashurisë. Poezia e Pano Taçit është e veçantë sepse ai ndërroi më të mirën, ndërroi moralin më të pastër njerëzor, ndërroi idealet më bukura njerëzore. Njëkohësisht ai ishte një lëvruar i talentuar i poezisë, ishte mjeshtër i vargut dhe original në mënyrën e të shkruarit. Ka shumë veçori që do ta cilësonin të veçantë poezinë e Pano Taçit, por një nga veçoritë e tij më të mira ishte se ai ka menduar përmes vargjeve pareshtur për shpirtin e njeriut, për thelbin bujar të shpirtit njerëzor, për pastërtinë e ndjenjës. Ai ka menduar gjithë jetën e tij për dashurinë dhe moralin njerëzor në emër të poezisë. Po ta vëshes krijimtarinë e tij ajo flet për shpirtin e njeriut dhe moralin human mbarëshoqëror"



Poeti Bardhyl Londo

te të shijonte edhe pikat më të fundit të jetës në liri, që i kishte munguar aq shumë ndër vite, ndërsa muzgu i saj po i afrohej. Kjo duhet të ketë qenë mbresa e tij e fundit për jetën, përderisa e titulloi edhe librin e tij të fundit me poezi "Muzgu vjen papritur". Pano Taçi poezitë i shkruante në çdo cep kafeneje. Shumë prej tyre i improvizonte në çast dhe jo të gjitha i ka lënë të shkruara. Disa kanë mbijetuar si poezi gojore popullore, sidomos ato të dashurisë. Jeta dhe vepra e Pano Taçit ka qenë një kalvar i pafund vuajtjes, burgimesh dhe internimesh, por ai se ndau kurrë buzagazin për njerëzit. Poezia, vetëm poezia ishte e dashura më besnike e Pano Taçit, e këtij poeti, një adhurues i përluajtur deri në thellësi të shpirtit ndaj gruas.

KUR "MUZGU VJEN PAPTUR"

Pano Taçi mbetet një

ndër ata poetë që për një periudhë të gjatë ka qenë i privuar nga liria e fjalës dhe mendimit. Vetëm pas viteve '90, ai nisi të botojë serinë e veprave të tij poetike, të cilat u vlerësuan nga lexuesi dhe kritika letrare. Librin e tij të fundit me poezi luste që ta botonte më herët. Nuk e gëzoi dot. Priste që Ministria e Kulturës ta financonte. Ajo vonoi, ndoshta priste sponsor të jashtëm, edhe pse poetit ia pati premtuar ndihmën. Ndërsa libri ka mbetur ende në proces botimi, për poetin do të ishte tepër vonë. Ai nuk e pa me sy. Redaktori i librit të tij, Pandeli Koçi, thotë se "mezi e priste këtë libër. Panua më tha se: ata të ministrisë do të më ndihmojnë". Libri ende nuk është botuar. Pra, poeti vdiq me këtë peng. U largua nga kjo botë me pengun e librit "Muzgu vjen papritur".

SHKOLLA E PARUKERISË - ESTETIKËS

KRËHËRI I ARTË (LUÇI)

Adresa: Rr. Mihal Grameno,
200m mbi Shkollën e Baletit
Teli: 04 2 233 950
Facebook: Kreheri i Arte Tirane

Kurse 6 - 9muajore.
Për më të mirët mundësi punësimi
Regjistrimi vazhdon



SKANDALI SUEDEZ

Ekipi i Suedisë duket se po e përgatit me "seriozitet" ndeshjen e radhës përballë Anglisë. Në një prej senacave stërvitore futbollistë suedez kanë kthyer në shinjestër prapicën e portierit të tyre Ëiland, i cili nxjerr prapicën dhe shokët e ekipit e godasin. Kjo video që në pak minuta ka bërë xhiron e botës duket se ka përfshirë në një skandal suedezët. Por Ëiland ka deklaruar se gjithçka ishte pjesë e stërvitjes dhe asgjë më shumë.



NDALOHEN 184 HULIGANË

Në përfundim të ndeshjes Poloni-Rusia policia ka ndaluar 184 huliganë të cilët kanë shkakuar trazira. Inatet e vjetra midis tifozëve të dy përfaqësuesve janë shfrytëzuar më së miri në përfundim të ndeshjes. Sipas ministrisë së sporteve të Polonisë mësohet se të arrestuarit janë 157 polakë , 24 rus, 1 spanjoll dhe një algjerian. Theksojmë që ndeshja përfundoi në barazim 1-1.

Humbja e djeshme venit tulipanët

Gomez çon Gjermaninë në çerekfinale

Tre ekipe në garë për vendin e dytë

■ ■ ■ TIRANE
DYLBER BALLA

Lajmi

Pas ndeshjeve të dyta në grupin B, Gjermania kualifikohet në turin çerekfinal, ndërsa Hollandën vetëm një mrekulli mund ta shpëtonte nga eliminimi. Portugalia ka fituar përballë Danimarkës duke rihapur garën për vendin e dytë në grup.

Finalja e parakoshme e Europianit Gjermani-Hollandë ka vajtur për gjermanët, të cilët presin të parët biletën për në çerekfinale, ndërsa shpresat e Hollandës për të kaluar grupin janë në fije të perit. Tulipanët mund të kualifikohen në raundin tjetër vetëm nëse do të fitojnë ndeshjen e fundit përballë Portugalisë, ndërsa Gjermania duhet t'ju bëjë një nder duke fituar me Danimarkën. Askush nuk e kishte menduar më parë që Holanda, e cila kuotohej si favorite për të fituar Europianin do të kishte të këtu ecuri. Gjermanët e kanë nisur shumë mirë ndeshjen duke shënruar dy herë në pjesën e parë me bomberin e tyre, Mario Gomez në minutat e 24' dhe 38'. Të besuarit e trajnerit Marvijik të çorientuar plotësisht mundohen të reagojnë me të gjitha forcat për të ngushtuar rezultatin, por pjesa e parë

mbyllet me fitoren e "painerave". Në pjesën e dytë Marvijik largon Van Bommel për Huntelar dhe Afelay për Van der Vart duke freskuar mesfushën dhe sulmin, por Gjermania administron me kujdes rezultatin. Pas shumë tentativave të dështuara Van Persi arrinë të lërë gjurmë duke shënruar në minutën e 73' me një goditje të fushqishme jashtë zone duke mposhtur Noyerin. Goli ringjall shpresat për një barazim të tulipanëve që

tentuan me Huntelar dhe Van Persin pa pushim por mbrojtja gjermane ishte në ditën e saj më të mirë. Në fund Holanda largohet me kokën ulur duke mos u besuar syve për atë që kishte ndodhur. **DANIMARKË-PORTUGALI**

Portugalia ka siguruar një fitore dramatike me shumë vlera në minutat e fundit përballë ekipit të Danimarkës në ndeshjen e dytë në grupin B duke qëndruar në garë për një vend në çerekfinale. Ndeshja ka përfunduar me rezultatin 2-3, ku luzitanët kanë dominuar në të gjitha drejtimet, por golat nuk kanë ardhur nga futbolli i tyre më i mirë, Cristiano Ronaldo që nuk ka mundur të zhblokohej. Dancëzët me humbjen e pësuar rikthehen me këmbë në tokë pas fitores me Hollandën. Ndeshja ka qënë e bukur me plot raste për shënim, kryesisht portugezët. Sinjalin e parë në portën dancëze e ka dhënë Ronaldo me një gjuajtje nga larg por pa rezultat. Bendtler kundërpërgjigjet me një devijim me



Në foto: Mario Gomez duke festuar

HOLLANË-GJERMANI 1-2
Shënues: 73'Van Persi/24',38'Gomez
DANIMARKË-PORTUGALI 2-3
Shënues: 41', 80' Bendtler /24' Pepe, 36' Postiga, 87' Varela

kokë por topi përfundon mbi transversë. Rastet i lënë rradhën golave, serinë e të cilëve mendon për ta hapur mbrojtësi Pepe me një goditje me kokë në minutën e 24', nuk kalojnë shumë minuta dhe Portugalia mendon të sigurojë fitoren në 45' minutat e para duke dyfishur rezultatin në të 36' me Postigën, por në fund Bendtler ngushton shifrat në 1-2. Në pushim të ndeshjes tekniku Olsen udhëzon ekipin të zhvendoset me të

gjitha forcat në sulm për të barazuar rezultatin, por Portugalia e ndërton në ndihmë të kapitenit Ronaldo shpërdoron shumë raste për të trefishuar rezultatin, teska dancëzët gjakftohët barazojnë 10' minuta para përfundimit të kohës së rregullt. Iberikët nuk i humbin shpresat kundërpërgjigjen me golin e Vareles 3' minuta nga fundi duke siguruar kështu një fitore që e shtyn verdiktin final në ndeshjen e fundit përballë Hollandës.

LAJME SHKURT

■ **Erik Abidal në Europian**

Franca në kampionatin Europian që po zhvillohet në Poloni dhe Ukrainë do të ketë edhe një armë më shumë për të arritur objektivat e saj. Mbrojtësi Erik Abidal mësohet se do të bashkohet ekipit në ndeshjen me Suedinë. Një lajm të tillë e ka bërë të ditur presidenti i Federatës Franceze të futbollit për mediat Noel Le Graet. Abidal është rikuperuar pas transplantit të mëlçisë. Me ardhjen e Abidal grupi francez kompletohet plotësisht. Kujtojmë që Franca ka barazuar në ndeshjen e parë përballë ekipit të Anglisë. Tashmë nuk ka snjë justifikim për trajnerin Loren Blanc nëse nuk siguron një paraqitje të mirë në edicionin e finaleve.

■ **Golashënuesit më të mirë**

Pas përfundimit të dy ndeshjeve të para në grupe janë shfaqur edhe dy golashënuesit më të mirë të Kampionatit Europian të futbollit. Listën e kryesojnë Mario Gomez i Gjermanisë dhe Dzagoev i Rusisë. Pritshmëritë janë realizuar përsa i përket sulmuesit gjerman Gomez që ka shënruar tre gola vendimtarë deri tani. Golin e parë Gomez e shënoi përballë ekipit të Portugalisë, ndërsa dy të tjerët përballë Hollandës. Në të njëjtën kohë me tre gola është edhe sulmuesi Dzagoev. Rusi, dy golat e parë i shënoi me Republikën Çeke, ndërsa të tretin përballë Polonisë. Në listë nuk figurojnë çuditërisht Ronaldo.

Spanjë-Irlandë

Spanja do fitoren e parë në grup

■ ■ ■ TIRANE

Kampionia e Europës në fuqi, Spanja do të kërkojë fitoren e parë në këtë Europian pas barazimit me Italinë në ndeshjen e parë. Sipas parashikimeve, iberikët në letër kanë një kundërshtar të lehtë për të kaluar si Irlanda, e cila ndeshjen e parë e humbi me Kroacinë. Trajneri Vicente Del Boske edhe pse u kritikua shumë për zgjedhjet e tij pas ndeshjes me Italinë, pritet të zbrësë në fushë me të njëjtin formaicon përballë



Irlandës. " Me Italinë zhvilluam një lojë shumë të mirë por nuk fituam sepse nuk arritëm të finalizonim saktë para portës. Formacioni reagoi shumë mirë. Të njëjtën gjë do të kërkojmë të përsërisim edhe me Irlandën" deklaroi Del Boske. Edhe futbollistët të gjithë në kor duke filluar nga portieri Kasijas, Xavi dhe Torres shprehen se përveç fitores nuk lejohet asnjë rezultat tjetër. Irlanda nga ana tjetër kërkon një paraqitje dinjitoze pasi kualifikimi mbetet një ëndërr që vështirë se mund të bëhet realitet.

Itali -Kroaci


Në luftë për vendin e dytë

■ ■ ■ TIRANE

Itali-Kroaci konsiderohet si ndeshja më e fortë e grupit C në xhiron e dytë. Ballkanasit aktualisht janë në udhëheqjen e grupit pas fitores bindëse me Irlandën në ndeshjen e parë. Një fitore me Italinë do të thoshte kualifikim automatikisht për të besuarit e trajnerit Bilic. Një rezultat i tillë nuk do të jetë i lehtë për t'u siguruar, por kroatët besojnë që ky është momenti i tyre. Bilic përpara ndeshjes ka theksuar se do të jetë një ndeshje e fortë dhe



mjaft përcaktuese për ecurinë e dy ekepeve më të Italinë pas problemeve me 'Caciopolin' e kanë nisur në mënyrën më të mirë Europianin e tyre duke ndaluar Spanjën dhe treguar se ata janë gjithmonë një kërcënim real për këdo që kanë përpara. Prandaj në konferencën para ndeshjes shprehet se nuk do të bëjë shumë ndëryrje në formacion duke i besuar në sulm me shumë mundësi dyshes Di Natale-Baloteli. Çdo rezultat tjetër nga fitorja e komplikon situatën e Italisë, prandaj tre pikët janë një detyrim sot në orën 18:00.



ZBAVITJE

[SHQIPTARJA.com] funditësë

Kur hajdutëve s'u del boja

Matthew McNelly dhe Joey Miller, që shihni këtu në foto, janë dy amerikanë nga Carroll, në Iowa, të cilët pas një plane të studuar të detajuar mirë vendosën të hynin në një apartament për të realizuar një grabitje të madhe. Pasi bënë gjithçka gati, si masë të fundit zhgëryen fytyrat me marker me ngjyrë të zezë, në mënyrë që për çdo eventualitet të mos njiheshin. Dhe në një farë mënyre bën mirë, sepse vërtet, ndërsa po shpërthenin derën e apartamentit, bënë shumë zhurmë duke bërë që fqinjët të jepnin alarmin. Natyrisht që ia mbathën me të katra, por kur u larguan dhe deshën të pastronin fytyrën e kuptuan se çfarë gafe kishin bërë. Markeri me të cilin ishin zhgërryer në fytyrë kishte qenë nga ato me bojë të pashlyeshme. Ashti siç ishin katandisur policia nuk e pati paspак të vështirë t'i zbulonte e t'i vinte në pranga...



Grabitësi do të bëjë edhe don Zhuantin

A i që zgjedh të bëjë hajdutin sigurisht që e ka ndarë mendjen për këtë dhe as që do t'ia dijë për gjë tjetër, por kur dikush përveç grabitësit kërkon të bëjë edhe Don Zhuantin atëherë kemi të bëjmë vërtet me një rast vërtet të rrallë. I tillë është 26-çari John Jardini, nga Pittsburgh, i cili pasi i rrëmbeu një vajzë çantën me ç'kishte brenda (para përfshi edhe celularin), kërkoi t'i rrëmbente edhe zemrën. Kështu, duke përfutur nga celulari i saj i mori numrin telefonik të shtëpisë dhe telefoni duke i kërkuar që të dilnin sëbashku. Vetëm se u tregua më i sinqertë nga ç'duhet, pasi ia tregoi edhe se në ç'rrethana ia kishte mësuar numrin e shtëpisë. Sigurisht që vajza refuzoi dhe ndërkoji menjëherë policinë. Por ndërsa po dilte për shopping me të ëmën, u sulmua sërisht për t'u grabitur dhe grabitësi ishte sërisht Jardini, por këtë radhë ra në duart e policisë.



Qeni paraqitet vetë në urgjencë

I gjithë ekipi mjekësor i spitalit Farmington, në Neë Mexico, mbeti i shtangur nga habia kur në repartin e ndihmës së shpejtë hyri për t'i mjekuar një pacient. Nuk ka asgjë për t'u habitur kur dikush paraqitet në urgjencë për të marrë ndihmën e shpejtë, por në këtë rast ai që i habit më shumë mjekët e këtij spitali ishte pikërisht pacienti. Ishte një qen pastor, i cili hyri duke çaluar nga një plagë që kishte në këmbë dhe hundën e gjakosur nga një plagë tjetër. Menjëherë mjekët e kuptuan se ishin plagë të shkaktuara nga përleshje me ndonjë qen tjetër rrugaç dhe e dërguan pa humbur kohë në një repart veterinarie aty pranë. Pasi e mjekuan me kujdes ishte qeni vetë ai që i çoi veterinerët drejt e në shtëpinë e të zotit të tij, që ndërkohë kishte njoftuar policinë.



SUPER FJALEKRYQ

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21
22				23		24			25							27	28		29	30
			31	32				33							34	35			36	
37	38		39				40	41							42					43
44			45			46					47	48	49	50		51				52
		53		54						55		56			57					58
59	60		61				62		63	64		65			66		67			
68							69				70				71		72			73
74			75				76			77	78		79		80					81
82			83			84		85	86	87	88			89		90				
		91					92		93						94					95
96							97							98						99

- **HORIZONTAL**
- Ndiqet ajo e fundit.
 - Një gabim i pariparueshëm.
 - Kufizojnë një tunel.
 - Këndojnë Yellow submarine.
 - Ekstrema në duf.
 - Rruga e Ferenc Molnar.
 - Ndryshe për latinët.
 - Një fjalë e pamjaftueshme.
 - Eshtë vepër traumaturgu.
 - Eshtë samar... kail.
 - Rastisin në krye.
 - High Definition.
 - Janë fotot që projektohen.
 - Një fjalë goxha.
 - Markë motoçiklete.
 - Ishin Kastori dhe Pollusi.
 - Punojnë me nivel
 - Mbyllin një spital.
 - Një qen që gjuan dhelpra.
 - I absurdit ai i Ionesco-s.
 - Douglas i Spartacus
 - Fillojnë reformën.
 - Ka dy rreze.
 - Eshtë grackë.
 - Një që duhet sajdisor.
 - Rrethojnë ringun.
 - Bëjnë numra me ura.
 - U intereson trashëgimtarëve.
 - Pak teatralitet.
 - Eshtë i pandershëm, i pacipë.
 - E ka edhe ai një kufi.
 - Eshtë dëshirë fikse.
 - Edouard piktor.

- Rajone Autonome Lokale.
- Eshtë fama.
- Duken në fund.
- Një enë.
- Nofka e Eisenhower.
- Demme regjisor.
- Të fundit në studim.
- Kush nuk di... mbytet.
- Një Matt aktor.
- Fundi i Turandot.
- Eshtë veshje basketbollisti.
- Janë si barka.
- Bukuroshja Xhuvani e skenës sonë.
- Eshtë Afërdita ndryshe.
- King Cole i muzikës.
- Schiele piktor.

- **VERTIKAL**
- Felipe pilot.
 - Të fundit në simbol.
 - Caneron aktore.
 - Dy asa.
 - Inicialet e Pacino-s.
 - Një biçikletë dyshë.
 - Fillojnë aktivitetin.
 - Një sëmundje në grykë.
 - Një veshgjatë i butë dhe i egër.
 - Bashkohen për t'u puthur.
 - Eshtë ajka e... shoqërisë.
 - Rocky i Sylvester Stallone-s.
 - U zbulua nga Alfred Nobel.
 - Del nga zjarr.

- Carol aktore.
- Trimi pa çifte.
- Një pjesë e lavjërësit.
- Inicialet e Signoret.
- Lama i Tibetit.
- Janë krahët e zogut.
- Eshtë enë gjaku.
- Fillojnë largimin.
- Një burrë nga lagja Parrucë.
- Egjipiti i Çajupit.
- Shumë zëra.
- I triumfit ai i Remarque.
- U shkrua nga Zweig.
- Kështu thirret jugu i SHBA.
- Qyteti i Borussia-s.
- U shkrua nga Torquato Tasso.

- Janë në verë.
- Përfundojnë pingul.
- Me të bëjnë një tuftë.
- Eshtë hidrogjeni i... deuterior.
- Eshtë numri një.
- Policia e taksave.
- Eshtë pronar anijesh
- Mund të jenë mallrash.
- Tony, Mister Quando.
- Një ndenjese me rezervë.
- Eshtë sëmundje... mendore.
- Kufijtë e një guximi.
- Pat kitarist i njohur.
- Janë këngëtarët si Inva Mula.
- Një teolog në xhami.
- Mbyllin një sirtar.
- Salgari i Sandokan.
- Inicialet e Moravia-s.
- Jeton në... qytet.
- Lindi Akilini.
- Claude-Oscar piktor.
- Kalohet në gjumë.
- Mund të kthehet në mllaf.
- Mund të jetë gjaku.
- Vreto mes patriotëve.
- Kaçaturian kompozitor.
- Gjysmë sundim.
- Fillojnë takimin.
- Sillet me një set.
- Gjysma e lubisë.
- Skema pa kufij.
- Fillojnë lojën.
- Inicialet e Berenger aktor.
- Fillojnë vallen.

PERGJIGJET E NUMRIT TE DJESHEM

S	E	R	O	T	O	N	I	N	A	M	T	I	A	L	A	D	I	N	I	T	A	S		
E	K	O	N	O	M	I	K	E	G	J	A	T	A	T	R	A	P	E	Z	I	P	I	K	A
K	U	M	A	R	I	E	O	U	T	R	T	I	T	R	A	T	N	O	R	I	I	R		
R	A	A	T	R	M	I	S	I	O	N	A	R	E	T	A	A	R	I	E	L	L			
E	C	E	R	I	K	T	E	N	T	A	K	U	L	A	T	F	R	U	E	N	L	I	L	
T	I	T	A	R	M	A	R	T	I	N	E	D	E	N	R	E	I	N	O	L	D	S	U	
E	O	J	U	L	E	S	V	E	R	N	E	O	N	A	E	T	I	R	A	S	F			
T	N	P	A	K	A	M	I	I	L	T	A	N	A	T	O	M	I	A	A	T				
I	S	N	S	N	E	G	A	T	I	V	I	C	A	R	O	N	U	R	A	T	A			
B	A	R	B	A	D	O	S	T	A	N	I	T	A	B	A	T	N	D	R	A	K	A	R	
A	L	F	R	E	D	M	I	N	I	E	R	A	A	R	A	M	I	S	L	U	N	A		
A	R	O	A	Z	I	A	M	T	A	L	I	G	I	N	O	T	A	R	T	A	K			

HOROSKOPI

- Dashi**
Dëshira deri në mani për arritur rezultate të menjëhershme mund të jetë një nga arsyet që ju duket se gjithçka ju shkon së prapthi. Provoni t'i merrni gjërat më me qetësi dhe do të shihni sa mundësi keni.
- Demi**
Shumë lidhje apo raporte ndërpersonale mund të lëkundin për arsye nga më të ndryshmet, prandaj bëni mirë t'i ripërtëri, dita bëhet mjaft interesante në një udhëtim të shurtër.
- Binjakët**
Mund të guxoni pak më shumë për të artur aty që dëshironi, ndryshe do të vazhdoni vetëm të shihni ëndra me syhapur. Sidoqoftë, një Hënë e mirë bën që raportet me partnerin të kjenë të këndshme.
- Gaforja**
Duket seni mbetur paksa prapa me punët tuaja përse i takon aktivitetit të përditshëm, por sot nuk ju këshillohet të mendoni dhe aq shumë për to. Mendoni pak më shumë për çështjet e zemrës.
- Luan**
Nën "akordin" Afërditës Jupiter parashikohet një ditë e pasur me takime, propozime e impenjime në planin e raporteve ndërpersonale. E rëndësishme për ju është se ka të ngjarë të lindë një dashuri e re.
- Virgjëresha**
Edhe pse është Afërdita ajo që është ylli juaj i mirë, jeni aq të shpërnduruar, në atë masë sa mund të kaloni edhe në konfuzion të plotë. Më mirë kështu, sepse mund të ketë vend për surpriza.
- Peshorja**
Kalimi i Hënës në shenjë është në përgjithësi i favorshëm për ju, ndonëse kontrasti i Marsit mund ty sjellë ndonjë të papritur. Do të jeni në qendër të vëmendjes në një ambient njerëzish të rëndësishëm.
- Akrep**
Afërdita në shenjë sot është mjaft pozitive dhe do t'ju mbështesë në zgjidhjen e një problemi personal, por ajo që ka rëndësi është se dita do të jetë shumë e këndshme në raportet me partnerin.
- Shigjetari**
Lkjo ditë nën shenjë e yjeve pozitivë do të jetë një rast i mirë që, më me fund, të rimani në dorë frenat. Raporteve me dikë ndoshta duhen parë me një sy tjetër, që gjërat të shkojnë më mirë.
- Bricjapi**
Merkuri vërtet që sot mund të mund t'ju ngatërojë idetë, por nga ana tjetër stimulon edhe pasion tuaj, çka bën që të kaloni një ditë të "zjarrtë" me partnerin. Kujdes mos e teproni me shpenzime pa vend.
- Ujori**
Sot, një takim aq i pritë me dikë nga ju do të mund të realizohet në rrethana disi të papritura, prandaj është mirë që të jeni deri diku të përgatitur për çdo eventualitet. Interrestetë dita në planin afektiv.
- Peshqit**
Duket se më në fund mosmarrëveshjet e ditëve të shkuara kanë rënë ndëshjem dhe Marsi që e bënte të paqëndrueshëm situan nuk ka më atë ndikim. Këq njofton për të kaluar një ditë vërtet të qetë.

**LAJME
NGA BOTA**

Barroso: Kriza nuk është kuptuar siç duhet
Presidenti i Komisionit Evropian, Hoze Manuel Barroso, ka thënë të mërkurën se kriza financiare në Eurozonë "nuk është kuptuar siç duhet" nga disa vende. Duke folur para Parlamentit Evropian në Strasbourg, Barroso e ka përshkruar krizën si "problem sistematik". Ai ka thënë se është e nevojshme që të "artikulohej një vizion" dhe "një rrugë më konkrete". Megjithatë, Barroso ka pranuar se "edhe kur qeveritë ndërmarrin hapat e duhur për reforma", përpjekjet e tyre "mund të ndikohen negativisht nga ngjarjet që nuk i kontrollojnë dot". Deklaratat e Barrosos pasojnë marrëveshjen e ministrave të financave të Eurozonës për t'i dhënë Spanjës kredi në vlerë prej 100 miliardë eurosh, për bankat e saj të trazuara.

Lavrov në Iran - bisedime për programin bërthamor
Krizë mbi programin bërthamor të Iranit dhe konflikti në Siri pritet të dominojnë axhendën e bisedimeve ndërmjet ministrit të Jashtëm rus, Sergei Lavrov, dhe zyrtarëve iranianë. Vizita e Lavrovit në Teheran vjen pak ditë para bisedimeve ndërmjet Teheranit dhe gjashtë fuqve botërore, që do të zhvillohen më 18 dhe 19 qershor në Moskë. Para udhëimit të Lavrovit, sekretarja amerikane e shtetit, Hillary Clinton, ka thënë se Irani duhet t'iu përgjigjet në mënyrë konstruktive propozimeve ndërkombëtare, të cilat synojnë të qetësojnë tensionet rreth çështjes bërthamore. "Jam shumë e sigurt se ata janë nën presion të tmerrshëm nga rusët dhe kinezët, që të vijnë në Moskë të përgatitur për përgjigje."

Su Ki në Evropë pas 24 vjetësh
Liderja pro-demokratike e Birmanisë, Aung San Su Ki, ka udhëtuar drejt Evropës për herë të parë nga viti 1988. Pika kulmore e turneut të saj dyjavor do të jetë fjalimi i shumëpritur në Oslo, ku do të marrë Çmimin Nobel për Paqe, të ndarë qysh në vitin 1991. Vizita e saj nxjerr në pah ndryshimet që kanë ndodhur në Birmani, pas përfundimit të sundimit ushtarak në vitin e kaluar. Në 24 vjetet e fundit, udhëheqësja e opozitës, Su Ki, ka qenë në të shumtën e kohës nën arrest shtëpiak.

Tunizia e dënon me 20 vjet burgim ish-kryetarin Ben Ali
Gjykata ushtarak në Tunizi ka dënuar ish-presidentin tunizian Zine el Abidin Ben Ali me 20 vjet burgim në mungesë, shkaku i nxitjeve për trazira, vrasje dhe plaçkitje në territorin e këtij shteti" raportojnë agjencitë. Gjykata ushtarake e sollë vendimin në rastin e quajtur Uardanin i cili i referohet vdekjes së katër djelmoshave të vrarë gjatë dhunës që e tronditi qytetin Uardanin nga gjysma e janarit 2011. Në natën mes 15 dhe 16 janarit 2011, një ditë pas kësaj se Ben Alisë në Arabinë Saudite, ishin vrarë këta katër demonstrues të cilët tentuan që t'i kundërviheshin arratisjes së Kais Ben Alisë, nipit të presidentit të rezuar.

Nga bombat 62 të vrarë në Irak
Një seri sulmesh me bomba në Hila dhe Bagdad të Irakut kanë shkakuar 62 viktima dhe disa të plagosur. Sipas BBC, dy makina me eksploziv shpërthyen pranë një restoranti në Hila. Makina e parë vrau 6 persona dhe plagosi 20 të tjerë. Një shpërthim i dytë disa minuta më vonë vrau 7. Kryeqyteti Bagdad është goditur me 7 bomba sipas Ministrisë së Brendshme të Irakut. Shumica e viktimave ishin pelegrinë. Shia të mbledhur për një festë fetare.

Bosi meksikan i drogës arrestohet në SHBA
Prokurorët federalë në SHBA kanë arrestuar vëllanë e një padroni të dyshuar të drogës meksikane dhe asgjësuan një operacion të madh për pastrimin e parave përfshirë edhe garat me kuaj. Jose Trevino Morales ishte një nga shtatë personat e arrestuar në bastisjet në Oklahama dhe Neë Mexico. Ai është vëllai i një udhëheqësi të kartelit të drogës Zeta, Miguel Angel Trevino, i cili është ende i lirë. Katërmëdhjetë persona në total janë të akuzuar.

VALË UHF
NË PREFEKTURAT:
TIRANE - DURRES - LEZHE - FIER



DIGITALB
KANALI 50
Do na ndiqni në të gjithë Shqipërinë, Maqedoni, Kosovë, Itali, Greqi dhe në pjesën tjetër të Europës

Mund ta ndiqni A1-Report në këto televizione kablore:

NE SHQIPËRI		Berat		Kukesi		Reçi KGM		Lezhe	
Televizioni MRM	Qyteti Korçë	Berati	Elbasan	Oresh	Fier	Reçi KGM	S3	Tirane	Kraje
Intel Media	Fier	Fier	Fier	Maqedara	Diber	Manastiri	Ju-af	Lac	Fier
Inkusal	Pogradec	Lushnje	Lushnje	Tala Junior	Prenjas	B.Çurri	Manastiri	Fier	Elbasan
TVM Devoll	Devoll	Prenjas	Tirane	Dijviska	MKG	Lushnje	Beishi	Elbasan	Fier
Viosa	Vlore	Tirane	Tirane	Ura Vagurore	Berat	Lushnje	ARD&NET	Fier	Fier
Toskëz	Lushnje	Fier	Fier	Saranda Digital	Berat	Sarande			
Bradat	Elbasan	Kucove	Kucove	Pupa	Berat	Lushnje			
Erzeni	Shijak	Elbasan	Elbasan	Roskovec	Berat	Fier			
Luna	Kavaje	Vlore	Vlore	HE-GA	Vlore	Peshkopi			
Mariusho	Bulqize	Prroqezine	Prroqezine	Eri-ABA	Prroqezine	Ballsh			
Permeti	Permet	Mat	Mat	Iliria	Mat	Berat			

Së shpejti...

**TELEVIZIONI
MË I RI
INFORMATIV
NË SHQIPËRI**



Redaksia & Marketing

Rruga: "Dervish Hima",
Tirë kullat, kulla e dytë, Tiranë
mobile: +355 69 60 60 421
marketing: +355 69 60 60 419

Studiot e prodhimit A1
Rruga: "Aleksandër Moisiu"
ish-Kinostudio Shqipëria Sot

A1 REPORT!

origjina e lajmit...

Lajmi në High Definition

Jemi një grup mediatik i pavarur nga çdo parti në të cilin rregullat profesionale të informacionit mbizotërojnë mbi luftërat politike

• Alba Malltezi
Drejtoresh e Përgjithshme
e Free and Fair Media Group

• Anila Basha
Drejtoresh e Shqiptarja.com
• Arben Rrozhani
Kryeredaktor

Politika: Jakin Marena
Ekonomia: Genc Kondi
Kronika: Elton Qyno

Sociale: Esmeralda Keta
Kulturë: Admirina Peçi

Design: Altin Aliaj
Genti Manelli
Website: Suela Gera
Indrit Maraku

Departamenti i Marketingut:
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Shpërndarja:
Saimir Zenelaj
Cel: +355696060418